


BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 SH - 32

T 95

SKËNDER I. TUPJA



FLAKËT E URREJTJES
TREGIMË

8 SH - 32
T 95

SKËNDER I. TUPJA

FLAKËT E URREJTJES

TREGIME

~~75555~~
3247

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

FLAKËT E URREJTJES

— Po të shkon ters, mor vëlla, — i thoshin gjithnjë fshatarët. Atyre u vinte shumë keq. Donin tindsightmonin, po edhe ata ishin të varfër. Vërtet kjo e lehtësonte ca Zenelin, por, në fund të fundit, ishte vetëm një përkrahje morale. Në atë fshat malor, ku përveç disa rripave toke, që jepnin një dorë misër, si dhe pak bagëtive të imta, që mbaheshin me të keq, hante pula gur, si i thonë fjalës.

Zenel Mustafai rropatej fill i vetëm në punët e rënda të bujqësisë. I ati i kishte lënë trashëgim vetëm një shtëpi të vogël, ku edhe bagëtia nuk bënte rehat e jo më njeriu. Kishte edhe një copë tokë në një rrëpirë, që e lante çdo ditë me djersë e gjak. Si shpërblim nuk siguronte as bukën e gojës.

Me gruan e parë nuk pati fëmijë. Kur ajo kishte mbyllur sytë përgjithmonë, ai kishte qarë njëlloj si për të vdekurën ashtu edhe për shtëpinë, që po i mbetej pa një trashëgimtar. Pas pesë vjetësh që martuar përsëri. Edhe gruaja e dytë, Nafija, si e para, ishte shëndetligë, me fytyrë të

vrarë. Fliste e qeshte rrallë. Zeneli i thoshte shpesh se me atë pamje të ngrysur atij i dukej se ajo ndillte fatkeqësi. Po s'merrte përgjigje. Nafija dëgjonte, ngruhej e dilte jashtë dhe atje, në ndonjë qoshe, e nxirrte marazin, duke u shkrehur në vaj. Shokëve të Zenelit u dhimbsej kjo grua e mirë, punëtore dhe e urtë, e qortonin burrin «zemërgur», duke dyshuar se mos ai ishte shkaktar për zymtësinë e saj.

Pas dy vjetësh atyre u lindi një vajzë. Zeneli e priti sihariqin me një ftohtësi të papërmabatur. Shtëpia i kishte mbetur përsëri pa traun kryesor. E bija do të rritej e do të shkonte në shtëpinë e botës. E shoqja e vuri ré dhe u vra më shumë në shpirt. Kur vajza, Meremja, mbushi tre vjeç, ata u bënë edhe me djali. Këtë herë Zeneli sa s'u çmend nga gëzimi. E shoqëronte të birin me përkujdesje të tepruara dhe me frikën në zemër se mos i sëmurej dhe i vdiste. Po edhe me të shqen filloj të sillej më ngrohtë. Nuk e vinte re aq shumë natyrën e saj të myllur e të zyrtë. Tani dukej sikur jetonte vetëm për djalin, Seferin. Të gjithëve u thoshte me mburrje se këtej e tutje oxhaku i shtëpisë së Mustafajve do të nxirrte tym brez pas brezi. Djali tjetër, Agimi, u lindi pas gjashë vjetësh, kur Zeneli i la prapa të pesëdhjete-pesat.

Bashkë me gëzimet, fëmijët sollën edhe shqetësimë. Varfëria u ul këmbëkryq në koliben e tij të vjetër, ku të zihej fryma. Ajo karakatinë nuk mjaf-tonte për familjen prej pesë vetësh. Fshatarët i thoshin shpesh të ndërtonte një të re. E atij i pikonte në shpirt për këtë, po e shihte se do të shkatë-

rrohej nga ekonomia, po t'i futej këtij telashi, se s'kishte asnje mbështetje. Të tjerët s'e ndihmonin dot. Një shtëpi pér të qenë donte shumë para. Kur e mendonte shtëpinë, ai turbullohej më tepër, hutohej... Ulej te ledhi anës oborrit dhe bënte plane pas planesh, po llogaritë s'i dilnin. Pastaj ngrihej dhe ecte në tym, duke pirë duhan të fortë e duke u kollitur vazhdimisht.

Vetëm pas disa vjetësh, i qeshi nuri Zenel Mustafait, kur Meremja dhe Seferi u rritën. Atëherë ai i dha karar ta shkulte nga themeli atë kassolle pér ibret dhe të ndërtonte një shtëpi pér të qenë, ku t'i ngryste si njeri ditët e pleqërisë. Në këto mendime e ngrohu edhe i kunati. Ai i premtoi një shumë të hollash, që t'ia kthente pak e nga pak. Kështu filluan të ngriheshin themelet e shtëpisë së re. Mirëpo papritur punët u ngatërruan. Ai qerrata kunat e hëngri fjalën. I tha se paratë nuk ishin të tijat, po të një tjetri, i cili donte garanci. Dha e mori Zeneli, po nuk gjeti rrugëdalje. Atëherë la peng atë copë arë dhe e mori në sy të punonte pér të panjohurin aq kohë, sa të shlyente borxhin. Nuk mjaftoi kjo, po u sulën, si miza në mjaltë, edhe matrapazët, që nga furnizuesit e materialeve të ndërtimit e deri tek ata batakçinjtë me shkollë, të cilët donin t'i shitnin me çmim të kripur një copë letër, ku qenë bërë ca viza të trasha sipas të cilave do të ngrihej shtëpia. Këtë s'e hëngri Zeneli. U tha se shtëpinë do ta ndërtonte siç dinte vetë.

Kështu, një ditë të bukur vjeshte çdo gjë pati përfunduar dhe familja hyri në shtëpinë e re. Atë ditë Zeneli nuk ishte në vete nga gjëzimi. Po

edhe së shoqes i qeshnin sytë. Ai ecte ngadalë dhe fërkonte plot butësi me pëllëmbët e duarve të ashpra derën e dhomës në katin e poshtëm. E hante me sy tavanin e lyer me ngjyrë bezele të çelur, hynte në qilar, dilte që andej, lëmonte parmakët, hidhërohej kur shihte ndonjë plasaritje, ngjitej lart në dhomën e miqve, vërtitej rrotull sallonit katror dhe gjithë këto lëvizje e përkujdesje i shoqëronte me psherëtima shqetësimi e lehtësimi. Kur ra për të fjetur, e ndjeu veten të lodhur dhe u çudit kur mendoi se njeriu u lodhka edhe pa punuar. Tani ai kishte një copëz lumturi në jetën e tij aq të ashpër e të pasigurtë, që ngjante me atë detin e egërsuar, kur nGRE tallazet lart në quell dHE e përplas lundrën bashkë me lundërtarin si të dojë e nga të dojë. Sidoqoftë ai kishte tani një shtëpi. PËR mË tepër, në dimrin e ashpër, kur natyra shfrynte me tërbim, nuk do t'i shihte më ato rrëkezat e ujit që «shëtitnin» nëpër dheun e ngjeshur, i cili zëvendësonte dyshemenë prej dërrase, dHE era nuk do të bridhte me vërtik nga njëra anë në tjetrën.

Pas dy vjetësh e shleu borxhin. E ndihmoi shumë edhe djali i madh, që ishte futur punëtor në një kaminë gëlqereje. Bashkë me paratë ai i solli Zenelit edhe mendimet e para për të huajt që kishin pushtuar vendin dHE përluftën që bënин komunistët. Kështu, me kalimin e kohës, plaku u bë përhapës i fjalës së Partisë në fshat, po me mënyrën e vet. Fliste shkoqur, ashtu si dinte. Kishte vetëm një pikë të dobët. Atë punën e pronës së përbashkët s'e përtypte dot. Kur i biri i tregonte se si diku në një vend të botës tokat ishin bashkuar në kooperativa të mëdha, që prodhonin pa hesap, atij i dukej

sikur ajo copë shterpë dhe dy-tri pula ishin më të mira, ca më tepër tanë që kishte shtëpinë e vet, se-sa po të bëhej toktanë me të tjerët.

Koha rrodhi. Po mbusheshin tre vjet që edhe Meremja jetonte në qytet, te një kushëri i nënës. Atje punonte. Edhe ajo e ndihmonte shtëpinë. Zeneli qeshte dhe përdridhte mustaqet me kënaqësi, kur kujtonte sesa ftohtë e pati pritur lindjen e saj. Në të hyrë të prillit të vitit 1943 ai mori një letër dorazi nga qyteti. E shkruante ajo. Zenelit i ndritën sytë. Thirri të shoqen dhe e lexoi.

Qofshi mirë me shëndet! Edhe unë mirë jam. Më ka zënë malli shumë pér ju, po s'qenka thënë ta nxjerr së shpejti. Ti, baba, do të më kuptosh. Dua që edhe nëna të mos ma marrë pér keq. Ja, si është puna. Fashistët po më gjurmojnë, se ti e di, që unë ngatërrohem me punë të ndaluara. Kjo do të thotë se ata ua kanë frikën edhe vajzave. Pra, së shpejti mund të dal partizane. Kështu mendojmë. Putheni Agimin pér mua. Ju përqafoj fort e mirupafshim në Shqipërinë e lirë! Meremja.

Nafija qau. Zenelit iu dridh buza e poshtme. Tre muaj më vonë edhe i biri ndoqi rrugën e së motrës. Prindërit mbetën vetëm me djalin e vogël. Kjo ishte ca e rëndë pér moshën e tyre, megjithatë thellë në shpirt Zeneli ndiente diçka të bukur, që e bënte të ishte ballëlart para të tjerëve. Ai — babai i dy partizanëve.

Në janar 1944 mori lajmin se Meremja ishte vrarë. Që nga ajo ditë Zeneli u bë i heshtur si varri. Agimi 13-vjeçar ia këpuste shpirtin me të qarën e tij prej fëmije. E kishte dashur të motrën sa më s'bëhet. Ajo e kishte lënë me një mall përvëlues.

Pas dy javësh Zenelit i erdhi një letër nga komanda e batalionit partizan. Ajo ishte firmosur nga komisari. Atë, burrë e grua, kokë më kokë, e lexuan disa herë radhazi. U dukej sikur shihnin Mëremen. Nafija ishte bërë si gur. Zeneli i tha të birrit të nënvizonte ca rreshta, të cilët më vonë i mësoi përmendsh. Në ta thuhej: *Vajza juaj ra siç u ka hije partizanëve, bijave të Partisë. Armiku s'ia pa kurrë shpinën në fushën e luftës. Kur plumbi e goditi në kraharor, ajo thirri: «Përpara shokë!» Partia dhe komanda ju shprehin juvë, prindërve të saj, ngushëllimet e gjithë partizanëve dhe ju falënderojnë, që rritët një vajzë të tillë trime.*

Që nga ajo ditë Zeneli u lidh edhe më shumë pas djemve.

Ai dimër qe shumë i ashpër. Ditë e natë s'pushtonte era e tërbuar, që i përkulte pemët gjer në tokë. Dëbora, që kishte rënë herë pas here, po tretej nga shirat e rrëmbyera. Një ditë më parë qenë ndezur luftime të ashpra diku aty afër. Në fshat dëgjoheshin sokëllimat e mitralozave dhe plasjet e predhave të artilerisë. Shtëpia e Zenelit ndodhej larg të tjerve. Nga lagjja më e afërt mbante njëzet minuta. Në mbrëmje Zeneli dëgjoi ca zëra afër oborrit. U ngjit menjëherë në dhomën sipër. Pas pak zhurma u bë më e madhe. Porta e jashtme u hap me forcë. Njerëz të armatosur u futën në oborr. Zenelit iu vrénjt balli. Ai doli te pragu i derës. Njëri nga të porsaardhurit tha diçka që s'u mor vesh, se në çast një shok i tij qëlloi befas me armë. Viktimitë qe një kaposh i bukur. Nuk kaloi shumë e ai,

goxha burrë, dukej i qetësuar vetëm me gjelin e vrarë në dorë. Ndërkokë një tjetër doli nga plevica duke tërhequr zvarrë një dele. Ishin dhjetë ballistë.

— Dëgjo ti, plak! — e urdhëroi Zenelin kapoja i tyre. — Sonte të na e shtrosh si për dasmë! Kemi luftuar dy ditë me radhë me ata qenër partizanë dhe duam të festojmë sëç na ka hije! More vesh? Na sill raki ballë kazani! Hajt!

Zeneli ia ktheu i verdhë dyllë nga nervozizmi:

— Mirë, o bej, mirë, po, kur vijnë miqtë, më parë lirohen nga armët, pa pastaj dredhin ndonjë duhan me të zonë e shtëpisë e pastaj të tjerat vijnë radhë.

— Shiko, shiko! Qenka kokosh plak ky! Dashka të na japë edhe mend! Lëri, ore, fjalët, të them, e mos na dërdëllis, po marrsh, bëj ç'të thashë! Dhe, uro allahun që jam në qejf, se ndryshe do t'i kisha ndyrë duart me ty!

Këto fjalë të Xhemal beut i gajasën së qeshuri të tjerët. Ata filluan t'i hidhnin romuze plakut. Njëri nga ata tha:

— Ne e dimë se ti nuk na do ne, po komunistët, mor pizeveng! Prandaj luaj këmbët, shpejt, se m'i paske goxha të gjata! Mos na hap punë të t'i shkurtojmë!

Të gjithë u shkulën prapë së qeshuri, ndërsa Zenelit i shkreptinë sytë. Ai doli nga dhoma i fyer rendë. Pas pak, bashkë me Agimin shtroi një sofër të madhe dhe u vuri përpëra duhan të grirë imtë. I pyeti nëse dëshironin ta fillonin pijen me ç'i ndodhej aty për aty, apo do të pritnin sa të piqeshin pulat.

— Piqi, piqi, se këtu na ke! — iu përgjigj ai që rrinte në krye.

Kaluan disa minuta dhe Xhemal beu i tha përsëri Zenelit që t'i shpejtonte përgatitjet. Kur ky u mat të dilte jashtë, ai e pyeti:

— More plak, pa ndalo një çikë! Nuk të pyeta, sa fëmijë ke?

— Dy djem, bej. Këtë të voglim dhe një më të madh.

— Ku e ke të madhin? Mos është partizan?

— Jo, bej. Punon në qytet. Kam borxhe dhe më ndihmon t'i laj.

— Se mos gënjen?

— C'është ajo fjalë!

Po atë fotografinë në mur ç'e ke?

— Vajza ime është. Ka vdekur tani vonë.

Të gjithë shikuan fotografinë e Meremes. Ai, që rrinte në krah të komandantit ballist e që dukej se vinte pas tij pér nga pozita, foli:

— O i zoti i shtëpisë! Po ato vajzat që kanë pasë partizanët pér çfarë i duan thua zotrote, pér luftë apo pér...

Fjalët e tij e goditën Zenelin më rëndë se plumbi, me gjithatë e mbajti veten. I hodhi një vështrim fotografisë së Meremes dhe ndjeu se iu drodhën mustaqet e bardha. Foli me vete: «Bijë e babait! Të pata djalë e shkuar djalit! Ti u vrave në shesh të burrave, kurse këta qena...» Zemra e plakut ishte ndezur. Agimi solli raki me bollëk, pula të skuqura, fërgesë dhe bukë të ngrohtë.

— Urdhëroni! — foli Zeneli me zë të mekur, duke i ftuar të pinin.

— Për shëndetin e baballarëve të kombit e të

gjithë atyre që luftojnë kundër komunistëve, me fund! — tha kapoja dhe e rrëkelleu gotën e rakisë si sarhosh i regjur. Të tjerët e pasuan.

Rakia e fortë, po e dashur, pulat e pjekura për merak, dhoma e ngrrohtë, të gjitha nxitën në mes ballistëve një muhabet për shtatë palë qejfe...

Orët kalonin pa u vënë re. Pija filloj të bënte të sajën. Fytyrat e tyre u skuqën, sytë e tyre u zvogëluan, mjekrat nisën të kullonin lyrë.

Zeneli filloj të shërbente me shkathtësi. Ai po sillej dashamirës. E shoqja dhe Agimi u çuditën kur plaku i çoi raki tjetër, meze e pastaj delen e pjekur, që kundërmonte erë aq të mirë. Ballistët tanimë qenë çakërdisur nga pija. Çakërdisur dhe prerë.

— Pini, zotërinj, — u thoshte Zeneli. — Raki kemi mjaft!

— Mos na ngut, o plak! — i përgjigjej Xhemal bëu, — nata jona është.

— Si të urdhëroni, bej!

Kur ora shkoi tre pas mesnate dhe kur Nafija e rraskapitur nga puna e rëndë dhe e çuditur nga qëndrimi i të shoqit, kërkoi të dinte përsë i nxiste ai aq tepër të pinin, Zeneli i tha ftohtë se ashtu e kërkonte nderi i shtëpisë. Pas pak e ndjeu se duhej t'i tregonte diçka ndaj shtoi:

— Nisuni për te shtëpia e Selmanit tok me Agimin! Ruhuni të mos ju shohin, se na bëjnë gjëmën, pastaj shpejtoni, de!

Tha kështu dhe u ngjit lart. Kur hyri në dhomën e pritjes, vuri re se çdo gjë qe bërë lesh e li. Shiltet ishin hedhur andej-këndej, dikush këndonte e qante, një tjetër s'po i shqiste dot dhëmbët nga kofsha e mishit të dashit. Tavani mori në çast disa

plumba rakte. Dy të tjerë gérhitnin, duke nxjerrë nga goja jargë pérzier me fije mishi. Më i riu jep-te e merrte me çakmakun, që nuk i ndizte, ngaqë nuk kishte benzinë. Zeneli i afroi një shishe plot dhe ia mbushi. Kur po dilte nga dhoma, u pengua diku, shishja i ra dhe iu thye. Dhoma u mbush më erë të rendë.

— Na qelbe, more plak matuf, po s'ka gjë! — thirri Xhemal beu. — Po qejfi të bëhet, pa hundët i kemi mësuar edhe me erë kërme ne, e jo më me erë benzinë!

Gérhiti si derr e seq llomotiti tjetër. Zeneli kérkoi të falur. Pastaj u tha se do t'u conte përsëri raki dhe meze. Doli te pragu i portës, hodhi edhe një herë vështrimin brenda dhe iu drodh shtati. Hyri përsëri brenda. Era e benzinës të digjte grykën, llam-ba me vajguri nxirrte tym të zi. Njëri nga ballistët ngriti kokën dhe kérkoi një gotë ujë. Zeneli ia solli. Ballisti, më tepër e derdhi se e piu, pastaj u shtri gjatë e gjerë në shilte. Zeneli hoqi nga muri fotografinë e Meremes e doli jashtë, mori dy shishe dhe u largua, nisi të derdhte benzинë në sallonin katror. Ai shpejtoi duart. I dha flakën benzinës, vrapi në oborr dhe vërviti dy bomba mbi çatinë e asaj shtëpie që e kishte bërë me aq halle.

Krismat e forta shpërthyen sakaq. Pastaj gjuhët e flakëve morën përpjetë qiellit sterrë. Edhe një kasolle kashte nuk do të ishte djegur aq shpejt. Në dhomën e pritjes u dëgjuan britma të llahtarshme. Një hije u duk në dritaren me shufra hekuri. Zeneli e mori në shenjë me pushkën e gjatë. Pushka buqiti, i vrari ra me kokën në parvaz.

Trarët, dyshemeja dhe plaçkat që digjeshin,

kërcisnin me të madhe. Tërë shtëpia u përkul. Pas pak dy ballistë, të ndezur flakë, arritën në oborr. Por s'bënë dot çap, se morën nga një plumb ballit. Të tjerët, bashkë me Xhemal beun i përpinë flakët e shtëpisë, që digjej rrëmbimthi, sikur ta ndiente se përse po sakrifikohej. Kur gjithçka mori fund, Zeneli tha më vete:

— Do ta bëj të re, posa. Dhe më të bukur akoma. Ja, edhe ca, sa të lirohemi.

MESUESI

Asaj nate gushti, në atë shtëpi përdhese të vjetër sa vetë qyteti, vetëm kuzhina ndriçohej nga lamma me vajguri. Ishin mbledhur të gjashtë pjesëtarët e familjes. Nga shiu, që kishte rënë pak më parë, disa enë të vjetra të vendosura aty-këtu nëpër qoshe qenë mbushur plot. Kuzhina nuk kishte tavan. Sipër shkëlqenin trarët nga bloza e zezë. Në sofrën e vogël, rreth së cilës ishin ulur nëna me pesë fëmijët, përveç qullit të zakonshëm, kishte edhe dy tasa të tjera. Njëri me një sultjash të mpiksur mirë, kurse tjetri me gjashtë kokrra pjeshkë. Dhe kjo ndodhë se të nesërmen djali i madh, Luani do të fillonte një jetë të re. Ai kishte mbaruar shkollën normale dhe qe emëruar mësues në një fshat të largët malor. Sytë e nënës qeshnin e qanin. Ajo gjëzohej që i biri po i bëhej krah, për të rritur jetimët por, kur mendonte se nuk do ta kishte pranë, shqetësohej! «Eh, i madhi — hallemadhi», — mendonte. Ai e kishte mbaruar shkollën me shpirt ndër dhëmbë. Gjatë vërs kishte thyer gurë për shtrimin e një rruge automobilistike. Tani rrinte disi më i kënaqur pranë njerëzve të tij më të dashur. Herë-herë buzëqeshte,

përkëdhelte motrat e i thoshte nënës ndonjë fjalë të ëmbël.

— Luan, — i foli ajo pas palk, — ti u rrite tani, ndaj mos të të vijë keq pse të porosit nëna. Hë, t'u bëfsha! Hap sytë e zgjidhi mirë shokët, se ka ardhur kohë e vështirë! Puno me nder, si yt atë, ruaj shëndetin dhe na shkruaj shpesh! — Heshti dhe e ktheu kokën mënjanë, pér të fshehur dy pikë lotë që i rrödhën faqeve.

— Mos u bëj merak, nënë! Porositë e tua nuk do t'i heq kurrë nga mendja.

E éma e dëgjoi si e përhumbur. Ai ia puthi flokët e thinjur para kohe dhe ia mbështeti kokën në gjoks. Ajo i lëmoi kaçurrelat e zeza dhe e përçolli me mendje në rrugën e largët plot të panjohura.

* * *

Në fshat e pritën ftohtë. Ky çunak nuk ua mbushi syrin, sidomos disa burrave të vjetër, që kishin mjaft tokë dhe bagëti të trasha e të imta. Këtyre u kishte pëlqyer pa hesap mësuesi i parë, një burrë i vjetër, që falej tri herë në ditë e që, kur binte fjala, u thoshte fëmijëve se s'kishte gjë më të mirë, sesa të mësonin përmendsh pjesë nga kurani. Dhe ja tani ai babaxhan, që shtrohej pérherë këmbëkryq me ta dhe llupiste si i babëzitur çfarëdo që i vimin përrpara, duke lavdëruar allahun, që kishte ditur t'i ndante, që zëvendësuar me këtë tjetrin, me të cilin s'ta hante mendja se mund të bisedoje ndonjë gjë pér të qenë.

Si kaluan nja dy muaj, ata u bindën se nuk qenë gabuar në gjykimin e tyre pér mësuesin e ri, i cili, pér

çudinë e të gjithëve, u lidh ngushtë me ca djem të fshatit. Kjo s'u pëlqeu fare burrave të sojmë, ngaqë ata çunakë ishin të pabindur dhe dyshohej se përziheshin në punë të ndaluara nga qeveria. Po s'ishte kjo e gjitha. Mësuesin e domin shumë të varfrit, e fshatit, «rrjepacukët». Po edhe ata shejtanër kalamaj e domin e e domin, sa më s'bëhej. Thoshe se edhe be për kokën e tij bënin. Mos vallë mësuesi ishte komunist? Ai banonte në një dhomë të vogël të shkollës. Mjaft nxënës ishin prej fshatrave rrotull, ata bënin goxha rrugë për të ardhur gjer atje, e nuk mungonin kurrë në shkollë. Vinin me dëshirë të madhe. Mësuesi u mësonte shpesh gjëra shumë të bukura. Në shtëpitë e fshatarëve, këta kërthi shtatë-tetë e dhjetë-dymbëdhjetëvjeçarë filluan të flitnin me gjuhën e tyre për ndershmérinë dhe për virtytet e mjeriut, për dashurinë ndaj atdheut. Madje, dinin të thoshin se atdheu ishte fshati i tyre, fshatrat e tjera, edhe qytetet, tërë Shqipëria.

Kishte ardhur pranvera. Nxënësit mezi e prisin orën e mësimit të këngës. Luani i binte violinës. E pati mësuar më shkollë. Atëherë nuk kishte me se ta blente. Ia huante një shok i mirë, djalë i vetëm. Fashistët e vrani gjatë një demonstrate. Nëna e tij ia fali veglën më shenjë kujtimi për të birin.

Një ditë i coi nxënësit jashtë, më pyll. Atje ia mori një këngë, që fëmijët s'e kishin dëgjuar. Violina lëshoi ca tinguj të fortë e të prerë. Sytë e të vëgjelvë u ngulën te harku, që rrëshqiste me shpejtësi

mbi telat e hollë. Pastaj këta tinguj u përzien me zërin prej baritonit të mësuesit dhe u përhapën po-shtë, nëpër luginën e ngushtë. Fëmijëve u dukej si-kur rrëth e qark diçka buçiste. Vegse kjo buçitje kishte një gjë të ëmbël, që u kujtonte zërin e bilbilit. Ata dukeshin si të dehur nga kënga dhe pranvera. E pyetën për këngën e re. Kërkuan t'ua mësonte. Luan i buzëqeshi dhe u tha se do të vinte një ditë që do të mësonin shumë këngë si ajo e që u kushtoheshin atyre që luftonin për atdheun. Kur po ktheheshin, ai i shih te me dashuri dhe e ndiente se kënga revolucionare i bënte fëmijët më të mirë.

Kalonin muajt dhe në fshat flitnin hapur se mësuesi ishte komunist. Sa herë ndodhë diçka e ndaluar, thoshin se ishte dora e tij. Kur u mor vesh se i biri e një fshatari doli partizan, e thanë copë se edhe kjo ishte punë e mësuesit. Të rinxve, që nuk ishin nxënës shkolle e me të cilët mësuesi sillej si shok, u mësonte më shumë mbi jetën, mbi shoqërinë... Bashkë me ta ai shkonte herë-herë jashtë fshatit. «Sojllinjtë» bëheshin kureshtarë për të marrë vesh diçka rrëth atyre shëtitjeve, po s'kishin arritur të nxirrin gjë në dritë. Edhe në qytetin e vogël aty afër, mësuesi zbriste shpesh, po, për çudi, nuk endej rrugëve, siç bënin shumë të tjera e as dukej në ndonjë vend défrimi, por kthehej shpejt në fshat. Nuk i linte nxënësit asnjëherë pa mësim. Kështu rriddhni ditët për të. Me punë në shkollë e me mendjen te të gjithë fshatarët, tek e ëma, te motrat e vogla. Ç'bë-nin ato vallë? Njëherë iu bë një muaj e ca pa marrë letër nga shtëpia. Ekte i menduar anës një ledhi me kokën ulur. Kur e ngriti, pa tre fshatarë që po kuvendonin shtruar. Deshi të largohej, por njëri nga jata e thirri. Kur u afrua, i njohu. Mërzitja iu shfua e shtetit

më tepër. Ia kishte qejfi të ishte vetëm atë çast, po s'bënte dot ndryshe. U ul dhe drodhi një cigare nga duhani i kutisë së praruar, që ia zgjati më plaku, i cili, pasi ia ndezi, e pyeti:

— Or zoti mësues, me ç'po shohim, fëmijët tanë sikur të duan e të dëgjojnë shumë, apo jo?

— Janë të zgjuar, o xha Sherif; më vret e mira të ankohem. Ma ha mendja se edhe ju jeni të kënaqur nga sjelljet e tyre.

— Po, or, po, — u hodh e tha një burrë më i ri, i veshur mirë, — veçse sikur kanë filluar ta taprojnë ca. Kam frikë se mos na këcejnë mbi qafë. Shumë u është hapur syri.

Mësuesi bëri sikur nuk e kuptoi.

— Thonë se ata janë si sfungjeri, — tha. — Thi-thin goxha nga ç'shohin e dëgjojnë. Ja, le ta zëmë se një ditë na vjen djali në shtëpi dhe i gjen duke u grindur të émën e të atin. Burri e bën gruan në sy të djalit për pesë para, ose më keq, ngre dorën dhe e godet. Si thoni ju, çfarë mendon fëmija në këtë çast? Në shkollë ai mëson të dojë e të respektojë, jo vetëm prindërit, por edhe të tjerët, kurse në shtëpi sheh dicëka tjetër dhe hutohet. Ç'ka thithur ai në këtë rast? Vetëm të zeza ka thithur. Bile, edhe mund të mendojë se mësuesi në shkollë i bie gozhdës, ndërsa babai në shtëpi i bie patkoit. Kështu ndodh pastaj që, kur djali rritet, na vjen keq se nuk u bë i hajrit. Pra, harrojmë që fajin e kemi ne vetë.

Burri i ri i veshur mirë u skuq gjer te veshët, se kujtoi skenën kur rrahu të shoqen në sy të së bijës, nxënëses së Luanit. Përdrodhi mustaqet me ca lëvizje të shpejta të gishtave dhe u hodhi një sy dy të tjerëve, sikur donte t'i pyeste për dicëka. Mc vete ai thoshte se ky qerrata mësues, që s'të hynte në sy,

sikur kishte jetuar denbabaden në fshatin e tyre e ua njihet të fshehtat. Heshti ca dhe pyeti:

— Ta zëmë se me këto që the ke të drejtë zotrote, po me ca gjëra të tjera si i bëhet? A e di ti që këta qurramanë, që nuk kanë hequr shpërgjenjtë akoma, kuturisin e thonë ca gjëra që, po t'i dëgjojnë të tjerët, ua këputin veshët e ne na fusin në belara të mëdha?

— Pse, si është puna? — ia ktheu mësuesi dhe ndjeu një gëzim të brendshëm.

— Ja, ta them unë! — e mori fjalën i treti. — Që thua zotrote, ai çamarroku i djalit tim, Zeqiri, nuk ka mbushur as nëntë vjeç dhe se nga kishte dëgjuar ca fjalë, që s'i ngre as dheu. Na i lëshoi «bëllduq!» në mes të të gjithëve. Dhashë e mora, me të mirë e me të keq, për të marrë vesh se kush ia kishte mësuar, po s'ë hapi që s'e hapi gojën qerratai.

— E çfarë tha, që e paski rrahu aq shumë? — foli mësuesi me një ton, ku nuk fshihej zemërimi.

— Cfarë tha? S'ma nxë goja ta them, o mësues. Ja, kështu! Mos shko më tutje! Ne i çojmë në shkollë e ata kur kthehen në shtëpi, na tregojnë se italianët janë të këqinj, kurse shqiptarë të mirë qenkan vetëm ata, që do t'i përzënë prej këndeji! Hë, si thua ti, kush ua mëson këto gjëra?

— More, kjo s'është hiçgjë, — hyri prapë në bisedë më i moçmi, — po ec e merru vesh me ca të rindj, që duan të na prishin rehatinë! Kërkojnë të maten me goxha qeveri. Pa le ca varfanjakë, si ai Demiri, ai rrjepacaku Hysë e ca të tjerë, që pandehin se do të vijë vakti të rrëmbejnë gjënë e tjetrit!

Mësuesit i punonte mendja tek ato që i kishin thënë shokët për këta fshatarë me të cilët po kuve-

ndonte. Ishin në gjendje të mirë e nuk do të ecnin kurrë në një rrugë me të varfrit, me njerëzit e thjeshtë të popullit, jo vetëm se kishin pasuri, po edhe sepse i kishin futur duart gjer në bërryl në punëra fort të ndyra, duke bërë edhe spiunllëqe kundra popullit. Për shkak të tyre ndonjë edhe e kishin plasur në burg. Këto i dinte mësuesi, prandaj, ndonëse ziente përbrenda nga inati, e përbajti veten. Megjithatë, nuk duroi dot pa u thënë:

— O xha Sherif, unë di të them vetëm kaq: kjo botë është e ndarë më dysh. Ca përpiken të ruajnë të mirat që kanë. Të tjerët mundohen të rrojnë si njerëz. Luftë ështëjeta. Le të bëhet si është më mirë!

Pas këtyre fjalëve ai u ngrit. Kur po largohej, Sherifi e shau me vete dhe u tha të tjerëve se mësuesi foli me thumba e kundër qeverisë, ndaj do të përfundonte patjetër në burg. Dy të tjerët u kënaqën nga fjalët e Sherifit dhe thanë se ishin në një mendje me të. Dhe ja, një ditë e pruri rasti të vinte në fshat xhandar Kasemi. Ai nuk e merrte kot rrogëng nga fashizmi. Prandaj, kur e panë njerëzit, duke ecur serbes, me koburen që i tundej fort në rripin e mesit, thanë vesh më vesh se diçka e keqe do të ndodhte. Atë pasdite xhandari dukej vërtet shumë i zymtë. Nuk përshëndeti asnje nga ata që hasi rrugës. Vajti drejt e në dyqanin e fshatit. Hyri brenda dhe përplasi derën pas. Ca fshatarë që ishin duke blerë e shikuan vëngër. Ata e njihnin mirë këtë njeri të qeverisë. Në qoftë se disa kafshëve, që godasin me brirë, u duhet ruajtur nga përpara e disa të tjerave, që qëllojnë me shkelma. T'u kesh frikën kur je pas, xhandar Kasemit duhej t'i ruheshe nga të gjitha anët. Ja, kështu ishte ai, një bishë e egër,

po edhe si ajo tenja, që gërryen ngadalë, si ajo merimanga, që e thur rrjetën pak e nga pak, si ai çakkalli, që lëpin kockën e lënë nga ujku. E ç'nuk kishte në veten e tij! Vetëm po t'i bashkoje të tëra në një vend, mund të thoshe se e njihje vërtet mirë. Sa hyri Kasemi, të gjithë pushuan së foluri dhe pri-tën ç'do të ngjiste. Pa iu drejtuar askujt, ai kërkoi t'i sillnin aty Qerimin, një plak tetëdhjetë e ca vjeç. Pas dhjetë minutash urdhri i tij shkoi në vend. Gjatë kësaj kohe erdhën në dyqan edhe të tjerë, edhe mësuesi në mes tyre.

— Ku e ke nipin, o plak matuf? — iu hakërrua xhandari xha Qerimit.

Plaku vuri dorën e djathë te veshi i djathë dhe kërkoi që të përsëriste pyetjen, sepse nuk dëgjonte mirë. Kasemit iu duk se e bëri enkas, u skuq në fytyrë dhe shfryu me sa zë pati:

— Ty, po të them, o plak shurdh! Hapi veshët mirë, kur të flas! Ku e ka thyer qafën ai zabërhan, yt nip?

— E para e punës, ndreqe gojën e fol më shtruar zotrote! — iu përgjigj xha Qerimi. — E dyta, unë s'kam ndonië nip zabërhan. Po ti, në e ke fjalën për Sadikun, fol, ç'ke pér të thënë, se po të dëgjoj!

— Ashtu, hë? — iu hakërrua Kasemi. — E ke më-suar të luftojë qeverinë, mor firaun! Prandaj ta kemi rrasur në burg. Atje do të ngordhë. Po mos harro, se do të paguash edhe ti pér fajin e tij! Mbaje mend këtë!

Pasi tha këto, zgjati dorën e, pér ta poshtëuar, i rrëzoi qeleshen nga koka. Plaku, të cilin e çmonin pér burrë të mençur, të urtë e të drejtë, s'e duroi fyterien. po ia ktheu me ca fjälë që Kasemi s'i harroi kurre.

— Dëgjo, or njeri i qeverisë! — i tha. — Po nuk dite t'i peşhosh mirë fjalët dhe bëmat, kjo goja ime e fishkur, edhe pse ka mbetur pa dhëmbë, përsëri kafshon. Ajo të pështyn në fytyrë dhe të thotë «që-rohu nga ke ardhur!» Të kisha, jo më shumë, po vetëm' nja dhjetë vjet më pak, do të të jepja një dru, që ta mbaje mend për tërë jetën. — Dhe sakaq e pështyu: — Pthu! Surrat!

Xhandar Kasemi u tërbua nga inati dhe e kapi nga mustaqet. Plaku u drodh. Sytë iu bënë gjak të kuq. Këmbët s'e mbajtën dhe u rrëzua. Mësuesi nuk duroi. Kërceu midis tyre dhe e shtyu tutje xhandarin me sa forcë pati.

— S'ke turp! — i tha. — Merresh me një plak!

Pastaj e ngriti xha Qerimin, kërkoi t'i sillnin një gotë ujë për të qetësuar plakun dhe tundi kokën egër.

Disa nga fshatarët e përkrahën mësuesin, por me frikë, duke shfryrë urrejtjen me ca fjalë gjysmake e me zë të ulët kundër xhandarit. Kurse nja dy-tri nuk folën fare. Dukej se i mbanin anën xhandarit. Ishin pikërisht nga ata, me të cilët mësuesi pati biseduar ca kohë më parë, kur i takoi rastësisht. Por papritur u hap dera dhe u fut brenda një djalë i ri. E shikoi Kasemin drejt dhe foli me zë të sigurtë:

— Shiko, o xhandar! Fshati e mori vesh këtë që bëre sot. Mos harro, se nuk ka për të të dalë mirë! Kaq di të them.

Mësuesi ia bëri me shenjë dhe djali nuk tha gjë tjetër. Xhandarit i erdhi vreri majë hundës. U sul ta qëllonte, por e mbërthyen krahët e mësuesit. U bë rrëmujë. Kasemi e kuptoi se kjo çështje po merrte ters, ndaj nuk shkoi më tutje. Doli i pari nga dyqani.

Pas tij dolën edhe të tjerët. Kur po largohej, u kthyen nga mësuesi dhe tha duke bërtitur:

— Siç duken bathët, ne të dy do të shihemi përsëri, o dhaskal!

Pastaj ngjeshi pushkën pas shpinës, diç mërmëriti nëpër dhëmbë dhe u zhduk. Mësuesi e përçollimi me mendimin se ai njeri i poshtër duhej hequr qafe sa më shpejt.

Por, nuk kaluan as njëzet e katër orë dhe mësuesin e lajmëruan të paraqitej sa më parë në komunë te postkomandanti. U nis i vetëm e i bindur se shkak për thirrjen ishte bërë ndodhia me xhandar Kasemin. Dhe ashtu doli. Xhandari po e priste te shkallët, duke e shpuar me atë vështrimin tallës e nënqeshjen ironike.

Mësuesi nuk i foli fare, sikur ai të mos ishte aty, po hyri drejt e në zyrën e postkomandantit. Xhandari iu vu pas. Sakaq u gjend brenda tok me të e i tha postkomandantit:

— Ky është ai karafili, zoti...

— Hë, po! Nuk na thua, ç'bëri vaki atje në fshatin ku... punon zotnia jote? — e pyeti postkomandanti mësuesin.

— Nuk jua tregoi xhandari? — u përgjigj mësuesi me pyetje.

— Ti ç'thua?

— Ky, zoti komandant, u mat me një plak 80-vjeçar. Nuk është turp?

— Dhe ti guxove të ngresh dorën kundër xhandarit tonë, kështu?

— Ashtu vërtet, — ndërhyri xhandari. — Më qëlloi me grusht. Bile, i ndërseu të gjithë kundër meje. Ky do zhëpur në hu. Po tërbon dynjanë.

— Gënjen, — ia priti mësuesi. — Shpif,

Xhandar Kasemi vazhdoi më me rrëmbim:

— Po, po. Bile më tha, po erdhe prapë këtej, do të të thyejmë brinjët!

— Jo, — tha mësuesi i habitur.

— Mbylle! — thirri postkomandanti vrazhdë. — Xhandarët tanë nuk gënjejnë. Ju dhaskalët gënjeni. Pastaj urdhëroi Kasemin:

— Fute në birucë dhe mbaje mbyllur nja dy ditë e dy net, që t'i vijë mendja në vend!

Dhe kur mësuesi e kreu këtë dënim, postkomandanti, duke e vështruar ngultas, i tha:

— Dëgjo, more djalë! Të jetë hera e parë dhe fundit që merrem me ty! Ke edhe gjynahe të tjera ti. Mos kujto se nuk i di unë! Më kanë raportuar se edhe nxënësit ke ndër mend t'i bësh komunistë qysh tani, pa mësuar ende të lidhin të mbathurat. Pa ke zënë shoqëri të ngushtë edhe me ca të rinj, që allahu e di se ku do të përfundojnë me sjelljet e tyre të dyshimta. Pa thonë edhe që ke gisht në ikjen e një maskarai në mal. E di që, të pëlcas në burg kur të duash?

Mësuesi e shikoi ngultas dhe u përgjigj me gjakftohtësi:

— Zoti postkomandant, unë ju kuptoj shumë mirë. Edhe ju duhet të më kuptoni. Kam ardhur në fshat për të mësuar fëmijët, t'i bëj të ndershëm dhe patriotë, e jo për gjë tjetër. Kurse për shoqërinë, jam i ri dhe kam të drejtë të lidhem me të rintjtë. Ata janë djem të mirë. I dua dhe më duan. Nuk bëjmë më tepër se q'na lejon mosha. Sa për të tjerat, nuk kam gisht në asgjë.

— E paske brisk gojën, djalë! Po, hap sytë, se do ta pësosh keq! Dhe tani qërohu jashtë dhe vari vath në vesh këto që të thashë!

Mësuesi doli në korridor. U ndesh ball për ballë me Kasemin. Ai rrinte i heshtur dhe ngërdheshej. Mësuesit i erdhi ndot. U largua me hap të zakonshëm. Kjo ndodhi të enjten.

Të dielën ai shkoi në qytetin e vogël aty afër. E kishin thirrur shokët. Në darkë rrugët u zbardhën nga traktet. Kur njerëzit e qeverisë, xhandarë e fashistë, zunë të vinin vërdallë për të kapur ata që hodhën traktet, Luani po ngjitej drejt fshatit. Ai nuk i ra rrugës më të shkurtër, që kalonte përmes komunës, po mori të përpjetën, midis një pylli të dendur me lisa të gjatë. Pasi eci gati dy orë, u ul, ndezi një cigare dhe po mendohej. Poshtë, qyteti vezullonte nga dritat. Ai buzëqeshi. Papritur u dëgjuajnjë pushkë. Pastaj edhe një tjetër. Ù ngrit në këmbë dhe mbajti vesh. E kuptoi se kishin qëlluar diku midis komunës dhe fshatit të tij. Përsëri buzëqeshi dhe uroi me zemër që pushka të kishte goditur në shenjë. Filloi të ngjitej. Kur arriti në fshat, llambat me vajguri qenë shuar prej kohësh. Me hapa të lehtë, duke shikuar nga të gjitha anët, hyri brenda në dhomë. Futi dorën në xhep, nxori shkrepsen, kërkoi paketën e cigareve, po preku diçka, që ia bëri fësh-fësh. Ndezi shkrepësen dhe atëherë pa një letër të bardhë. Ishte një trakt, nga ato që e kishte lexuar kushedi sa herë atje në qytet. E kishte ruajtur apostafat në xhepin e tij. Do t'ua jepë të rinjve të fshatit ta lexonin. Ra për të fjetur, por gjumi nuk e zinte. Qëndronte ashtu, me kokën mbështetur në jastëk. Papritur iu bë sikur dëgjoi një trokitje të lehtë në xhamin e drifares. U ngrit ngadalë. Bëri dy çape dhe qëndroi. Përsëri trokitën, por këtë radhë pak më fort. Mësuesi hapi dritaren, pastaj çeli derën. Brenda u fut Zarifi. Ata shkëmby-

en vetëm pak fjalë. Luani futi me të shpejtë ca gjëra në valixhen e vjetër. Pastaj dolën. Te porta qëndruan. Mësuesi u kthyesh në klasë dhe se ç'bëri. Porta kërciti pas krahëve të dyre. Ata rrëshqitën si dy hije.

Mëngjesi erdhi i freskët. Pak e nga pak oborri i vogël i shkollës u mbush me nxënës. Atë ditë nuk ra zilja. Të vegjlit u futën në klasë dhe u ulën në-për vendet e tyre. Në dërrasën e zezë ata panë diçka të shkruar me tebeshir e si me ngut. Nisën të lexonin duke ndarë rrokjet, por nuk vazhduan dot gjer në fund. U hap dera. Brenda në klasë u fut postkomandanti me dy xhandarë. Me ta nuk ishte Kasemi. Ai s'kishte për të ardhur më as aty e as gjékundi tjetër. Postkomandanti u bë si bishë e tërbuar, kur hodhi sytë nga dërrasa e zezë. S'kishte pse të pyeste ku ishte mësuesi. Aty qe shkruar: Rroftë Partia Komuniste Shqiptare! Vdekje fashizmit! Mirupafshim në Shqipërinë e lirë! Mësuesi! Eh, që s'e kishte kapur dot!

E nxori inatin me portën, e cila hëngri dy shkelma të fortë. Pas pak u fut përsëri në klasë njëri nga xhandarët. Ai nuk e pa fshirësen nga marazi dhe hutimi. I fshiu ato fjalë me mëngën e xhaketës ushtarake e pastaj doli jashtë. Për çudi, dëgjoi përsëri shkoqur ato që qenë shkruar në dërrasën e zezë. Nuk mund ta kuptonte se ato fjalë mbetën të skalitura në zemrat e fëmijëve. I kishte shkruar mësuesi i tyre i dashur.

SHOQËRIA PARTIZANE

Ajri i rëndë, muret plot lagështirë, dritaret e vogla me xama të thyer, dyshemeja, që kërciste edhe po të ecje lehtë, rënkimet e mbytura të disa të plagosurve, që përpinqeshin të mposhtnin dhimbjet e forta, të gjitha këto krijonin një ndjenjë të papël-qyeshme për cilindo që hynte në atë dhomë të gjatë e të ngushtë të spitalit partizan, ku ishin vendosur shtretër që nuk ngjanin fare me njëri-tjetrin.

Ai që kishte zënë shtratin në krye të dhomës, nuk qe më shumë se njëzet e tre vjeç. Fytyra zeshkane me mollëzat e faqeve të kërcyera, ku dridheshin lehtë fije muskujsh të vegjël, sytë e zinj plot shkëll-qim, mjekra e mbledhur nën buzët e shtrënguara, të mbeteshin në mendje edhe pas një shikimi të vetëm. Tjetri, afér tij, kishte fytyrë të zbehtë, sy të qetë e të mëdhenj ngjyrë qielli. Mbi ballë i binin një tufë flokësh të verdhë. Kraharon e kishte të mbështjellë me fasha të bardha, në të cilat dallohen shin ca njolla të kuqe. Ishte më i madh. Po u afrohej të tridhjetave.

Kur rrezet e para të diellit përshkuan xhamat e dritareve dhe kur ata ndien në fytyra ngrohtësinë e

tij në atë ditë dimri të acartë, ai me moshë më të madhe puliti dy-tri herë qepallat e syve dhe tha:

— Besoj se nuk do të na pengojnë më si atëherë dhe do të kemi kohë ta çojmë deri në fund bisedën.

Zeshkani u kthye nga ai me vështirësi dhe iu përgjigj duke buzëqeshur:

— E shoh se do të kesh fjetur me merak, sepse pa hapur mirë sytë kërkon prapë të më bindësh.

— Ti i zmadhon gjérat.

Të tjerët nisën të dëgjonin pa kuptuar për çfarë po flitej.

— Me sa më kujtohet, e patëm fjalën te Lufta Partizane e se q'është ajo në të vërtetë, — foli zeshkani dhe vazhdoi: — Unë nuk po përmend se kush e drejton këtë luftë dhe as po prek çështje të tillë me karakter ushtarak, si befasinë, lëvizshmërinë, epërsinë në goditje etj. Sipas mendimit tim, më e rëndësishme është se ne kemi me vete tokën tonë. A e dinë q'kuptoj unë me këtë? Gjithçka: njerëzit tanë, që e duan lirinë sa s'bëhet, edhe atë pemën e vëmuar, kudo që është, errësirën e natës sonë, të goditurën e sépatës së druvarit në malet tonë thepisura, fëmijët tanë, që u ngjitën shpateve me torbat, që kanë brenda një kothere bukë misri e një bombë, përrrenjtë tanë të rrëmbyer, gjithçka që është jona, kupton? Këto janë forca e atdheut tonë, që e godasin armikun orë e çast. Dhe ai nuk e ndien veten të sigurtë, prandaj luan të gjithë gurët, vret këdo që i del përpara. për dyshimin më të vogël. Pra, ai i trembet tokës sonë, kurse ne u besojmë asaj dhe njerëzve tanë, sepse pikërisht tek ata i kemi rrënjet. Cilido partizan, edhe ne të dy, që nuk lëvizim dot, e ndiemjë veten të pathyeshëm, sepse mbajmë me vete ndërgjegjen e popullit. E ç'të them tjetër!

Heshti. Ata që dëgjonin vunë re se ai shtrëngoi buzët nga dhimbja e fortë.

— Më pëlqen arsyetimi yt, — iu përgjigj flokë-verdhi, ndaj më vjen edhe keq që ne ndryshkemi këtu, në një kohë kur shokët... .

Nuk e mbaroi mendimin. Psherëtiu dhe ktheu kokën nga muri. Zeshkani s'e trazoi. Të gjithë heshën. Ndërkaq u hap porta. Sollën një të plagosur.

— Vdekje fashizmit, shokë! — përshëndeti i por-saardhuri dhe iu kthyte infermieres me një zë basi pak si të çjerrë:

— Hajde ti, bijë e babait, hiqmi këto kocka të thërrmuara, se po më bezdisin shumë! — Pastaj, me sytë drejtuar nga ne, vazhdoi:

— Qenat! Le të trembin galat atje ku mbeten! U bëftë mirë karikatorja shpinës! Oh, s'besonin se ky krahu im qëllon mirë edhe i thërrmuar! A. pa. pa, sa dhëmb i shkreti!

U shkoi një herë dorën e shëndoshë mustaqeve bigë të drejta dhe na pyeti të gjithëve:

— Po si jeni, o trimat e babait?

— Mirë, — i thamë ne.

— Mirë jeni vërtet, na e ktheu. — Dhe prapë i vajti gjuha tek i dhimbte dhëmballa:

— Oj, që thoni ju, na del birboja në mejdan dhe krekoiset si kaposh deti. Kujton se hamë bar ne flokëthinjurit!,

Ai shau ndyrë dhe për minuta të tëra s'pushoi së përsërituri atë që i kishte ndodhur në përpjekjen me nazistët. Të tjerët sikur u lehtësuan. Plaku ua hoqi mërzitjen. Ai bënte durim aq shumë, saqë nuk nxori asnjë ofshamë, kur i mjekuan krahun e dërrmuar në bërryl.

Kaloi kështu një copë kohë. Pastaj të dy shokët

nisën përsëri bisedën e këputur në mes. Flokëverdhë foli i pari:

— Me të vërtetë, shumë e fuqishme është shoqëria jonë partizane. Ajo i ngjan një kështjelle, që i qëndron edhe artilerisë më të rëndë.

Pastaj ai e shikoi shokun me bisht të syrit. Zeshkani buzëqeshi lehtë.

— Thonë se miqësia është si vera. Sa më shumë vjetërohet, aq më e fortë bëhet; prandaj më mirë një mik i vjetër, se dhjetë të rinj.

— Kjo mund të jetë e vërtetë për miqësinë në kuptimin borgjez të fjalës, — ia ktheu tjetri, — po në luftën tonë është ndryshe. Unë them se miqësia partizane do një përcaktim tjetër. Ju keni dëgjuar ndoshta të thuhet se miqtë, që ke fituar në lumturi, mos i kërko kur ke rënë në mjerim; ndërsa ata që ke fituar në mjerim, mos i harro në kohën e lumburisë sate. Pra, ne partizanët jemi të gjithë miq e shokë për kokë, në ditë të mira e të këqija. Japim jetën për njëri-tjetrin.

— Shiko, mor vëlla, — ia ktheu tjetri. — Me këto që thua, të kuptoj shumë mirë.

— Lumturia, thonë, e bën njeriun të fitojë shumë miq, kurse fatkeqësia i kalon miqtë nëpër gurin e provës. Një borgjez nuk mund ta kuptojë lumturinë siç e kuptojmë ne. Ai nuk do t'u besonte veshëve të tij, po të dëgjonte se ne jemi shumë të lumtur që na takoi të luftojmë, të sakatosemi e ndoshta edhe të vritemi, që nesër të tjerët të kenë lirinë.

Si tha këto, fytyra e zeshkanit u shtrembërua nga dhimbjet. Flokëverdhë thirri infermieren.

Pas pak minutash atë e zuri gjumi. Shoku ndezti një cigare dhe ndenji një copë herë duke e shiku-

ar. Sa më shumë bisedonte me të, aq më tepër e done. I pikonte në zemër ai djalë aq i zgjuar e i vendosur, që e përballonte të keqen me një durim të çuditshëm. Ai flinte dhe trupi i dridhej lehtë herë pas here. Pastaj filloi të lëshonte ca si psherëtima të mbytura. Iu kujtua ajo ditë, kur qe detyruar të vinte dorë në këmbën e tij të djathtë. Atëherë i kishin treguar se si dy ditë më parë partizanët ishin përleshur keq me nazistët. Kishte vajtur puna gjer aty, sa të luftohej fyt më fyt, në një kohë kur dëbora e imtë, përzier me shi dhe erë, të shponte sytë si me gjilpërë. Armiqtë kishin qenë tri herë më shumë se partizanët. Në atë përleshje të tmerrshme, ai qe plagosur në këmbë dhe kishte mbetur i vecuar. Shokët s'patën lënë vend pa kërkuar, por pa dobi. Dy ditë e dy net kishte zënë vend në një gëmushë të madhe, i bërë kallkan nga të ftohtët, e duke duruar dhimbje të forta. Pastaj, papritur ato i qenë fashitur. Më pas ai ishte çuditur, kur kishte vënë re ca njolla blu sipër dhe poshtë plagës.

E sollën në spital në një gjendje shumë të rëndë. Ai sapo e kishte parë, kishte kuptuar se çdo gjë fliste qartë pér kangrenë. Këmba duhej prerë, bile sa më shpejt, ndryshe i plagosuri do të vdiste. Mjekut s'i kishte rastisur asnjëherë të priste këmbë njeriu, e jo më atë të shokut dhe me çfarë, se, me një sharrë të zakonshme! Pastaj kishte ardhur çasti i vështirë, kur iu desh t'ia thoshte partizanit të vërtetët e hidhur. E ai çast nuk pati zgjatur shumë. Çdo gjë kishte ndryshuar si me magji. Mjeku qe çuditur, kur ai djalë aq i ri e pati pritur verdiktin si një të keqe që, vërtet ndodh rrallë, por kur të kap, gjëja më e mirë është të mos çash kokën. «Një këmbë e prerë s'është hicgjë para kokës së humbur.»

Ai i kishte thënë këto fjalë me një ftohtësi stoike. Sytë e tij të shkëlqyeshëm e që lëshonin xixa i patën dhënë zemër mjekut, po, kur sharra kishte prekur Këmbën, balli i doktorit flokëverdhë që mbushur me bula djerse të ftohta. Ishte përgjegjësia për jetën e shokut, që bënte të sajën. Pasi mbaroi këtë punë të padëshiruar, kishte thënë ato fjalë, që i përsëri ste aq shpesh: «Ky djalë nuk duhet të vdesë.» Dy ditë më vonë i plagosuri i kishte dhuruar një fotografi. Një djalosh, që po i ngjitej kodrës, qeshte me gjithë zemër, duke shikuar nga aparati. Duke parë fotografinë, atij i erdhi keq që këtej e tutje ai nuk do t'u ngjitej më kodrave. Pastaj punët qenë ngatërruar dhe ai nuk kishte mundur ta niste thellë, në prapavijat e sigurta.

Lufta qe afruar shumë shpejt. Shtëpitë e fshatit, me kanatat e dritareve të puthisura mirë, ngjani si fortesa të vogla të shpérndara e të braktisura. Njerëzit qenë larguar. Më të rrallë dukeshin ca plaka e ciliminj. Të tjerët luftonin larg. Spitali partizan qe vendosur në mes të fshatit. «Njëlloj si ky, ku jemi, — tha me vete flokëverdhë, — veçse atëherë unë isha mjek, kurse tanis...» Ai mori frymë thellë dhe humbi prapë në mendime e përfytyrimë, që lidhesin më atë që kishte ndodhur.

...Pati hapur portën, i qe afruar shfratit të fundit dhe kishte qëndruar ca, duke shikuar të plagosurin. Lajmi për të zbrazur spitalin qe vonuar, sepse korrierët kishin rënë në përpjekje. Në një qoshe, mbështetur pas murit, ishte një vig, që dukej sikur priste radhën për të shërbyer. Përnjëherë ishin dëgjuar të shtëna pushkësh dhe automatikësh. Pastaj qenë futur brenda dy partizanë. Njéri nga ata i kishte thënë:

— Shpejt, doktor, nuk keni kohë, do t'ju kapin gjermanët! Ç'prisni!? Nisuni!

Kështu kishte filluar largimi i të plagosurve. Zheshkani më këmbë të préfë e pati vështruar në një mënyrë të çuditshme, kur ai e kishte urdhëruar për t'u nisur. Edhe tani e kishte para syve atë buzëqeshjen e hidhur, që e pati shoqëruar me fjalët:

— E keni kot, doktor. Kështu, siç jam, ju e kuptoni së është më mirë të mos rrezikoni më shumë. Ikn! Dhe kur të dëgjoni pushkë e bomba, dijeni se unë e kam kthyer këtë shtëpi në një kala të vogël. Kjo do të jetë gjithçka që mund të jap në këtë gjendje.

Për një çast vështrimet e tyre qenë kryqezuar, pastaj biseda ishte mbyllur me fjalët e doktorit:

— Jo, jú do të vini me nè, ky është urdhër!

Predhat e artillerisë kishin nisur të binin në fshat. Të plagosurit qenë larguar njëri pas tjetrit. Zheshkanin e patën marre me barelë ai dhe një partizan. Në krye të fshatit kishin flisur luftimet...

Në dhomë sollën një të plagosur dhe atij iu këput filli i mendimeve. Ishte një vajzë shumë e rë. Plumbi i kishtë goditur në faqë, duke i hapur një plaqë të llahtarshme. Ai e kuptoi se ajo nuk do të vdiste, megjithatë i erdhia aq keq, sikur të ishte mrotra. Atë e vuinë në shtratin pranë atij të zheshkantit. Duke kaluar vështrimin herë nga njëri e herë nga tjetri ai ndjeu një brëngë thellë në zemër. Pastaj shikimi i tij u ndal gjatë te shoku dhe nisi të riprodhonte të gjitha ngjarjet e asaj mbrëmjeje si dhe ato që i treguan të tjérët.

...Ata echnin në një monopat të ngushtë, rrrethuar nga të dyja anët me marrë. Degët e tyre u përplasejhin në fytyrë. Vendì vinte sì më të tatëpjetë. Parti-

zani ecte pérpara. Ai ishte më i fuqishëm. Barela rëndonte shumë. Këmbët nuk donin t'u bindeshin. U dukej sikur kishin bërë goxha rrugë, kurse në të vërtetë s'qenë larguar shumë. Papritur, fare afër u dëgjuan pushkë. Ata ndaluan. I plagosuri nuk deshi të shkonte më tutje. Në mes të të thirrurave të tij pér ta lënë aty, ata bënë edhe ca rrugë nëpër një si kreshtë, që binte në një përrua të thellë. Pastaj qëndruan. Vendosën që partizani të hapte rrugën. Pas pak u dëgjua një e shtënë pushke dhe një breshëri automatiku. Të dy u lëshuan pérpara. I plagosuri tërhiquej zvarrë, duke u mbajtur te doktori, po më tepër rrëshqiste këmbadoras. Shoku i tyre qe ndeshur me një skuadër nazistësh. Kishte qëlluar i pari. Pastaj e kishin vrarë. Më tutje qe shtrirë armiku me një plumb në zemër. Një pér një. Partizani dukej sikur flinte. Asnjë mundim nuk shprehte fytyra e tij e qetë. Nuk patën kohë të merreshin me të, sepse menjëherë krisën pushkët. Skuadra naziste u përpoq me dyshen partizane. Çdo gjë ndodhi me një shpejtësi të rrufeshme. Pas pesë minutash, po të kalonte njeri në atë vend, do të shikonte shtatë kufoma ushtarësh nazistë. Dy nga ata kishin marrë nga një plumb në ballë. Tre të tjera, qëndronin gjysmë të mbështetur në ledh, me sy të zgurdulluar, mbytur në gjak. I gjashti kishte parë lemerinë. Në fillim kishte zënë barkun me dorë. Pastaj ishte pérpjekur të shtrëngonte diçka. Kishte dhënë e kishte marrë, po më në fund vdekja i qe qasur pranë. Ai e pati ndier afshin e saj në tërë qenien e tij. Kishte dashur të thërriste. Ishte pérpjekur të largonte një degë mareje, që i dukej se nuk e linte të vështronë diku në hapësirë, po pastaj çdo gjë qe errësuar në sytë e tij. Buzët e thara nuk patën më fuqi të pérplaseshin dhe dy pikë

lotë ngrinë në faqet e zverdhura. Pastaj kishte rënë nata dhe, kur të plagosurit e fundit po rregullohe-shin në dhomën ku tani ndodhej edhe ai vetë, ja-shtë ishte dëgjuar zëri i komandantit, i cili ngarkonte me detyrë një skuadër partizanësh. Ajo kishte filluar të kontrollonte vëndin pëllëmbë pér pëllëmbë. Partizanët, të shpërndarë në formë harku, lëviznin përpara, djathtas e majtas. Ata ngjiteshin, zbritnin, futeshin nëpër gëmusha, përgjonin. Kudo vetëm zhurmë e lehtë pylli. Njëri nga ata kishte parë një hije njeriu. I qe afruar dhe kishte dalluar armikun. Nuk e pati prekur fare kufomën. Më në fund ky hark partizanësh kishte dalë te pérroi. Gjithnjë po ajo he-shtje, që kishte me vete një frymëmarrje të vështi-rë pér fatin e shokëve. Partizanët kishin ndier një dhimbje, që bëhej edhe më e thellë në errësirën e asaj nate, në pyllin ku lufta kishte lënë gjurmët e saj.

I patën gjetur të dy, mbështetur në një trung peme. Formonin një barrikadë të pjesshme. Pér të kaluar andej, armikut do t'i duhej t'u bënte ballë pushkëve të tyre. Doktori merrte frymë me vështi-rësi. Nga cepat e búzëve i dilte një si shkumbë e bardhë. Njérën dorë e mbante në gjoks. Një njollë e kuqe gjaku dukej mirë në xhaketën e tij të shkurtër ngjyrë gri. Fare pranë qe shtrirë sa gjatë-gjerë një alamet ushtari nazist. E kishte vrarë zeshkani në çastin kur shokun e patën lënë fare forcat dhe kur ai derr i fëlliçur po matej t'i ngulte bajonetën në fyt. Atëherë tërë karikatori i revolverit qe zbruzur në gjoks dhe ai goxha trup ishte shembur pjerësisht mbi doktorin, i cili kishte bërë përpjekje të mëdha pér t'u çliruar nga ajo barrë e padurueshme. Ky ki-

shtë qenë i shtati nazist i skuadrës. I fundit kishte ikur nga sytë-këmbët. . .

Doktori mori frysme thellë dhe ndezi një cigare tjetër. Zeshkani çeli sytë dhe e shikoi duke buzëqeshur. Kujtoi «grindjen» rreth rëndësisë së thelbit e të nuancave të shoqërisë partizane. Miqësia e tyre do të mbetej gjithë jetën.

D E N I M I

Ajo ishte një natë mjaf e ftohtë. Brenda asaj shtëpie të vjetër, ku era hynte e dilte nga të donte, nuk ngroheshe lehtë. Zjarri kursehej sa edhe buka. Varfëria binte në sy sapo hyje në portën e madhe, të «arnuar» me dy copa të gjera dërrasash, mbërthyer ngutshém te të tjerat. Ajo dukej edhe te zbratzëtia që përfshinte çdo gjë e që të ngjallte keqardhje. Tri shkallë të gërryera në mënyrë të çrregullt të ngjitnin të hajati i ngushtë, përbri të cilit ndodhen një nje dhomë e një kuzhine. Në të parën qenë shtruar dy hasra me fije të dala, sipër të cilave qëndronin ca rripa qilimash të grisur, po të pastër. Në njérën faqe muri, dy karrige të vjetra dukej sikur ruanin të mos rrëzohej dollapi i nxirë nga kohë. Në tryezën e zbërdhylur, së cilës s'ia përcaktoje dot ngjyrën që kishte pasur, lëshonte një dritë të zbehtë llambë më vajguri. Kuzhina nuk kishte gjë tjetër, përveç ca enëve dhe një minderi të vogël. Kjo qe e tërë «pasuria».

Atë natë, në dhomë qenë mbledhur njerëz. Ishin të gjithë të rinj. Po t'i shikoje mirë, të dukej sikur nuk e ndienin fare të ftohtët. Të kuqtë e faqeve

nuk ua jepte mosha, por puna me të cilën merreshin, pesha e përgjegjësisë që kishin mbi supe. Ata përbënин njérën nga celulat e Partisë.

Te porta e jashtme dukej herë pas here koka e një gruaje të thyer, me pamje edhe më të moshuar nga ç'ishte. Pasi hidhte shikimin andej-këndeja, ajo futej brenda oborrit, në rrugicën e shtruar me kall-drëm, zinte vend në krye, të shkallëve dhe përgjonte me veshët ngritur çfarë ndodhët rrëth e rrötull shtëpisë. Ishte gjyshja e Bekimit, e njërit prej dhjetë komunistëve, që ishin mbledhur aty si shumë herë të tjera. Ai që drejtonte mbledhjen që një djalë trupngjeshur, fytyrërrumbullakët, me ca vetulla të trasha e të zeza dhe me sy të mëdhenj e të ndritshëm.

Në fillim lexoi një letër të Qarkorit të Partisë, të firmosur me pseudonimin e njohur. Të gjithë i përpinin fjalët e saj me etje të madhe. Ajo përmbanë porosi të rëndësishme. Pastaj ata folën me radhë për detyrat që u dilnin nga porositë e asaj letre.

— Ju e dini, shokë, — vazhdoi ai që kishte lexuar letrën, — se ne kishim ngarkuar Seferin të merrëj me punën e Maksutit. Rrëth kësaj tanë kemi të dhëna më të plota, ndonëse edhe më parë qemë të një mendimi për ta hequr qafe atë. Dhe shokët më lart e quajtën të drejtë vendimin tonë. Pra, na mbetet ta zbatojmë.

— Kam një kërkësë, — tha njëri prej tyre.

S'u mor vesh ç'kërkonte ai që foli, se në dhomë u dëgjuan shumë zëra përnjëherësh. U bë një lloj «rrëmuje». Sekretarit iu desh të ndërhynte. Te dera u duk gjyshja e Bekimit. Ajo vuri gishtin tregues mbi buzët dhe doli përsëri.

— Unë e kuptoj përsë e bëtë këtë gabim! — foli sekretari.

Shokët po e shikonin drejt syve. Ashtu siç e kishte zakon, ai i tha ato fjalë me një buzëqeshje të lehtë e pa zemërim. Vërtiti lapsin dy-tri herë nëpër duar, ndali vështrimin te dy nga shokët e pastaj shtoi:

— Kam edhe unë të drejtë të kërkoj të flas i pari, apo jo? Propozoj që aksionin ta bëjnë këta shokë: Yzedini, Bekimi dhe unë. Si thoni?

Përsëri e ndërprenë me zhurmë.

Sekretari e kuptonte thellë pse bënин ashtu. Qenë dëshirat e tyre dhe ndjenjat e mira që i shtynin. Ai i la të bënин përsëri një «rrëmujë» të vogël. Atij i vinte keq që s'ua plotësonte dot dëshirën të gjithëve, po tre vetë ishin mjaft. Pasi kaloi edhe «rrëmuja», çështja u quajt e vendosur. Plani i vëprimit u la përt'u studiuar më me hollësi nga tre shokët që e morën përsipër. Pasi të diskutohej prapë në mbledhjen e celulës, ai do të zbatohet pa kaluar shumë ditë. Ndërkaq, u hap dera. Plaka u bëri shenjë të largoheshin shpejt nga dalja e fshehtë. Ajo kishte vënë re diçka të dyshimtë në rrugë. Pas dy minutash, në shtëpi s'kishte më njeri. Si kaloi rreziku, ata u mblodhën prapë e vazhduan mbledhjen duke kaluar në pikën e dytë e të tretë të rendit të ditës.

* * *

Në rrugën që të conte në të dalë të qytetit, ndodhej një pijetore. Të shtunave, në një shesh të vogël përballë saj bëhej tregti me lloj sendesh. Disa nga njerëzit, pasi shitnin e blinin, kthehen në kafe.

Até pasdite pijetorja ishte mbushur plot. Të gjitha tryezat qenë të zëna. Disa rrinin më këmbë pranë banakut. Në cepin më të largët ishin ulur tre vete. Njëri nga ata binte menjëherë në sy. Dukej që e vriste ca si lart. Në brez mbante ngjeshur një nagant të ri. E kishte vënë enkas në një mënyrë të tillë që tia shihnin të tjerët. Sytë e tij qenë të ndritshëm, hunda e drejtë, faket të mbushura. Dy burrat e tjerë, që i bënnin shqëri, ishin të njoftuar të vjetër në mes tyre. Ata pë vrisnin mehdjen si të shkëputeshin prej tij; mirëpo ky që e vriste lart i kishte gozhduar me fjalë, duke dërdëllisur pà pushuar e duke bërë herë pas here si padashur ca lëvizje, ku shquhej frika se mos ata të dy ia vdhni mendimet që ruante fshehur thellë në zemër. Prà, vërehej lehtë se kësaj here ishte edhe në qejf, edhe në hall. Ishte në qejf se i kishin ngarkuar një detyrë të re si shpërblim për një shërbim që u kishte bërë padronëve të tij; ishte edhe në hall sepse dy të tjerët, me të cilët po bisedonte, nuk duhej të kuptohin asgjë. Cigaret, që i ndizte njëren pas tjetrës, s'po e ndihmonin të ishte vëtem në qejf.

Erdhi një çast që ai i harroi dy të tjerët. Heshti, picërrroi sytë e tij të vegjël dhe humbi në atë ngjarjen e frekët, që kishte ndodhur një natë më parë.

* * *

Në zyrën e ngrontë të Gestapos, shefi po shfletonte ca letra në një dosje të trashë. Dukej i kënaqur. Cigarja e ndezur lëshonte rrathë të dëndur tyimi, ndërsa kolltuku, tek qe ulur, lëkundëj para-pra-

pa. Në dhomën ngjitur u dëgjua zilja. Kapiteni, që shërbente edhe si përkthyes, trokiti lehtë e si gjithnjë me druajtje, po kur hyri brenda u qetësuat. Zotëri është në humor të mirë. Goja e kapitenit, që rrinte në qëndrim gatit, u hap vesh më vesh. Ai shqiptoi me zë të lartë:

— Hajl Hitler!

Shefi i bëri shenjë të ulej, i zgjati paketën e cigares dhë i tha:

— Po e shoh se keni gjetur një njeri të aftë e me përspektivë! E kam fjalën pér agjentin numër 3. Jam i kënaqur nga puna e tij e gjertanishme. Informacioni që na dha na çoi në gjurmët e dy komunistëve të rrezikshëm. Njërin e kapëm, Tjetrin ende jo. Në shpëtoi. Sidoqoftë, falënderojeni nga ana ime dhe mos kursemi në kësos rastesh! Ngarkojeni me detyrën pér të cilën biseduam! Më duket se ka ardhur koha.

— Urdhri juaj do të zbatohet menjëherë, — iu përgjigj kapiteni dhe kërkoi leje të largohej.

— Pa dale njëherë! — foli shefi i Gestapos. — Ke mundësi të ma sjellësh këtu, të shkëmbëj dy fjalë me të rreth çështjes që biseduam?

— Si urdhëron, zoti major!

— Shumë mirë atëherë. E pres nesër në orën njëzet e tre. Besoj se është kohë e përshtatshme.

Të nesërmen, në orën e caktuar, agjenti numër 3, i cili, kuptohet, ishte njeriu që e vriste lart, u gjend në zyrën e shefit të Gestapos. Hyri nga porta e pasme, nëpërmjet një rrugice të ngushtë e të errët, ku ishte e ndaluar të kalonin banorët e qytetit. Me porosinë e kapitenit, agjenti ishte veshur mirë, po

rrobat s'i rrinin hijshëm. Po kështu edhe kasketa. Ajo ishte e vogël për kokën e tij. Shefin e Gestapos nuk e kënaqi pamja e jashtme e agjentit, ndonëse ai nuk i gjykonte të tjerët nga «guna». E priti siç e kishtë zakon të priste ata që nuk ishin intelektualë, rëndë dhe ftohtë.

Maksuti — agjenti numër 3 — iu afrua ngathët dhe i zgjati dorën pa gjallëri. Shefi u koll dhe nxori shaminë nga xhepi. Agjentit i mbeti krahu shtrirë përpara. U zbeh dhe e uli si vjedhurazi. Kapiteni ndërhyri pak si me vonesë. I afroi Maksutit një karrije dhe vetë qëndroi në këmbë. Shefit i ra në mend t'i zgjaste agjentit paketën. Ai nuk priti që Maksuti të ngrihej. Cigarja e nxjerrë paksa, të cilën agjenti s'arriti ta kapte, ra në tokë. Kapiteni bëri një lëvizje të pakuptueshme, sikur deshi të thoshte se edhe këtu diçka nuk shkoi mirë. Maksuti u zverdh, u ul mbi gjunjë, mori cigaren dhe falënderoi me një buzëqeshje që ngjante më tepër me një ngërdheshje të pështirë.

Pastaj nisi një bisedim me pyetje e përgjigje. Kapiteni përkthente me një gjallëri pak si të shtitur dhe ndiqte me shkathtësi gabimet e vizitorit të papërgatitur për takime të këtij niveli. Atë natë atij i ngarkuan një detyrë të rëndësishme: të sillte në shteg një «gjah» të majmë. Për këtë i premtuan një shumë të madhe të hollash, madje edhe një pushim në një vend klimaterik jashtë shtetit. Para se të largohej, kapiteni i rrahu agjentit shpatullat. Maksuti do të donte që këtë gjest dashamirës ta bënte shefi, por ai s'lëvizi fare. Kur po largohej, agjenti nuk guxoi t'i afrohej atij e t'i zgjaste dorën. Shefit i ra në sy kjo gjë. Prandaj ia dha dorën agjentit me një farë

buzëqeshjeje. Maksuti përshëndeti shumë herë me kokë e me trup dhe doli.

Ja, kjo ishte ngjarja e freskët që e bëri Maksutin të përhumbet për një copë herë.

* * *

Jashtë kafenesë u dëgjua një britmë. Disa kthyen kokën. Maksuti u shkëput nga mendimet. Dy shokët e tij deshën të largoheshin, po ai s'i la. Pas një bisede të shkurtër, filloi përsëri të kujtonte skenën në zyrën e shefit të Gestapos, pastaj edhe se ç'kishte dëgjuar të flitej për të nga gojët e këqija në atë qytet ku ai kishte ardhur. Në qytetin e ri, ku pati ardhur ai, kishte thurur bukur legjendën, sipas së cilës qe detyruar të vinte aty nga frika se mos e viste hasmi i vet, i cili e ndiqte këmba-këmbës, ndaj mbante edhe revole. Veç këtyre iu kujtua edhe se si kishte shpëtuar pa u pikasur për qime një mbrëmje, kur pati dyshuar për një mbledhje kundër regjimit dhe pati lajmëruar padronët e huaj. Më tej u bë ner voz, kur solli ndër mend se si e pati ndjekur një komunist, një djalë i vogël, që mbante në dorë diçka të zezë, si brovnik. Kur qe futur në atë portën gjysmë të hapur të një hoteli të kategorisë së fundit, i ishte zënë fryma fare. Pastaj kishte ardhur më e madhja. Ashtu duke gulçuar e pati ndalur vështrimin në një pikë të caktuar, përmes errësirës, që e rrëthonte. Atë çast kishte parë fare afër dy sy të ndritshëm, që e vështronin me ngulm. Jashtë qenë dëgjuar zëra. Ai kishte çuar dorën te revolja, duke mos i hequr sytë nga ai tjetri. Pas pak kishte bërë një lëvizje si pa dashje dhe ata sy që e vështronin s'u panë më. Më pas diçka pati lëvizur nëpër trarët

ë vjetër e prapë qe trembur. Atëherë ai e pati sharë rëndë veten, sepse për herë të parë në jetën e vet pati ndier si i qe njollosur trimëria.

Te porta e lokalit u përplas një i dehur. Maksuti porositi edhe tri gota raki. Kur e rrëkelleu të tijën, dy të tjerët vunë re se atij iu drodh pak dora. Njëri nga ata të dy nisi të tregonte, gjoja rastësish, se si kishin vrarë një spiun në Vlorë, midis pazarit e në mës të gjermahëve. Duke follur, ai e zbuluronte ngjarjen e vërtetë si tregimtar i talentuar. Maksuti filloi të lëvizte në karrige. Më pas nuk duroi e ia priti:

— Shumë po ná dërdëllis. Përralla më mbret, ja q'po ná thua! Shko e gënje më mirë ndonjë fëmi-jë, së burrat s'i hanë këto dëngla! Derisa janë gjermanët, nuk është aq e lehtë të vritet njeriu asisoj.

Ai bëri sikur rregulloi pantallonat. Të tjerët e panë t'i dukej më mirë nagafti.

— Ofe Maksut, kot e kë që ngul këmbë! — e mori fjalën përsëri i pari. — Ti nuk i njeh mirë komunistët. Jänë cä ata, që! . . . S'e kanë në hesap jetën, e di apo s'e di? Ja ku po ta them unë! S'ua bëjnë të gjatë spiunëve. I qërojnë.

Maksuti u zverdh. Tëmihat filluan t'i rrithnin fort. Krimbi i pasigurisë kishte kohë që e brente pak e nga pak. Duke kündërshtuar, ai hiqej sikur s'i bëhej vonë nga ato që dëgjonte, ridonëse ndiente se fjalët e dy të tjefëve e shtypnin si një peshë e rëndë. Maksuti dörte të çlirohej, të merrte frymë më li-risht, po lokali i dukej si shumë i ngushtë e sikur i mungonte ajri. I bëhej sikur thellë në zemër diç e torturonte e sikur në kokë e qëllonin me hekur. Ata të dy, që rrinjan bashkë me të nuk dinin asgjë për shërbimet e tij ndaj pushtuesve të huaj. Megjithatë, spiuni i vështronë më mosbesim e me një lloj inati

të përmبajtur. Mendonte se edhe ata mund të ishin fshehës, mbrojtës e strehuës të komunistëve.

Në rrugë kalonin shumë njérëz. Bëhej zhurmë e madhe. Ishë dite pa zari. Në kafene hyjnë e dilnin çdo minutë. Ty mi i duhanit ngrihej si re dëri në tavanc. Një klient grindëj me kamerierin. Një tjetër shante më zë të lartë rakinë e keqë dhe kafenë si lëng gështenjash. Papritur në derën e lokalit u duk dikush. Në kokë kishte rrasur një kasketë të errët. Mustaqët e holla i ishin ngritur përpjetë nga të ftohtët. Sapo hyri brenda, qëndroi në vend, futi duart në xhepat e xhaketës dhë hodhi vështrimin nga një tryezë të tjera. Kur shikimi i tij hasi tek ata të tre, Maksuti ndjeu diçka si frikë. I porsaardhuri i panjohur, pasi ferkoi mjekrën e pafruar, lëshoi hapin e gjatë e të rëndë në drejtim të tyre. Agjenti ndoqi me kujdes lëvizjet e tij. Dorën e çoi te revolja. Tjetri iu afrova banakut, mbështeti bërrylat në të, porositi një gotë raki dhë papritur u kthyë përgjysmë nga ata të tre. Ia nguli sytë mirë Maksutit dhë rrëkelleu me një frymë gotën e rakisë. Para se të largohej, e vështri i rishtas Maksutin dhë kaloi përmes lokalit si furtunë. Agjentit i mbeti mendja tek ai njéri i patjohur e i çuditshëm. Ç'kishte pasur me të dhe pse ia kishte ngulur sytë ashtu?! Kujtoi ato që i patën treguar pák më parë dy të tjerët dhe u shqetësua. Deshi ta mbyste shqetësimin me raki. Porositi tri dopio. Pashqit nisë një bisëdë për çështje të rëndomta. Kjo sikur e lehtësoi ca. I pëlgente të dëgjonte qoftë edhe gjëra krejt boshe, veçse të mos kishin lidhje me të papritura të frikshme. Bëfas jashtë lokalit plasi një potere e madhe. Dy të rinj, me berëta vënë përbësi, u futën brenda në lokal e zunë vend në një tryezë që sapo u lirua. Porositën verë dhë mëze. Mak-

suti filloi të ndiqte bisedën e tyre. Edhe ata flisnin për ngjarje që ai nuk donte t'i dëgjonte. U përpoq ta largonte mendjen prej tyre dhe e çoi dorën në çast tek arma. Njëri nga dy djemtë i ra me bërryl pjatës e ajo sakaq u bë copë e thërrime në dyshemenë prej çimentoje. Maksuti tha me vete se rakia ia kishte dobësuar nervat. U përgatit të paguante. Done të largohej sa më parë dhe të mendonte në qetësi për detyrën e re që i kishin ngarkuar. Ai qeshi nën hundë me këtë dobësi të nervave. Rregulloi pantalonat dhe thirri kamerierin. Ndërkokë u hap dera dhe brenda hyri një fshatar i shkurtër nga trupi, po i shëndoshë, fytyrërreshkët me sy të mëdhenj të zinj dhe me mustaqet sterrë. Në kokë mbante një qeleshe të përdorur prej kushedi sa kohe. Maksutit iu duk fshatari qesharak. Filloi të buzëqeshte. Por, për çudi, ai që hyri nisi të ecte drejt tij. Kur iu afrua dy hapa, qëndroi një çast dhe bëri një lëvizje të vetëtimshme. Maksuti nuk pati kohë as të mendonte dhe as të bënte ndonjë veprim. Një zë i fortë gjëmoi sakaq në tërë lokalin. Të gjithë dëgjuan shkoqur:

Në emër të popullit...

Pas këtyre ushtuan tri të shtëna revolveri. Një karrige kërciti fort nën peshën e trupit të rëndë të Maksutit, që u plas si thes me bajga. Koka iu var anash, sytë i rrotullonte me llahtar, e vëtmja shenjë që tregonte se ende s'kishte vdekur mirë, dhe atë kohë naganti iu rrëzua nga brezi e rrëshqiti paksa në çimenton e dyshemesë.

Qetësia e shkurtër që u bë pas tri krismave u prish. Fshatari me trup të ngjeshur, që ngjante si dy pika uji me sekretarin e celulës, tashmë ishte languard. Të parët që ikën me të shpejtë pas tij nga lokali qenë ata të dy që rrinin bashkë me Maksutin.

KOVAÇI FETI JONUZI

Dimër i vitit 1944.

Natyra shfrynte me mlefi. Rrapëllima e përroit të fryrë nga shirat përplasej brigjeve të thepisura. Era e marrë fshikullonte si me kamxhik. Bubullimat gjëmonin fuqishëm, ndërsa drita verbuese e shkrep-tinave gjarpëronte përmes territ pa pushim. Në qinellin isterrë retë ecnin me shpejtësi. Në udhë kalo-nin katër njerëz. Tre ishin ushtarakë, një kapter eses, nazist, një ushtar dhe një ballist, i veshur edhe ai si eses gjerman. I katërti ishte civil, pa xhakëtë, me një këmishë të çjerrë copë e çikë, nëpër të çarat e së cilës dukeshin në kraharor e në shpatulla vija të kuqe gjaku të mpiksurt. Tre të parët këtë të fundit e kishin vënë në mes, me duart lidhur me pranga dhe ecnin të nxituar.

— Luaj këmbët, derr i ndyrë! — i gérthiste kap-teri eses civilit kur ai pengohej sepse, ngaqë duart i kishtë në pranga, mezi e mbante' ekuilibrin dhe për-plasej kohë pas kohe sa para, djathtas e majtas.

Civili në pranga nuk e dinte se ku po është ato egëfsira nëpër atë ki amet. Megjithatë ai ishte i qetë. Fytyra e tij me njolla të zeza të buhavitura e ca rre-pila gjaku tregonte se asgjë nuk e kishte trëmbur

gjer atë kohë e asgjë nuk do ta përkulte edhe më pas. Ky qëndrim i tèrbonte edhe më keq pushtuesit gjer-manë e këlyshët e tyre vendës.

Tufani që frynte filloj të bëhej më i fortë e të angullinte, duke u përplasur majave e shkrepave. Civilit në pranga, kovaçit Feti Jonuzi iu kujtua se kështu kishte fryrë era edhe atë natë, kur i patën hapur portën e vjetër të farkëtarisë së tij tri javë të shkuara dhe i patën hyrë brenda njerëz të armatosur. Ai nuk kishte luajtur nga vendi. Esesët ia kishin bërë lesh e li çdo gjë, ia kishin thyer e shkallmuar ato vjetërsira që kishte, dhe pastaj e kishin çuar në postëkomandë. Atje e torturuan me ç'u erdhi ndoresh. I thanë se e dinin që ishte komunist dhe se e kishin njohur edhe gjatë përpjekjes që ishte bërë buzë përroit. I kërkuan të tregonte shokët, bazat e partizanëve.. Por ai mohoi. Ditën tjetër i kërkuan përsëri të pohonte se ishte komunist, se ishte i lidhur me partizanët ... Po ai prapë heshti. Vazhduan kështu ta torturonin me egërsi edhe më pas. Oficeri eses Toger Hansi, që kishte marrë përsipër t'i zbërtente gojën, qe çmendur përpara qëndrimit të vendosur të këtij njeriu, që i dukej sikur nuk ishte prej mishi e kockash, po prej guri, prej geliku.

— Fol, mor qen, fol! — ulërinte ai duke kërcitur dhëmbët si bishë dhe nxihej i téri në fytyrë nga gjaku që i hipte në kokë.

Më në fund oficeri eses e urdhëroi kapterin të merrte edhe një ushtar, tradhtarin vendës, që u bënte edhe punën e përkthyesit dhe ta shpinin kovaçin te vendi ku qe bërë përpjekja. Atje, buzë graminës, ta kërcënënonin: O të tregonte gjithë ç'dinte, ose përndryshe do ta hidhnin prej andej të gjallë, të bëhej copë-copë, pre për korbat e egërsirat.

Në qoftë se nuk do të trembej edhe nga ky kërcënëm, atëherë do t'ia kthenin prapë oficerit nazist të Gestapos. Ai do të dinte vëtë pastaj si të bënte. Edhe mishin më gërshtërë do t'ia grinte cika-cika. Nuk do ta vriste më plumb, sepse vdekja nga plumbi në kësoso rastesh, kur kishe të bëje më njerëz tepër të rrëzikshëm, ishte shpëtim, ishte falje.

Tek eçnin nëpër natë, te një kthesë e vogël, atje ku përroi kalonte në formë bërryli, farkëtari u kujtua si i pati rënë një arkë me fishekë. Atëherë ai qe shumë i fuqishëm. Por kjo nuk pati ndodhur as para një viti e as para gjashtë muajve. Kishin kaluar prej asaj dite vetëm tri javë. Ai e kishte hedhur arkën mbi kurriz e i dukej e lehtë, sikur të kishte brenda digka tjetër, e jo plumba e barot. Ishte mbështetur përmjë gast pas një ledhi dhe kishte hapur zjarr mbi armiqë të që përpipesbin të kalonin nëpër zall. Iu kujtuat e tërë beteja. Kur pushtuesit gjermanë po mundoshin tu merrnin krahët partizanëve përmë të rrethuar atë dhe shokët e tij, të cilëve po u çonte fishekët, ai kishte vrarë katër prej tyre është nuk i kishte lënë t'ia arrinin qëllimit.

Në një vend kovaçi u pengua befas në një gurtë lëpirë. Ballisti i futi një shkelme iu kërcënuat:

— Hë, qen bir qeni, folë pse nuk tregon!?

Feti Jonuzi e pështyu në fytyrë.

— Kam folur unë, — i tha, — qen je ti, kërmë, ndyrësirë, tradhtar!... Të gjitha do t'ia paguani, ti, dhe zotërinjtë e tu, që të hedhin nga një kockë sa përmë të të zënë sytë!

Tek e dëgjoi kapteri nazist, e thatiq, me atë fytyrë të ngrysur, ku çdo fije muskuli i dridhej nga nervozizmi, iu afroa kovaçit dhe ia nguli sytë mirë në fytyrë. Ai u përpoq edhe një herë të zbulonte tek ai njeri i dërrmuar nga torturat se çfarë sekretesh fshihte. Eh, sikur t'ia thoshte të gjitha ato! Eh, sikur t'i mësonite! Sa krenar do të kthehej tek eprorët!

«Ky do qëlluar në lule të ballit! — tha me vete pas pak esesi. — Nuk durohet dot. Po ç'ti bëj urdhrit! ... Djallive mori! Pse më duket sikur shkojmë drejt vdekjes?»

E vështroi përsëri egër farkëtarin dhe e ndjeu më thellë si nuk e përfillte fare vdekjen ai njeri i çeliktë. Kapteri e dinte se pushka mund ta zhdukte në çast këtë rreckaman, por të dhënët që duheshin marrë prej tij do të shkonin pastaj bashkë me të në varr.

«Jo, — vazhdoi përsëri me vete, — do ta bëj të flasë. Pa tjetër! Dhe pér këtë eprorët e mi kanë besim tek unë. Ndaj më zgjodhën mua ta çoj buzë greminës. Prova të tilla kam dhënë mjaft, ndofta jo në Shqipëri, te ky vend i mallkuar, po gjetkë. Megjithatë kjo s'ka rëndësi. Të gjithë njerëzit kanë diçka të përbashkët kur arrijnë të shohin vdekjen me sy. Këtij komunisti shqiptar do t'i ngulem keq... Po sikur... po sikur të mos e hapë gojën?... Ah, ç'ti bëj urdhrit! Të mos kisha urdhrin, do ta vrisja i qetë, duke ia shtypur kokën në gur.»

Duke folur kështu, kapteri kujtoi atë vajzën kokëtrashë, që ia kishin shpënë toger Hansit pasi e kishin kapur duke ndarë trakte. Ishte shumë e re. Qëndronte në mes të dhomës e mezi mbahej në këmbë. Edhe asaj heshtja i kishte kushtuar shumë. Nuk njihej fare në fytyrë. Atë ditë togeri që tërë inat.

Komunistët kishin hedhur në erë një depo municioni. I qe afruar vajzës dhe e kishte pyetur për herë të fundit. Kërkonte të dinte kush ia kishte dhënë traktet. Ajo nuk fliste. Ai filloi të humbiste durimin. I tha duke sokëllirë se kот i kundërviheshin nazizmit. Sa mund t'i bëjë gjë boas një krimb plehu, aq mund t'i bënin dëme Rrajhut të tretë ajo e shokët e saj. Të tjerët kishin qeshur. Ai priste përgjigje. Ajo heshtte. Atëherë toger Hansi e kishte qëlluar me kërbac në kokë. Vajza qe mbytur në gjak. Ai, duke ungërdheshur, i kishte zgjatur shaminë, po kishte marrë një pështymë fytyrës. Pas kësaj togeri i kishte mbështetur grykën e revoles, në ballë dhe ata kishin parë një vrimë të vogël plumbi, pastaj një vijë të holdë gjaku; që kishte rrjedhur ngadalë e ca pika që kishin rënë në dyshemë.

Atyre s'u kishte shkuar në mendje se fill pas kësaj toger Hansi do të urdhëronte t'i sillnin atë djalin që qe kapur bashkë me vajzën. Edhe ai ishte i ri. Edhe ai e kishte fytyrën tërë blana të zeza. Togeri i qe drejtuar me ca fjalë që shprehnin besim se ai do të ishte më i arsyeshëm nga vajza, e cila nuk pati mend në kokë. Nga ky çunak kërkonte vetëm diçkë të vogël, duke i premtuar jetën si shpërblim. Por përcudi ai i ishte përgjigjur Hansit me zë të qëtë se e përbuzte atë «premtim». Pastaj kishte ardhur një e madhja. Ai djali i rrënuar fizikisht e kishte fyer rendë personalitetin e oficerit nazist. Kishte thënë se e diinte që priste, ndaj nuk kërkonte mirësi e mëshirë nga armiqtë e tradhtarët, se nuk ishte i poshtër si ata. Togeri qe tërpuar fare. Ishte matur t'ia zbrazte revolen në gojë, po kishte ndërruar mendim. Do ta dënone me një vdekje të ngadalshme vërtet, por të sigurtë.

Duke kujtuar të gjitha këto, nën oficeri skërmimi dhëmbët.

Dy herë qëndroi në vend katershja. Dy herë thanë se s'kishin pse shkonin më tutje, po përsëri nuk vendosnin. Kovaçi Feti Jonuzi me këmishi të grisur e pranga në duar kënaqëj kur ata tërboheshin. Kjo për të ishtë një lloj hakmarrjeje. Së largu u dëgjuat lehja e një qeni. Edhe ai kishte pasur një qen besnik. Ia kishin vrarë para portës së shtëpisë. Atë natë e shqoqja kishte qenë vetëm. Ajo nuk i pati parë ata që vranë qenin. Më vonë u mor vesh se këtë e kishin bërë pushtuesit armiq.

Shiu reshti. Pas pak ushtari nazist u gremis dhe lëshoi një britmë të imprehtë. Kishte thyer keq këmbën. U përpinq të ngrihej, po që e pamundur. Atëherë iu lut kapterit ta linte atje gjersa të mbaronte punë me të arrestuarin, e pastaj... Gremina nuk ishte shumë larg. Kapteri e la dhe vazhdoi rrugën bashkë me ballistik. Arriten të një e përpjétë e shkurtër pranë greminës. Qëndruan befas.

Farkëtari hodhi vështrimin tutje. Horizonti nuk shquhej. Errësira ishte e fortë. Vendi i ngushtë. Në njërin krah shpati i malit ngrihej drejt qiellit të zi. Në anën tjetër edhe pak dhe fillonte humnera. Poshtë, shumë poshtë, ushtonte rrapëllima e përroit. Një mjegull e përhime, si një pelerinë e stërmadhe, shtrihet tejembanë. Njëri prej atyre të dyve lëvizit përparrë. Pastaj u afroa të tjetri. Të dyja hijet bënë për nga honi, por shpejt i mbërrthen këmbët në vend. Ku të shkonin më tej? Veç në botën tjetër! Ballisti u kthye, e kapi të arrestuarin nga krahu dhe e tërhoqi buzë honit.

— Tani zgjidh e merr! — i tha. — O përfundo në

dreq, copë e çikë në greminë, o fol q'di dhe kthehu me ne të shpëtosh!

Farkëtari përsëri heshti. Nazisti nuk duroi e iu afroa hundë më hundë. Shkrepit çakmakun dhe ia vuri flakëzën ndën mjekër. Kovaçit i nxorën sytë shkëndija. E shtyu me tërë forcën nënoficerin në gjoks e, sa çel e mbyll sytë, nazisti fluturoi poshtë, në honin e thellë, duke garë errësirën e natës me një britmë të llahtarshme. Ballisti shtangu. Po kur pa se i arrestuari po sulëj drejt tij, u zimbrops me tmerr dhe qëlloi me pushkë. Plumbi i tij nuk goditi në shenjë. Pas atij çasti armë s'i hynte më në ptnë. Dy duar të fuqishme, indonëse të lidhura të kyjet, e kishin përfshirë përgryke. Koka iu përplas sakaq fakes së shkëmbit. Një herë... dy... tri...

Nuk vënoi e ai u gjend shtrirë gjerë e gjatë pa shenjë jetë. Kovaçi Feti Johuzi mori frymë thellë. Ngjitti pushkën lart më të dyja duart, shikoi nga maja e malit më dëborë e me partizanë dhe u niç. Iu bë sïkurt préj andej po e thërrisin në emër shumë zëra. Ishin zërat e shokëve të tij.

KOMANDANTI I BATALIONIT

M'u desh shumë kohë dhe një punë e vështirë për t'i «deshifruar» këto fletë të shkëputura nga një ditar partizan. Ato qenë zverdhur nga koha, vendevende ishin grisur e pothuaj të palexueshme. Nuk vinin njëra pas tjetrës. Enkas zgjodha ato që m'u dukën më interesante e që formonin një të tërë më vete. Sapo fillova t'i lexoja, e kuptova se qenë fletë të një ditari të mbajtur nga një dorë e stërvitur e një letrari të ri me një farë talenti. Se si kishin mbetur të ruajtura aq vjet në një qoshe sirtari, shoku im nuk dinte të më shpjegonte. Ndofta ngaqë ai nuk u bë letrar, po inxhinier.

18 dhjetor. Mbrëmje. Është e treta ditë që bie një shi i dendur. Na ka hyrë gjer në palcë. Ndodhem i vzhdimisht në ecje. Komandanti i batalionit urdhëron që të shpejtojmë, po ne jemi të lodhur sa s'bëhet. Pas një ore dalim në majë të kodrës më të lartë. Përpara kemi të tjera, që ulen njëra pas tjetrës. Më tutje dallojmë një pllajë të vogël katrore. Ndalem. Këtu do të kalojmë natën. Ndërsa mbaj ditarin, Seloja më ngacmon. Qesh me punën time. Nuk i përgjigj. Ibrahim i flet, po ai s'heq dorë. Hapim çantat. Kemi ura. Shumë nga shokët i mbyllin pa gjetur asgjë. Jemi më-

suar. Mendja na rrri te përpjekja me nazistët. Nesër ata do të kalojnë këndeje. Nuk e dinë që jemi këtu. Na kanë thënë se duhet t'i mbajmë deri në drekë. Kjo do të ndihmojë forcat e tjera partizane. Ra muzgu. Tani unë shkruaj më tym. Nuk mund të ndezim asgjë. Kemi urdhër. Shokët i ka kapur një gjumë i rëndë. Por komandanti i batalionit nuk fle. Kalon nga një pozicion të tjetri. Jep urdhra. Vjen edhe pranë nesh. Qëndron gjatë duke menduar. Pastaj i kthehet njërit prej shokëve të shtabit:

— Këtu është pika më e fortë. Sillni edhe një mitraloz tjeter dhe një skuadër pushkatarësh!

E shikojmë me çudi. Shoku i shtabit e pyet:

— Nuk ju kuptoj. Edhe një pikë e fortë, edhe të shtojmë forcat?!

Ai buzëqesh; shikon anash, fërkoni mjekrën dhe flet:

— Ata do të sulmojnë me forcat kryesore tamam këtu, sepse kjo është pika dominuese. Po të bjerë kjo, atëherë gjendja jonë vështirësitet. Komandanit hedh edhe një herë vështrimin tutje e pastaj largohet.

19 dhjetor. Zbardh dita. Jemi si të përgjumur. Bisedojmë më njëri-tjetrin. Të gjithë kemi një fare ankthi. Janë ethet e betejës së ardhshme. Unë i ndiej ca më tepër. Do të jetë përpjekja ime e parë. Pozicionet tona janë maskuar mirë. Shikoj qielin. Re të holla davariten ngadalë. Bën shumë ftohtë. Na kanë porositur të mos i përgjigjemi zjarrit të armikut pa urdhër. Minutat kalojnë aq ngadalë, sa më ngjajnë orë. Ja dhe shungullima e prëdhës së parë që vjen si e mbytur. Ajo kalon plot zhurmë mbi kokat tona.

— Ej, ti, «historian!» Mbylle atë qitapin tënd, se na hëngre!

Kthej kokën. Është përsëri Seloja. Nuk më ndahet. E fus bllokun në çantë. Do të vazhdoj më vonë.

24 dhjetor. Kanë kaluar pesë ditë. Po e filloj nga predha e parë e artilerisë. Pas asaj u dëgjuan dhjetëra shungullima të mbytura dhe po aq predha fluturuan e u përplasën edhe rrëth nesh. Një partizan u vra. Pak më parë ai bisedonte me ne. Kështu e ka lufta. Asnjë lëvizje nga ana jonë. Komandanti shikonte me dylbi. Dy partizanë i kishte nisur me detyrë në krahun e djathtë. Pastaj u panë kapota të murme, që lëviznin drejt nesh. Urdhëroi t'i linim të afroheshin sa më shumë. Hitlerianët ngjiteshin përpjete. Erdhi një çast që m'u duk sikur toka u ndez flakë. Qëlløhej me të gjitha armët. Ishte një zjarr skëtërrë. Dhjetëra kapota të murme mbetën nëpër shkurre. Armiqtë u prapsën. Nuk kaloi shumë e ata u derdhën përsëri si valë e rrëmbyer. Ngjiteshin, qëndronin, e prapë ngjiteshin. Ne i vështronim nëpërmjet thepit të pushkës. Ata zmadhoheshin, bëheshin më të gjatë, më të urryer. Parashikimi i komandanit doli. Forcat më të mëdha erdhën drejt pozicioneve tona. U dhamë një breshëri të gjatë. Na e kthyen me bomba, pushkë dhe me mitraloza «Shars». Për herë të parë vrava tre. Mora dhe vetë një plagë të lehtë në dorë, por nuk e ndjeva dhimbjen aq. Pas disa minutash i thyem. Nuk kaloi shumë dhe ata filluan të na qëllonin me artileri. U përpoqën të ngjiteshin edhe dy herë të tjera, po u thyen keqas. Ra nata. Ata qëllonin ende nga frika. Ne qeshnim dhe numëronim predhat që harmonin kot. Të nesërmendëmbuluan me bomba. Plasjet e sharapnelëve na shurdhuan veshët. Nuk lëvizëm fare. Komandanti dha urdhrat e fundit. Ata donin të çanin me çdo kusht. I mbajtëm edhe tërë atë ditë.

Dielli po perëndonte. Ai m'u duk kuq e zi, si-kur të kishte thithur tërë gjakun e të vrarëve, tërë vuajtjet e njerëzve tanë, flakën e betejave, tymin e shtëpive të djegura e të shkurreve të përcëlluara. Në mbrëmje u larguam. Më vonë morëm vesh se nazi-stët qenë ngjitur në majë vetëm në mëngjesin e ditës së tretë, kur ne ishim shumë larg. Humbjet e tyre qenë të mëdha. Kishin lënë më shumë se gjashtë-dhjetë të vrarë. Ne s'folëm për fitoren. Na vinte keq për dy shokët që s'jetonin më. Komandanti i batalionit na falënderoi, po ne nuk u gëzuam dhe aq. E kishim mendjen tek ata të dy që na mbetën në betejë.

23 janar. Kemi gjashtë orë që ecim. Qielli është krejt i përhimtë. Jemi aq nga barku. Sapo bëmë një aksion. Tani u futëm në një pyll të dendur. Ndalojmë. Andej-këndej shikoj zjarre bubulake. Partizanët thajnë rrobat, bëjnë shakara... Shoh komandan-tin. Ai qëndron pranë dy shokëve. Afrohem. Sytë i ka të njomur e të gëzuar. I kapi duke «u zënë» për një krodhë bukë misri, që edhe plumbi nuk e shpon-te. Ua ndau në mes. Ata e shikonin në sy. Atij iu bë zemra mal. Pastaj vjen te ne. Na gjen duke bis-kuar për aksionin. Përpinqem të fsheh ditarin, por ai ma sheh dhe thotë:

— Ruaje! Aty ështëjeta jonë, një pjesë e historisë së luftës sonë.

Ul kokën. Seloja kapet ngushtë. E vështroj me keqardhje. Komandanti e merr fjalën përsëri:

— Pa më thoni, ku ishim para disa orësh? U dhamë një dru të shëndoshë nazistëve! Ata tani me sì-guri ende «spastrojnë» vendin, ndërsa ne jemi larg. Nesër do t'i godasim në një vend tjetër. Të tillë janë partizanët. Ne e detyrojmë armikun të luftojë aty ku

duam, e tärbojmë me befasinë, me iniciativën, me lëvizshmérinë. Mendja jonë e kthjellët dhe këmbët tonë të forta na nxjerrin faqebardhë. Lufta jonë ka një vecanti. E godasim armikun aty ku ai s'e pret, pér t'u grumbulluar ku duhet e pér të humbur nga sytë e tij, sa herë që kjo është e dobishme. Jemi si ajo reja e fuqishme e ngarkuar me breshër, që derdhet befas. Më vonë do të na duhet të luftojmë edhe ndryshe. Ne shikojmë gjithmonë pérpara dhe nuk pengohemi, kurse armiqtë janë si ajo qerrja e thyer, pér të cilën të tëra rrugët janë të prishura.

E dëgjojmë dhe bëhemë më të fortë. Mua më duket sikur ai ka mbaruar ndonjë akademi të lartë ushtarake, ndërsa në të vërtetë ka ngarë vetëm parmen-dën. Papritur i drejtohet Dhorit:

— Po ti, paske mbetur me ato këpucë që u ka mbetur vetëm emri! Pse i mban sa pér bela?! Mirë kur s'kemi, po tani që u zumë gjermanëve!...

— Nuk pata kohë t'i zëvendësoja. Por, shpejt do t'ju paraqitem me një palë gjermane, fringo të reja.

Qeshim. Ai vrenjtet. Pasi hesht pér ca sekonda, na jep një mësim të mirë. Dhe me të drejtë. Dhorit i vjen pak si thartë kur dëgjon:

— Ai që nuk kujdeset pér të forcuar gatishmërinë e tij ushtarake, krijon boshllék në kolektiv.

Si thotë këto, dora e djathtë e komandantit rreh shpatullat e shokut tonë. Na porosit të thellohemëti në këtë çështje. Largohet. Unë mbyll kapakët e ditarit dhe bie në mendime.

26 janar Sot mora vesh se më 24 janar, ndaj të gdhirë, komandanti kishte kontrolluar rojat. Dëbora atëherë binte fjolla-fjolla. Ai rrëshqiste nëpér mugë-tirë. Donte të sigurohej nëse ishte çdo njeri në vendin e vet. Kur kishte arritur pikën më të largët, në

një vend të rrezikshëm, roja e pati diktuar dhe i pati bërtitur të qëndronte pa lëvizur përballë pushkës së tij, derisa të sqarohej në ishte apo jo vërtet ai... Komandanti ishte bindur dhe më në fund e kishte përgëzuar atë djalë 18-vjeçar, që vigjëlon me syrin pishë, ndonëse i bërë kallkan nga të ftohtët. Pastaj ishte nervozuar, kur kishte parë se sa hollë që veshur partizani. Aty për aty e kishte urdhëruar intendentin t'i jepte atij një pallto për të qenë.

Shpirt njeriu e kemi komandantin. S'ka dyshim. Por, edhe të ashpër, veç. Ne ia njo him ashpërsinë kur gabojmë. Megjithatë, edhe atëherë hijjmë thellë në tërë qenien e tij dhe na duket se edhe në ashpërsi ai është i mirë. Në të ka diçka të butë, ndonëse të fshehur thellë, diku në ndjesitë e veta. Njëri nga ne e ka quajtur komandantin gjykatës të saktë, që të jep gjithmonë atë që meriton, pa iu brejtur fare ndërgjegjja, sepse përherë merr vetë më tepër nga ç'i takon në gabimet tona. Nuk të akuzon kurrë po nuk u bind se ke faj. Ai mat, pa pret, dhe mat pa u nxituar. Kurrë nuk ka qëlluar që të akuzojë një shok e pastaj ta falë për mungesë provash.

6 shkurt. Dje patëm një përpjekje të vogël. Në rrugën automobilistike kaloi një makinë ushtarake gjermane dhe fill pas saj dy motoçikleta me kosha. Njëra nga kompanitë e batalionit tonë, ajo ku jam edhe unë, hapi zjarr të befasishëm kundër tyre. U deshën vetëm pak minuta që gjithçka të merrte fund. Ishin dhjetë ushtarë e një oficer. Tetë i vramë, por me luftë të rreptë. Tre i zumë robër. Oficeri kishte një mjekër të zezë si prift.

Frika i kishte hyrë në palcë. S'pushonte së foluri me një zë lutës:

Jam austriak, jam austriak!

Fjalët i shoqëronte më pérulësi e gati duke rënë në gjunjë. Na ngjalli neveri dhe urrejtje. Kur hitlerianët pushtuan Austrinë, ky oficer spic me siguri do ta ketë quajtur veten gjerman. Ne e ndienim se ai ishte gati të ndërronte tërë nënshtetësitë e botës, vetëm që të shpëtonte lëkurën. Njërin nga të tre robërit, atë që ishte pothuaj fëmijë, e kapi skuadra ime. Kur kaloja para partizanëve për t'i çuar në shtab, më dukej sikur të gjithë e thoshin nga një fjalë të mirë përmua. Ndaj më ishin skuqur faqet prej turpit, se nuk kisha pasur asnjë meritë të veçantë përkapjen e tyre.

Dëgjova bisedën e komandantit me robin çunak. Po e riprodhoj.

— Si të quajnë?

— Zigfrid. — Ai u përgjigj me vështrimin mbi majat e këpucëve.

— Sa vjeç je?

— Sot mbusha gjashtëmbëdhjetë.

Komandanti e shikoi me vëmendje. Sytë e ushtarit dukeshin të shpëlarë. Fytyrën e kishte dyllë të verdhë. Mbi buzën e sipërme mezi i dukej një vrragë e lehtë pushi të kuqërrëmtë. Rrobat i rrinin pak të mëdha.

— Si ëndërroje ta festoje përvjetorin e ditëlin-djes sate?

Robi uli kokën dhe s'foli. Komandanti përsëriti pyetjen. Tjetri përsëri heshti. Ne e shikonim me një farë çudie fëmijën me rroba ushtarake dhe e ndienim se armikut po i vinte fundi. Komandanti i tregoi atij se si Hitleri dhe banda e tij i kishin hedhur në një luftë grabitqare e të pashpresë tërë ata djem aq të rinj, të cilët duhej të kishin supeve çantat e shkollës. I foli e i foli, sa mua m'u duk se po zgj-

tej pa nevojë. Nuk po kuptoja q'qëllim e shtynte komandantin. Ç'donte të arrinte ai. Pas ca, kur hodha vështrimin nga robi, vura re se sytë e tij e kishin humbur atë ngjyrën e shpëlarë të mëparshme. Ngriti kokën me një lëvizje të rrëmbyer. Pastaj grisë astarin e xhaketës, nxori prej andej diçka të fortë si meshinë dhe ia zgjati komandantit. Tanimë ky mbante në dorë një fotografi dhe një copë letër të vogël e të zverdhur. Ishin «dokumente». Tregonin se i ati i Zigfridit kishte qenë punëtor militant, kundërshtar i regjimit hitlerian dhe i pushkatuar prej tij. Komandanti ra në mendime. Pastaj i tha robit se, po të kishte qenë gjallë i ati, do ta pushkatonte një fëmijë, që kishte ngritur dorën kundër babait, kundër ideve të tij, kundër lirisë së popujve. Robi uli kokën dhe nuk foli. Komandantit iu vrenjt balli. Ai dha urdhër ta nxirrnin jashtë. Se ç'u bë me këtë ushtar gjashtëmbëdhjetëveçar të Fyhrerit, nuk e mora vesh. Edhe ajo puna e «dokumentit» nuk e dinëse qe truk apo e vërtetë. Kur ua tregova shokëve këtë skenë, ata ranë në mendime. Unë forcova bindjen se komandanti ynë ishte edhe komisar, ashtu siç ishte komendant edhe komisari ynë.

3 mars. Bën shumë ftohtë. Vazhdon të bjerë dëborë. Shpejt ajo kthehet në një si llohë tepër të mërzitshme. Pastaj papritur shpërthen një breshër kokërrmadh. Na kanë ngrirë këmbët e duart. Jemi të detyruar të marshojmë. Dua të vazhdoj ditarin, por s'mundem. Më duket se po bie erë luftë.

7 mars. Kanë kaluar katër ditë. Ata që e panë komandantin me 3 mars, nuk vunë re asnje shqetësim tek ai, ndonëse, si gjithmonë, ishte i merakosur për aftësinë luftarake të batalionit, për disiplinën dhe rregullin. Aty për aty neve nuk na bënë përshty-

pje këto preokupime të komandantit, se qemë mësuar me të. Por, pak nga pak edhe partizani më i ri e kuptoi se pritej diçka e jashtëzakonshme. Ato të shtënënat e herëpashershme që dëgjoheshin nga larg, lëvizjet me ngut sa në njërin krah, te tjetri, urdhrat që shkonin e vinin, nuk të linin dyshim se ndodheshim në gjendje të vështirë. Siç dukej, armiku synonte të na rrethonte e të na asgjësonte. Komandantit tonë nuk i shpëtonte asgjë. Ai vuri tërë aftësitë për të dalë si kurdoherë me faqe të bardhë. Pas ca na e tha troç si qëndronte puna dhe kërkoi mendimin tonë.

...Kaluam anës një fshati. Enkas komandanti përhapi lajmin ndër fshatarët se gjoja forcat kryesore partizane vinin më pas. Në të vërtetë ishim vetëm ne. Papritur morëm urdhër të ndërronim drejtim. Dëbora nisi që të binte me të madhe. Shtegu i vetëm, nga ku mund të kalohej, të nxirrte në një qafë mjaft të rrezikshme. Por, edhe ajo qe zënë nga armiku. Kjo na e rëndonte gjendjen. Megjithatë, komandantit nuk iu tremb syri. Ai mori menjëherë një vendim të guximshëm e krejt të befasishëm për armikun.

Me urdhër të tij u nisën të dilnin në një vend pothuaj të pakalueshëm në dimër. Po në këtë kohë komandanti dërgoi një skuadër në drejtim të qafës, për t'i mashtruar armiqtë. Dhe vërtet i mashtroi keqas. Skuadra filloi goditjen papritur. Praparoja ndërrroi drejtim. Për të dalë sipër, në atë shteg aq të ngushtë dhish, na duhej të hidhним një ledh pak të ngri-
tur, që mund të luante rolin parapritës për armiqtë. Komandanti urdhëroi që pikërisht aty të sulmohej. Dhe nuk u gabua. Ai e peshonte çdo gjë deri në im-
tësinë më të vogël dhe mbështetej fort në besimin

që kishte te ne. Prandaj edhe ata që mezi i hidhnin përpara këmbët e enjtura, edhe të sëmurët luftonin njëloj si të tjerët.

Kur zbritëm afër ledhit, plasi pushka. Vërejtëm se një kolonë e madhe hitlerianësh na ndiqte nga pas. Por edhe anash u dëgjuan sokëllima mitralozash. Pra, nuk duhej vonuar. Komandanti s'dinte të hutohej në situata të vështira. Ai e kuptione mirë se ç'duhej bërë. Dha urdhër në çast të sulmonim, duke na nxitur e ndezur zemrat me atë zë të fuqishëm, ku ndihej bindja për vendimin e drejtë e besimi në fitore dhe doli sakaq në ballë. Thirrjet tonë të një-kohshme «Para partizanë!» jehonin me forcë përmes plasjes së bombave dhe sokëllimave të mitralozave. Asnjë nuk u përpoq të shfrytëzonte ndonjë pozicion për t'u mbrojtur sado pak. Të gjithë luftonin në këmbë, duke u futur deri në gju në borën e trashë e të butë. Dhe i thyem nazistët. Pastaj kuptuam sa vështirë e kishim pasur. Po askush s'i coi në mend vështirësitë, kur u hap lajmi gojë më gojë se komandanti ishte plagosur. Dikush na ngriu gjakun, kur tha se ishte një plagë për vdekje. Nuk besuam. Pyetjet binin si breshër sa andej-këndej, po asnjeri s'kishte parë gjë me sy. Vetëm Xhaferri, një shoku ynë, edhe ky i plagosur, paskësh thënë se vetë komandanti e kishte shpëtuar nga thonjtë e vdekjes. Më vonë u bë e qartë gjithçka. Ai kishte marrë vërtet një plagë, por do të rronte. Këtë e thoshte mjeku. Ja si kishte ndodhur! Ne sulmuam me furi. Shembulli i komandantit, që ishte hedhur në ballë, na kishte tërhequr pas të gjithë. Bashkë me disa partizanë ai që ngjitur te ledhi, duke qëlluar pa pushim me pushkë. Kur erdhi çasti për t'u përleshur trup me trup, Xhaferri u plagos, s'qëndroi dot më këmbë dhe u

rrëzua. Njëri nga hitlerianët u mat t'i jepte goditjen për vdekje, po i mbeti armë në dore, se komandanti i kërceu në grykë dhe ia zbrazi shpejt plumbin në zemër. Në këtë kohë ai u plagos edhe vëtë. Megjithëse i plagosur e fshehu këtë nga shokët dhe e vazhdoi sulmin.

Pasi e thyem armikun, u vumi në ecje. Në krah kishim një fsfat të vogël. Kujtuam se do të drejtoheshim për atje, se nuk kishim futur asgjë në gojë dy ditë të tëra. Një copë misërnike me qepë do të ishte për ne gostia më e madhe. Por, komandanti nuk na lejoi. Ai i bënte llogaritë më thellë e më mirë. Qëndrimi, sado pak i shkurtër, ishte tepër i rrëzikshëm! Armiku mund të na détyronte të ndeshëshim prapë me të, mirëpo u ishim ne në gjendje të përballonim epërsinë e tij numerike dhe armatimet që kishte, ashtu si ishim: të pangrënë e të rraskapitur?! Atë ditë ne bisedonim orë e çast për komandanatin. Disa thoshin se ai nuk pasloësh bërë mirë që dolli në ballë, kurse mjaft të tjerë ia vleresonin shumë këtë akt të guximshëm. Megjithatë, ishte komisari ai që tha fjalët më me vend:

— Komandanti ynë u hodh përparë kur batalioni ishte në pozitë të vështirë, kur shembulli i tij që i domosdoshëm. Pra, ai bëri atë që i takonte. Pastaj... u plagos. E po, kështu e ka lufta. Ndryshe do të ishte të plagosej nga pakujdesia në një çast tjetër. Atëherë ne do të hidhëroheshim, por ama edhe do ta qortoni për gabimin. Se një komandant i mirë, merret vesh, e ndien gjithnjë përgjegjësinë që ka para shokëve për të ruajtur vëten, me qëllim që t'i drejtojë ata me aftësi të plota gjër në fitoren përfundimtare.

12 thërs. Dje ishte një nga ditët më të bukurë.

Takuam komandantin. Ne, tre partizanë dhe komisari. Hymë në spital. Ai rrinte shtrirë. Vërejtëm se i ndriti ftyra sapo na pa. Deshëm ta shtrëngonim fort në krahët tanë, po patëm frikë se mos i lëndonim plagën. Komandanti e ndjeu dashurinë tonë. Vuri lehtë buzën në gaz. Pastaj pyeti një për një për partizanët. Komisari i dhuroi një «Valter»¹⁾ gjerman, që ia kishim rrëmbyer një oficeri nazist. Ai e vërtiti revolen ngadalë nëpër duar. Pastaj na vështroi gjatë me ata sy që i ndriçonin nga gëzimi. Më në fund iu drejtua komisarit:

— A do të ma bësh qejfin tamam? — i tha.

— Patjetër! — iu përgjigj komisari.

— Atëherë mere prapë revolverin dhe dhuroja partizanit që u dallua më shumë në atë luftim! Të lutem kështu bëj!

— Po atij po ia dhuroj, pra! — buzëqeshi komisari.

Komandanti heshti për një hop. Pastaj foli me ton të prerë, por pa mundur t'i jepte zërit forcën e duhur, se e pengonte plaga.

— Të urdhëroj, Nevruz! Jepja një partizani të thjeshtë e trim. — Dhe aty për aty, si të donte të mos e mbyllte atë bisedë me urdhër, shtoi me zë të ëmbël:

— Mos ma prish, bre! Jemi shokë apo s'jemi?

U ndamë me të pas dy orësh. Na u bë se lamë në spital zemrat tona, se komandanti e kishte vendin thellë brenda tyre. Ecnim dhe heshtnim. Kur do të shërohej ai? A do të ishte i plotë shërimi A do të kthehej në batalion përsëri të na drejtonte aq mi-

1) revole

rë, të na ngrohte shpirtrat, të na ndizte kraharet, duke na nxitur, si gjer atëherë, që ta ndienim veten shqiponja kur të suleshim mbi armikun e egër? Këto pyetje silleshin tutje-tëhu në mendimet tona pa pushim. Edhe komisari ecte dhe heshtte. Pas pak ai ndaloi, u fut në mes nesh, na hodhi krahët supeve dhe tha i përmalluar:

— Atë ditë që do të dalë komandanti nga spitali, do ta festojmë, or shokë. Do ta festojmë ashtu, partizançe, ku të na e bjerë rasti e si të na gjejë ai lajm i mirë, veç që do ta tundim!...

Ne nuk folëm. I hodhëm duart në qafë dhe me këtë gjest tonin i treguam se kishte folur tamam ash tu sikur të kishte qenë në zemrat tona.

MOTËR E VËLLA

Ata jetonin në një shtëpi të vjetër përdhese në qytetin e lashtë me rrugë të ngushta me kalldrëm dhe mure të ulëta prej guri ngado që hidhje sytë. Kishin mbetur në familje vetëm tre: nëna plakë, Zylfia, i biri, Agimi dhe e bija, Xheja. Katër fëmi-jët më të mëdhenj kishin vdekur shumë vite më parë, në moshë fare të njomë. I zoti i shtëpisë kish-te pasur një «fat» më të keq. Një natë, kur e shoq-ja priste që ai të kthehej nga puna e rëndë, sollën lajmin e kobshëm: e kishte vrarë një nga njerë-zit e beut, sepse «leckamani» paskësh guxuar ta quante atë vjedhës e gjakpirës.

Qysh atëherë Zylfia lante rrobat e botës. Agimi e kishte lënë shkollën dhe qe futur në një punishte të vogël, të cilën pronari e quante me mburrje «fabrikë vaji». Xheja, e dobët dhe shtatimtë, vuante nga një bronkit kronik e mezi u vinte rrotull punë-ve të shtëpisë. Kështu rridhnin vitet në atë shtëpi. Dikur nënën e lanë fare forcat. Zuri shtratin përmuaj më radhë. Kur u bë më mirë, i biri nuk e la të merrej më me larje rrobash. Kështu u varfëruan edhe më tepër.

Me kalimin e kohës Zylfia u bind se Agimi ngatërhojej me punë të «ndaluara». U drodh kur mendoi se fashistët nuk bënин shaka me ata që quheshin komunistë. Kishte dëgjuar për burgimet, torturat e pushkatimet dhe kjo e bënte të futej në mendime të thella. Po, dalngadalë mendimet e saj u kthjelluan dhe ajo mori frymë më lehtë. Ishte duke u bërë tjetër njeri. Kur një natë i biri i lexoi pjesë nga «Nëna» e Gorkit, ajo qau me lotë të nxeh të për Vllasovën dhe zemra iu mbush me drithërimë e urrejtje. E kështu u mësua. Të rinj të panojohur vinin tinës në shtëpi dhe çoç bisedonin me të birin për gjëra të fshehta. Dhe erdhi një ditë që asaj komunizmi nuk iu duk më si diçka e frikshme. Bile, njëherë e quajti edhe veten komuniste. Më vonë, kur Agimi kujtonte se si kishte qenë e ëma, qeshte me të madhe.

Nga shtëpia përdhese përhapeshin çdo ditë lajmë për copëra ngjarjesh revolucionare, shpërndahejshin parulla luftarake, merrnin udhën e malit armatime. E ajo, rrobalarësja e dikurshme, grua e paditur shtëpiake, e ndiente se nuk po bënte një jetë boshe. Kishte merak vetëm për Xhejen. E donte shumë atë dhe, kur e shihte aq të dobët, i qante zemra. Një ditë ia tha Agimit brengën që e mundonte, po ai i foli e i foli, sa ajo e ndërpren, duke e qortuar me keqardhje e duke i thënë se gabonte, kur e merrte nënën e tij tjetër për tjetër. Agimi e kapi për mesi, e rrotulloi nëpër dhomë, e puthi e i tha se e donte njëqind herë më tepër se më parë.

Xheja e ndiente shqetësimin e nënës. Megjithatë, nuk mundej t'i ndrydhëte hovet e veta. Duke ndjekur shembullin e Agimit, që përkujdesej për të

si vëlla e si mësues, ajo piqej çdo ditë më shumë në zjarrin e punëve revolucionare. Rrugën e re e pati nisur me etjen për të mësuar të vërtetën. Kishte qëndisur flamuj me yje të kuqe, kishte bërë punën e korrieres, kishte shtypur edhe trakte, derisa qe futur në grupet edukative që drejtonin komunistët. Kështu kishte rrjedhur koha për Xhejen e kishte ardhur ajo mbrëmje dimri, kur ajo kishte dalë nga shtëpia përdhese me një copë mushama në kokë për t'u mbrojtur prej shiut që binte me rrëshkekë. Në duar mbante dy shporta me bomba, sipër të cilave, një mbulesë të pastër bësmeje ta bënin me sy ca mollë të kuqe e të mëdha. Kur u afrua te cepi i rrugicës së parë, qëndroi një çast dhe u mbush me frymë. Pastaj nisi të ecte më shpejt. Shikonte me kujdes sa andej-këndeji. Pasi bëri edhe një copë rrugë të mirë, iu duk sikur dëgjoi zëra. Ndali këmbët e mbajti vesh, por... ata nuk u përsëritën. Edhe pak e do të dilte, në kthesën pas së cilës rruga vazhdonte në një monopat drëjt kodrave me ullinj. Krahët e hollë iu lodhën nga pesha e rëndë, ndaj i lëshoi për një çast shportat në tokë, për t'u çlodhur sado pak. Por, shpejt i ngriti përsëri, e, sapo hodhi çapin, u pre menjëherë. Në kthesë u dukën dy xhandarë. Të prapsej dhe të niste vrapin në drejtim të kündërt? Jo, jo. Kjo s'ishte punë që bëhej. Si mund t'i braktiste shportat? E kuptoi se nuk kishte rrugë tjetër, veçse të shkonte drejt tyre gjakftohtë. Shiu i rrëmbyer nisi t'i rridhte nëpër mjekrën që i dridhej nga të ftohtët. Më tej shquheshin ullinjtë e murmë dhe ajo kasollja e vetmuar. Iu bë sikur dëgjoi një trokitje të lehtë këpucësh prapa shpinës. Nuk e ktheu kokën. Pati frikë se mos xhandarët dyshonin.

— Pa shih, pa shih! Ç'është kjo vajzë, që del vetëm në këtë shi dhe në këtë orë! — foli njëri prej xhandarëve.

Ajo qëndroi dy hapa larg tyre. Shportat po i lëkundeshin ndër duar.

— Ç'ke aty brenda? — e pyeti tjetri ashpër.

Xheja nuk foli, por hoqi mbulesën e njérës shportë, mori një mollë të madhe dhe ia zgjati. Xhandari e shtyu dhe futi dorën në shportë. Ajo u drodh e tëra. Në çast një e kollitur e fortë e ngatërroi gjendjen. Të tre kthyen kokat djathtas. Dy të rinj, me duart në xhepat e xhaketave, vështronin të egërsuar. Xhandarët u hutuan. Dy të rinjtë sikur kishin mbirë nga dheu.

— Eja të shkojmë, se na lagu ky shi i mallkuar! — i tha shokut të vet xhandari që kontrolloi shportën, pa harruar ta përshëndeste vajzën, duke e çuar dorën që i dridhej në kapelen që i kullonte ujë.

Xheja erdhi në vete, kur njëri nga të rinjtë ia mori shportat dhe e nxiti të largohej sa më shpejt e të mos shqetësohej, se bombat do të mbërrinin menjëherë në duart e partizanëve. Kur u kthyte në shtëpi, e ëma, që nuk dinte se ç'detyrë kishte kryer, e qortoi se nuk kujdesej fare për shëndetin. Kurse Agimi, që u kthyte të nesërmën, i tha se ishte shumë i gëzuar që ajo kishte dalë faqe bardhë.

— A e di, Xheje, — vazhdoi i vëllai, — se çdo gjë ishte organizuar si jo më mirë? Ti ishe e mbrojtur. Mora vesh se ata dy shokët qenë zbavitur ca me fashistët, që kishin ikur si pula të lagura.

Ai po qeshte. Xheja e shikonte si me pikëllim.

— Qesh ti, qesh, — i tha, — po unë kujtova se çdo gjë mbaroi. Në fillim m'u duk se do të kaloja pa rënë në sy, po ata dyshuan. Pastaj...

E ëma, që po e shikonte të bijën me dhimshuri, u ndrydh në vetvete dhe s'e hapi gojën. Kur ranë të flinin, ajo e nxori të keqen me përkëdheljet e pambaruara ndaj së bijës. Që nga ajo natë Xheja filloi të mos flinte gjithnjë në shtëpi. Shpesh shkonte te një shoqe. Po edhe Agimi kishte kohë që nuk dukej për ditë dhe net me radhë.

* * *

Një natë, kur ora e madhe e qytetit ra dy herë, u dëgjua një shungullimë e fortë. Pastaj u panë flakët, që u ngritën lart. Një dritë e fuqishme ndriçoi tërë vendin. Njerëzit u zgjuan. Nëpër rrugë kalonin ushtarë të armatosur. Sirenat e disa makinave zjarrfikëse të cirrnin veshët. Pati edhe të shtëna pushkësh.

Në fillim çdo gjë kishte shkuar mirë e bukur për të rintjtë komunistë që kryen aksionin. Po kur gjuhët e flakëve e përpinë krejt ndërtesën katér-këndëshe me munizione, armiqtë e morën veten dhe ranë në gjurmët e tyre. Ata patën mbaruar punë dhe qenë tërhequr siç e kishin llogaritur. Vetëm njëri nuk kishte mundur të çantë aty ku duhej. Ruga qe zënë dhe njerëzit me rroba të murme e kishin ndjekur pas. Ai e pa se nuk do të arrinte në vendin e caktuar! U përpoq t'u humbiste nga sytë, po ishte e pamundur. Plumbat i fërshëllenin rrëth e qark. U hodh në një hendek. Deshi të kapërcente më tuftje, po këmbët iu prenë. E kishin goditur në gjoks. Arma iu duk shumë e rëndë. Merrte frymë me zor. Në zemër ndjeu një therje të imprehtë. Ata qëllonin me breshëri automatikësh. Atij i dukej sikur të gjithë plumbat goditnin tek

ajo vrimë e vogël, që ishte hapur mbi xhepin e majtë të xhaketës së vjetër. Mbështeti pëllëmbët e duarve të gjera e të ashpra në tokën e lagur dhe iu bë sikur gjithçka lëvizi. Të shtënati u rralluan. Ai përmblodhi të gjitha forcat dhe nisi të largohej, duke u lëkundur fort. Këmbët e shtynin në rrugicën e ngushtë, drejt atyre shtëpive të vogla, që i dukeshin edhe më të vogla nga ç'qenë. Pas tij dëgjoi këmbët të rënda ushtarësh. Shtrëngoi revolen. Më tutje u duk një uniformë e murme. Qëlloi mbi të me tërë urrejtjen. Tjetri e mbuloi vendin me krisma të vazhdueshme. Plumbat goditnin në muret e gurta dhe ktheshin në drejtime të ndryshme. Forcat po e linin, u mbështet rrëzë një muri të vjetër. Përpara syve i doli një mjegull e dendur. Po i merrshin mendtë. Mbylli sytë përgjysmë. Bebzat e tkurrura ia përshkoi një rrëze e zbehtë drite. Përpara dalloi një siluetë gjigante, që vallëzonte në trajta të ndryshme. Qëlloi përsëri e pastaj u tërroq zvarrë. Ra në një copë vend të vogël, ku ishte rritur bari. Ndjeu një lehtësi të çuditshme. Diçka iu këput në zemër. Një buzëqeshje e pakuptueshme i ngriu në fytyrë.

* * *

Në dhomë qenë përsëri tre. Ato të dyja dhe Agimi, që kishte mbaruar. Porta e jashtme u hap me tërsëllëm. Brenda hynë njerëz të armatosur dhe tok me ta edhe spiuni i njohur. Sapo u futën në dhomë, ku qe shtrirë i biri pa jetë, Zylfia fshiu lotët dhe, me një zë që dridhej nga dhembja e urrejtja, foli:

— Çfarë doni akoma në shtëpinë time? Nuk ju mjaftoi im bir?

— Ti, plakë, merru me të vdekurin! Ne kemi punë me të gjallët, — foli ashpër kapteri që u printe dhe urdhëroi të tjerët të kontrollonin çdo skutë.

— Ju keni frikë nga ai edhe kështu siç është, — vazhdoi nëna. — Ju, vrasësit!

— Mbylle gojën, shtrigë, se t'i vura prangat e të plasa në burg! Kurse ti, — iu kthyesh ai Xhejes, — do të vish me ne! — Ndërkaq e tërroqi nga krahët.

Kjo ishte një goditje tjetër e fortë për nënën.

— Jo! — klithi ajo me zemërim të thellë. — Ju nuk do ta kaloni pragun e portës sime vetëm me të! Merrmëni dhe mua! Për tim bir do të gjenden plot njerëz të mirë që ta varrosin.

Nëna nuk kërkonte mëshirë. E dinte se ata nuk prekeshin nga vuajtjet e saj. I biri i kishte goditur për vdekje-te depoja, në rrugë dhe gjetkë sa e sa herë të tjera. Nënës i kishte mbetur vetëm Xheja. Por nuk ka xhelat që llogarit viktimin. Ata e shtynë të bijën përpara e ajo e shikoi të ëmën në sy. Nuk i pa pikë loti, po vetëm shkreptima. Mori zemër dhe i tha:

— Nënë, ti je e fortë. Mos... — por nuk i mbaroi dot fjalët. Porta kërciti prapa krahëve të Xhejes. Nëna mbeti vetëm. U ul pranë djalit të vrarë dhe i foli siç i kishte folur qindra herë, duke i qarë hallin, se, e kishte rritur me mundime, e tani ia bënte hallall luftës së popullit.

* * *

Në burg bënë çmos për të mësuar cilët qenë ata që dogjën depon. Xheja qëndroi. I kapërceu të gjitha: kërcënimet, trillimet, torturat. Një natë i futën në bi-

rucë një grua. Hiqej sikur e kishin shembur së rrashuri. Dy ditë e dy net ajo vetëm rënkonte e mallkonte. Xheja e ngushëlloi, siç bëjnë njerëzit që vuajnë nga një e keqe e përbashkët. Ditën e tretë, ai që i solli ca ushqim nga jashtë, i tha se atë drekë do të hante një bukë të mirë. Kur po largohet, e pati shikuar drejt në sy. Xheja diç kuptoi. Në tulin e bukës gjeti një copë letër shumë të vogël, ku që shkruar: **Kujdes! Gruaja** në birucë është provokatore. Kjo e shpëtoi. Pas pesë muajsh e liruan. Nuk shkoi shumë dhe një natë shokët e njoftuan se përtë nuk kishte më siguri në qytet. Xheja ia tha sëmës larg e larg. Zylfia e ndjeu veten shumë ngushtë. Një lot i madh iu rrokullis në njérën faqe. E shtrëngoi të bijën fort në krahët e saj.

— Vështirë do ta kem unë, — i tha, — kurse ti në mal do të jesh pushkë përballë pushke. Mirë të kanë thënë. Këtu ka më shumë rrezik.

Do të nisej të nesërmen herët në mëngjes. Natën vonë e éma ra në dyshekun e shtruar përdhe. Xheja ndjeu një dorë që i lëmoi flokët e butë. Sapo zbardhi, Zylfia i dha një bohçe, ku qenë futur një triko e vjetër (e vëtmja që kishte mbetur nga i vëllai), ca ushqime dhe libri «Nëna». Xheja vuri diçka në xhepin e xhaketës. Dolën në oborr. È éma e puthi në ballë dhe ajo ndjeu buzët e sai të ftohta akull.

Takimi me shokët ishtë lënë te një breg paksa sipër varrezave. Prej andej do të ngjiteshin përpjjetë kodrës. Asaj iu kujtua i vëllai. Me këtë mendim mori rrugën, ku nuk dukej këmbë njeriu. Ekte shpejt. Tëmthat i rrithnin fort. Kur po i afrohej bregut, iu bë sikur po e ndiqnin. Përshkoi edhe një copë rrugë me mendje të turbullt. Pastaj u duk qiparisi i parë. Bëri dhe disa çape dhe përsëri ndjeu një fëshfërimë. Ktheu kokën. Asgjë. Nisi të ecte, por në çast i doli

përpara një njeri. Ajo u zverdh. Njohu spiunin e urryer, atë që pati ardhur në shtëpinë e tyre atë natë kur u vra Agimi. Ai bëri sikur qeshi. Ajo futi dorën në xhepin e xhaketës. Ai hodhi dy hapa përpara dhe foli me qesëndi;

— Si shumë herët e more këtë rrugë, moj Xheje! Nuk pate frikë?! Apo jeni trima ju komunistët e s'doni t'ia dini? Hë?

Ajo e vështroi egër. Nxori rrufeshëm revolverin dhe ia drejtoi sakaq në lule të ballit. Atij i mbeti goja gjysmë e hapur. Sytë iu zgurdulluan. Tyta e revolverit iu duk si grykë topi. Duke u dredhur si purtekë, tha me një fije zë:

— Lëri shakatë, të lutem! Largoje atë hekurishte, hë, vajzë! Unë të dua të mirën!

Po Xheja nuk e zgjati. Ajo tërroqi këmbëzën me vështrimin e ngulur rreptë në fytyrën e spiunit, i cili u shtrri pa frymë sa gjatë gjerë midis asaj udhëze me baltë, që dredhonte përmes shkurresh e kaçubesh të lagura nga shiu që sapo kishte reshtur.

Vajza kishte qëlluar në shenjë që në të shtënën e parë. Sa mirë! Iu ngjit malit e lehtësuar. Me siguri atë krismë e kishin dëgjuar edhe shokët që po e prisin diku aty më lart. Kur mendoi kështu, e ndjeu veten edhe më të fortë. Ky ishte një fillim i mbarë në, atë, rrugë të bardhë me gjurmë heroizmi.

QORTIM I SINQERTË

Atë natë marsi binte shi me shqotë. Qyteti qe zhytur në errësirë. Ora e madhe sapo kishte rënë nëntë herë. Ndalimqarkullimi ishte në fuqi. Rrugëve s'pipëtinte gjë. Shumë rrallë dëgjohej të ecurit e rëndë të patrullave fashiste.

Në shtëpinë e profesor Samiut vetëm në njëren nga dhomat kishte dritë. E shoqja, që s'e ndiente vreten mirë, kishte rënë për të fjetur. Profesori, një burri afër të gjashtëdhjetave, tip tepër i ndjeshëm dhe mjaft autoritar, lexonte diçka interesante në një libër shkencor. I biri, që bënte vitin e fundit të shkollë së mesme, i hedhur në jetë, sidomos në çështjet me karakter shoqëror, po merrej me ca probleme matematike. Kur kaluan nja pesëmbëdhjetë minuta nga nënta, djali e la papritur punën dhe hodhi vështrimin përmes dritares që binte karshi portës së jashtme. I ati s'e vuri re, ashtu i zhytur siç ishte në leximin e librit. Pas pak u dëgjuan vërvëllima bilbili, pastaj këmbë të rënda ushtarësh, fjalë të ashpra me zë të lartë, që u shoqëruan me tri-katër krisma armësh. Iu bë sikur dëgjoi zhurmë edhe në portën e tyre. Profesori brofi më këmbë. Ferdi largoi mënjanë perden e tra-

shë të dritares. I ati e qortoi, ndërsa patrulla kaloi pranë shtëpisë. Të dy mbajtën fryshtë. Ushtarët e huaj u vërtitën ca si gjatë aty rrrotull. Ata u larguan, kur krisi një pushkë dhe kur lehu një qen më tutje, andej nga fillonin ca kopshtije, që fshihnin midis tyre shtëpi të vogla përdhese.

Në dhomë hyri me vrull Leonora. Fytyra i kishte marrë një çehre të zbehtë. Sytë e zmadhuar shprehës shtësim të dukshëm, ndërsa buzët e puthitura xheç fshihnin.

— Përse nuk e shuanë dritën, apo prisni të na futen brenda? — iu drejtua të shoqit.

Ai e vështroi si i kapur në befasi dhe murmuriti diçka që ajo nuk e kuptoi. I biri i kishte ngulur sytë diku te porta e jashtme, përmes xhamave që i rrihte shiu dhe era e fortë. Papritur ai thirri:

— Baba, eja të shikosh! Dalloj diçka të zezë. Më ngjan si njeri.

— Pse, hapur është porta?

— Më duket se e kam harruar unë ta mbyll.

Sa bëri dy çape, eëma ia preu rrugën dhe shoi dritën.

— U çmende, Ferdi — foli ajo, — apo do që të çmendem unë?!

Sapo shfaqi shqetësimin e saj, filloi të dridhej. As që e hodhi vështrimin nga dritarja. Ajo kishte frikë të madhe. Jetonte më shumë përvete dhe përdjalin. Qëndronte larg gjurulldive. Nuk i mungonin ndjenjat e holla, por ato ishin të mbyllura në një kornizë të ngushtë, që s'ë kapërcente pragun e shtëpisë së tyre. Në ndërgjegjen e saj nuk provonte asgjë për ata që përziheshin në punë të ndaluara e që pastaj u vinte radha ta «pësonin».

Zhurma u afrua përsëri rrëth shtëpisë së tyre. Ata dëgjuan ca thirrje, që tregonin se kérkonin dikë që u kishte shpëtar nga duart. Profesori, e shoqja ane i biri shikuani njëri-tjetrin, ashtu siç bëjnë ata që kanë gisht në një punë të ndaluar. Ferdi iu afrua përsëri dritares e, ndonëse kishte sy të fortë, nuk e dallonte dot se ç'ishte ajo gjë e zezë, që nuk lëvizte fare. Ai mori **inat me pemët**, që ia pengonin pamjen **duke zënë gozha vend** në të dy anët e kopshtit, në mes të të cilët shtrihet rrugëza që të conte te porta e jashtme.

Profesori, pasi ndoqi me kujdes shikimin e të birit, u kthyen nga e shoqja, dhe i tha:

— E di ç'ke ti, Leonora? Më mirë shko e fli! Ata do të ikin dhe pas pak edhe unë me Ferdin do të biem.

E shoqja diç **dyshoi**, por, kur pa fytyrën e tij të ngurtë e si pa shprehje, nuk kundërshtoi. Parasë të largohej, i tha:

— Shiko, Sami, në qoftë se do që unë të vdes nga frika, lëre djalin të dalë te porta! Atje s'ka as gjë, por edhe po të ketë, s'kemi nge ne të paguajmë për të tjerët, kuptove?

Ai nuk foli. Ajo mbylli derën. Ai e shoqëroi me një shikim të rreptë, ishte një shikim nga ato që paralajmërojnë shpërthim të furishëm dhe që përbahen me vështirësi. Pastaj, sikur ta kishin bërë me fjalë, atë e bir thanë, pothuaj me një gojë, se duhej sqaruar ajo puna e asaj hijes së zezë aty pranë portës tani që ishte larguar Leonora. Djali zgjati kokëns përsëri nga dritarja, pastaj doli jashtë në majë të këmbëve. Oborri ndriti nga vetëtima, që u shoqërua me shkrepëtimë rrufeje. Ai u sigurua se nuk ishte gënjer. U kthyen me të shpejtë. Bashkë me të atin

e futën brenda atë njeri, që kishte shpëtuar nga vdekja, por që nuk dihej që e priste në atë gjendje. Pasi e rregulluan me kujdes në kanapenë e gjerë, i shkopsitën xhaketën e lagur dhe atëherë panë njolla të kuqe gjaku të shpërndara në ije dhe në gjoks. I plagosuri nuk lëvizte fare. Buzët e thara e të rrudhura i kishin marrë një ngjyrë manushaqeje të fortë. **Sytë i mbante myllur, duart i kishte akull dhe frymëmarrijen mjafë të shpejtë. Kjo pamje i trembi. Mbetën për një çast të hutuar. I kapi një ndje-një pasigurie.** Pastaj i ati pyeti:

— Po tani ç'do të bëjmë? A ta zgjojmë mamanë?

Ferdi e shikoi si i habitur. Shiu rrihte me forcë xhamat e dritares. Iu përgjigj me ca fjalë të thëna shpejt e shpejt. E kundërshtoi mendimin e tij. Kishte frikë se e éma do të prishte punë me ndonjë skenë të papëlqyer e do t'uacaronte më tepër nervat. Më në fund, si ai njeriu që ndriçohet nga një mendim i guximshëm, foli me zë tjetër:

— Baba, më duket se kemi vetëm një rrugëdalje.

— Cilën? — pyeti i ati, dhe priti me një si ankth të përbajtur.

— Të shkoj unë qysh tani këtu afër e të sjell një kirurg?

Samiut sikur i plasi një bombë dhe e shurdhoi, prandaj iu mor goja kur i tha:

— Si?! Të dalësh jashtë në këtë orë e në këto rrethana?! As mos e shko në mendje, djalë! A kujton ti se ka të marrë të tillë që të vijnë këtu në këtë orë, dhe për çfarë se! Për të mjekuar një njeri që e kërkojnë e që, po ta kapin, e pushkatojnë në çast bashkë me bamirësin. Jo, jo, Ferdi! Kjo është me të

vërtetë marrëzi. Pastaj, a nuk më thua, cili është ky kirurg?

I biri nuk foli, por po e shikonte me nofulla të shtrënguara. Sytë e tij s'e fshihnin dot zemërimin. Samiu e kuptoi se ai u prek nga fjalët e tij një çikësi të tepruara e që, në fund të fundit, nuk shprehnin ndjenjat e vërteta të tij pér gjendjen e krijuar. Nuk priti që djali të hapte gojën, por vazhdoi:

— Dëgjo, mor bir! Kjo punë duhet peshuar me kandar farmacisti, si i thonë fjalës, sepse nuk kërkon pak, apo jo? Edhe unë nuk kam zemër të keqe, por kam vetëm një djalë. E kuptoj se duhet bërë diçka pér këtë tjetrin, por çfarë? S'jam në gjendje të jap ilaçin, që do ta mbyllte plagën, pa hapur një tjetër më, të madhe.

I plagosuri lëshoi një rënkim të mbytur. Të dy e shikuani me dhembshuri. Diku larg u dëgjuan përsëri të shtëna armësh. Vështrimet e tyre u kryqëzuan. Heshtje.

— Baba, — foli i biri, — në këtë moshë që jam besoj se i njoh mirë prindërit. Edhe ju keni pjesën tuaj në formimin tim si njeri. Në këtë çështje ju duhet të dilni ca më shumë e më shpejt jashtë caqeve të detyrës së ngushtë të babait të mirë pér djalin e pér shtëpinë e tij. Besoj se më kuptoni. Ja, ç'dua të them: Ju keni një zemër të ndjeshme, por e keqja është se nuk e lini atë të rrahë ca më tepër me pulsin që duhet në këtë kohë. Nuk është e vërtetë se zémra juaj nuk e dëshiron atë që thashë. Pra, ju e pengoni ndoshta pa dëshirë, pa vetëdije, ashtu si pér inerci. Kurse e mira, dhe jo vetëm jona, e do që çdo zemër shqiptari të ndershëm të rrahë më me forcë pér çështjet e mëdha. Unë çuditem pér këtë dhe më vjen të mos e besoj, kur sjell në mendje ca gjëra

që tregojnë të kundërtën. Qëndrimi juaj, baba, më kujton një enë me ujë, që e kemi vënë mbi një zjarr të madh, po që nuk duam të valojë shpejt, sepse kemi frikë se uji mund të derdhet. Që ta themi troq, edhe ju, po shumë më tepër mamaja, keni frikë se mos humbisni djalin, se atëherë i keni humbur të gjitha. Unë mendoj ndryshe. Nuk është e vërtetë se juve ju mungon guximi, në thellësi ju keni ndjenja shumë të holla, po nuk i lini ato të shpërthejnë, sepse nuk pranoni që ky shpërthim të mbajë me vete rrezikun e pandreqshëm. Më falni, baba, nuk dua t'ju fyej, por e ndiej se edhe ky siklet që keni tani mund të kapërcehet lehtë, po ta gjykojmë çështjen me gjakftohtësi e ca më ndryshe.

Ai heshti. Profesori po mendohej. Ishte hera e parë që po dëgjonte nga i biri fjalë të tilla. Vërtet ca gjëra ishin të rënda, por ai çuditej me logjikën e tij. Thellë në shpirt i jepte të drejtë. Nuk e kishte menduar kurrë se djali e njihte aq mirë. Sytë filluan t'i merrnin një si shkëlqim të lehtë. Dora e tij fërkonte pa pushim mjekrën. Ferdi foli përsëri:

— Ndofta s'është koha tani t'ju them gjëra të tjera, por ja që nuk mund të rri pa kujtar atë çështjen e drejtorit italian. Nuk di sepse më gufon zemra, sa herë përfytyroj atë skenë, kur babai im ia theu turinjtë atij të poshtri.

— Lëre atë, Ferdi, se më ngrihen nervat! — i tha i ati ballërrudhur.

I biri e kuptoi se atë mund ta rrëmbente ajo ngjarje, që kishte mbetur në mendjen e shumë kolegëve të tij si një dackë e që iu dha armikut në ftyrë flakë për flakë. Buzëqeshi dhe shkoi pranë të plagosurit. I ati shikoi të birin, pastaj të plagosurin, dhe iu duk sikur ata të dy nuk ishin të huaj për një-

ri-tjetrin. Ai bëri një lëvizje sikur deshi të çlirohej nga një brengë e madhe, fërkoi rishtas mjekrën dhe pyeti veten në heshtje:

«A është e vërtetë se e keqja, që mund të vijë nga një shërbim i mirë, është, në fund të fundit, shumë më e pranueshme sesa shërbimi me qëllim të keq?»

Tundi kokën. Buzëqeshi lehtë dhe i dha vetes përgjigje pozitive.

— S'kemi nga t'ia mbajmë, baba! — foli i biri.

— Unë nuk shoh zgjidhje tjetër. Do të shkoj. Mos kini merak! Sa të pini një cigare, do të jem përsëri këtu.

I ati mezi e dëgjoi. Ishte i turbullt. Koka i digjte dhe tëmthat i rrihnin me shpejtësi. Ai e pa të birin në sy dhe foli me zë të mekët:

— Po, po, ti ke të drejtë, ndryshe çdo gjë do të shkojë kët. Edhe ky ka prindër, — tha duke shikuar të plagošurin. — Ata presin t'u kthehet.

Ferdi hapi portën. Samiu e ndoqi largimin e tij me një farë ankthi. Në zemër ndjeu boshllëk. Ndezi një cigare, mbështeti bërrylin te pezuli i drifores dhe me sytë e ngulitur diku në oborr u kthye në atmosferën e elektrizuar të sallës së madhe të profesorëve. Atëherë ishte kapur keq me drejtorin, një farë Luixhi, intelektual fashist, që e vriste lart dhe e quante veten si të dërguarin e «perëndisë» për të shpëtuar besimtarët» e paditur të këtij vendi të egër. Ky drejtor fodull dhe i pacipë kishte cënuar rëndë dinjitetin e çdo shqiptari të ndershëm. Professor Samiu s'e kishte duruar. Drejtori, dyllë i verdhë në fytyrë, e kishte quajtur këtë një skandal politik.

Në çast e patën pushuar nga puna. Mezi shpëtoi pa u arrestuar. Pas shumë përpjekjesh dhe si kaloi mjaft kohë, mundi të zinte një vend të parëndësi-shëm në arsim.

Me një pompozitet të neveritshëm drejtori itali-an u kishte thënë atë ditë të gjithëve se qe një fat i madh për Shqipërinë që Italia fashiste i kishte zgjatur dorën plot mëshirë dhe po ngrinte nga balta, në qytetërimin e vërtetë perëndimor, një popull e një komb që, mjerisht, nuk kishin as tradita e as vlera kulturore për të qenë. Të gjithëve u ishte dukur sikur ai i qëlloi me hekur të rëndë në kokë. Profesor Samiut i patën kërcyer damarët e ballit, i qe marrë fryma, kishte brofur në këmbë dhe, duke tundur gishtin tregues, i qe drejtuar të huajt:

— Merrini prapa të gjitha ato që thatë! Turp, që po fyeni një popull e një komb me tradita të tilla, për t'i pasur zili jo vëtëm ju, por edhe shumë popuj e kombe që hiqen të qytetëruara. Populli ynë i vogël ka shpëtuar një Evropë të madhe për njëzet e pesë vjet me radhë, pa përjashtuar as vendin tuaj. Pa pastaj, mos vallë ju e keni fshirë nga kujtesa një-mijë e nëntëqind e njëzetën?! Jo, jo! Ju s'duhet ta harroni atë vit, se e provuat në kurrizin tuaj! Po edhe me shtatë prill të tridhjetenëntës ne nuk ju zgjatëm tufa me lule. Në vend të tyre ju patë tytat e pushkëve. Është e vërtetë se gjatë shekujve janë përpjekur, të na shtypin me hekur e me zjarr, po asnjeherë nuk na kanë gjunjëzuar. Ne s'jemi gatuar për t'u bërë temena të tjerëve. E kemi mbajtur shpirtin me një kothere bukë, me kripë e me ujë, po asnjeherë s'e kemi përfillur jetën, kur ka qenë puna për lirinë dhe nderin tonë. Sa për vlerat kulturore, ju, ose nuk i njihni ato (e nëse është kështu,

më mirë të mos flisnit fare), ose i shtrembëroni me paramendim, duke kujtuar se ne këtu jemi servilë e do t'ju mbajmë ison! Por vlerat tona vetëm një qorr nuk i sheh. Ato janë edhe në Romën tuaj të amëshuar, në Vjenë, Luvër të Parisit e kudo. Këto që ju thashë varini vath në vesh, drejtor i «nderuar»!

Fjalët e fundit ai i shqiptoi me një ton aq sarkastik, saqë italianni e humbi fare toruan dhe doli jashtë në çast, duke harruar kapelën.

Kjo ngjarje mori dhenë. Pas asaj dite profesorin e tregonin me gisht njerëz të thjeshtë, të rritur e të vegjël. Disa gra patën përgëzuar edhe të shoqen e tij, Leonorën, ndërsa ajo e kishte ndier. veten ngushtë e nuk kishte ditur si t'u shmangej, nga frika se mos do të vinin pasoja të rënda.

Atë mbrëmje në shtëpi kishte plasur një sherr i madh midis asaj dhe të shoqit. Ajo e atakonte burrin në një pikë delikate, ku kanë vend ndjenja të holla. I thoshte se ashtu si ishte sjellë Samiu, do të arrinte patjetër një ditë që ai do të merrte në qafë familjen, Pra atij duhej t'i vinte keq, në mos për të, të paktën për djalin. Sipas saj, do të ishte më e udhës që «mishi të piqej e helli të mos digjej». Madje, mund të qëndronte edhe mënjanë, gjithnjë i gatshëm për t'u angazhuar plotësisht, kur rreziku të ishte sa më i vogël, ose kur të mos ekzistonte fare. Pra, Leonorës nuk i pëlqente që i shoqi të lidhej përgjithmonë me diçka, ca më tepër kur nuk dihej ende çrrugë do të merrnin ngjarjet. Ajo nuk donte kurressi që ai të dilte në pah para kohe.

Duke shfaqur këto pikëpamje, Leonora e kishte të qartë se Samiu nuk ishte nga ata që shohin e presin. Ajo e dinte se ai s'e bënte dot këtë. Kishte një

karakter tjetër. Ajo e pranonte në fund të fundit, ndonëse si diçka të papëlqyeshme, që ai të mbetej ashtu siç ishte, por ama të mos bënte asnje hap tjetër përpara, me qëllim që,, edhe në rrethanat më të disfavorshme, të mos konsiderohej kurrë përgjegjës.

Kësaj logjike profesori i qe përgjigjur ashpër, duke thënë se ajo nuk do ta kuptonte kurrë burrin e saj. Arsyetimet e Leonorës i kishte hedhur poshtë me neveri, duke i quajtur po aq të këqija sa ato të Ballit Kombëtar. «Sikur të gjithë të kishin bindjet e tua, — i pat folur ai një ditë, — fashistët mund të qëndrojnë këmbékryq në Shqipëri një mijë vjet e rehat-rehat.» Samiu ia kishte bërë të qartë se mendimet e saj njollosnin formimin e tij si njeri i ndershëm e patriot, bile gjithë familjen.

Ajo ishte përpjekur ta kundërshtonte, duke ngulur këmbë se ai e kishte keqkuptuar dhe se i zmadhoente gjérat. I shoqi nuk qe bindur dhe e kishte aku-zuar për dredhi. Asaj i qenë mbushur sytë me lotë, kur ai i pati thënë se pikëpamjet e saj nuk ishin vetëm në dobi të armikut, por përmbanin një cinizëm të tillë, që vetëm njerëz me moral të dobët mund t'i përvetësonin aq mirë sa ajo. Pastaj i kishte dhënë fund bisedës me këto fjalë:

— Unë e çmoj njeriun, mbi të gjitha, për ndershmërinë në kuptimin e gjerë të fjalës, për qëndrueshmërinë dhe guximin. Nuk jam nga ata, që kërkojnë të bëhen padronë të gjahut në luftën e fituar me duart e të tjera. Jam i lidhur përgjithmonë, jo qysh tanë, por shumë më përpara, me një rrugë, me atë të lirisë për atdheun. Në qoftë se kjo «dasma» e të gjithëve do të kërkojë diçka edhe nga unë, apo nga familja ime. nuk jam kundër. Në këtë pikë edhe yt bir gabon në gjykimin për babanë. Po të ma go-

dasë rëndë sedrën, do të vuaj dhe ndoshta mund të vdes nga dhimbja e madhe. Veçse, në paça frymë, inatin do t'ua nxjerr atyre që do të më shkaktojnë fatkeqësinë. Nuk e çmoj ngutjen e as papjekurine. Ti më njeh. Nuk dua të besoj se je aq e keqe sa kërkon të tregohesh, por janë tekat e, pér më tepér, frika e tmerrshme para rrezikut, që të çon deri aty, sa të thuash marrëzira të tilla, që na mbulojnë me turp të tre. Kur flas pér frikën, unë nuk e pérjashtoj atë frikë të zakonshme ose, si të them, diçka tjetër të ngjashme, nga e cila nuk jam çliruar plotësisht as unë, por pér atë frikë që të paralizon fare. Ja, pra; pérse e kam fjalën!

Leonora e ndjeu fyerjen e rëndë, e cila u duk përsëri në sytë e saj me lotë. Kur ranë pér të fjetur, ajo u pérpoq të vinte në peshore mendimet e saj dhe ato të të shoqit. Në fillim, të sajat rënduan më tepér, por, kur u pérpoq të rikujtonte ç'i kishte thënë ai, vuri re me keqardhje se si peshorja e saj u bë më e lehtë. E largoit mendjen dhe u rikthyte te të sajat. Pér çudi, kandari vërtet lëvizi pak në favor të saj, por nuk shkoi deri aty ku kishte qenë në fillim. Atë natë ajo bëri shumë pohime e mohime. Ishte e turbullt. Bindjet e saj nuk e kishin më atë formën e prerë si kallëp, që të çon ndonjëherë deri në humbjen e logjikës.

Me këto kujtime, kaluan plot njëzet minuta. Dy-tri rrugica pas shtëpisë së tyre u dëgjua një britmë e mbytur, që u shua kur krisi një pushkë. Profesorit i ngriu gjaku. Në domë u fut e shoqja. Ajo shtangu, kur pa një njeri të huaj shtrirë në kanapë.

— Sami! — thirri me forcë, — ku është Fredi? Po ky djalë ç'do këtu? Fol de, fol! Se...

Para se Samiu të përgjigjej, ajo u zverdh, u

mënjanua ca dhe humbi ndjenjat. Profesori mezi e solli në vete. Ai e njihte mirë gruan e tij. Dhe ja, tani ajo do të nxirrte përsëri telashe të tjera. Duke e shikuar ngultas, e kuptoi se po i skuqeshin veshët. Po i hipte inati, një inat që kishte ditur gjithnjë ta përbante, por kurr ta mposhtte përfundimisht. Ndezi cigaren dhe, duke shikuar të shoqen, iu kujtua edhe një herë ajo kohë e largët, kur që martuár me të vetëm pér hir të bukurisë. Ajo e kishte dëshpëruar shumë herë. I kishte marrë një kohë të gjatë dhe energji të mëdha në përpjekjet pér ta afruar me mendimet e tij pér jetën, pér shoqërinë. Kishte ardhur një ditë kur e pati ndier veten të drobitur fare dhe atëherë i kishte dhënë fund kësaj pune me mendimin e prerë, se jeta bashkëshortore nuk të jep dorë sa duhet pér të ndryshuar ca pika të forta të mentalitetit të njeriut, sepse nxjerr çdo ditë probleme të reja, të mprehta e të ngatërruara. Mendoi përsëri me keqardhje se e shoqja kishte mbetur pothuaj njëlloj si atëherë. E vështroi rishtas dhe tha me vete se tek ajo vepronin me forcë uni, frika gjer në palcë, po edhe vesi i të shtirurit. Kjo e metë e fundit e së shqes i shkaktonte një neveri të madhe.

Pak nga pak Leonora u duk sikur e mori veten, por, kur ai ndeshi në shikimin e saj dhe vuri re sytë e zmadhuar e të zbehtët e dukshëm, e kuptoi se po afrohej stuhia. Iu mblodh një lëmsh në grykë dhe bëri një gjest, të cilin ajo e njihte mirë. Për çudi, në vend që të shpërthente, e shoqja u ligështua përnjëherë. Atij iu duk se u shtir nga frika se mos e fynente. Turfulloj nga inati, por përsëri e mbajti veten. Nuk donte andralla të tjera. Iu kujtua vdekja e xhaxhait të saj. Ato ditë ajo dukej e hidhëruar ja-shtë mase. Kjo kishte rënë në sy. Atij i kishte zënë

veshi shumë fjalë. Të tjerët thoshin se ajo shtirej. I mbeti në kokë kjo gjë dhe e forcoi mendimin se edhe hidhërimet e mëdha fshehim nganjëherë hipokrizi.

I turbulluar nga këto mendime, ai pështyu në dysheme, pa e kuptuar fare se e bëri këtë për herë të parë në jetën e tij.

I plagosuri filloi të rënkonte thellë. Samiu ia lagu buzët me ujë të ftobët. Në çast e shoqja lëshoi një britmë të mprehtë. Ai e kapi për krahësh dhe e çoi në dhomën tjetër. Balli i saj u mbush me surabullë djerse dhe duart filluan t'i dridhesin. U përpoqta qetësonte, po ajo u ngrit me vrull nga divani dhe thirri:

— Djalin, djalin! Ku e ke çuar, i pashpirt? Ti po më fut në dhe për së gjalli. Po ai tjetri? Do të na kapin të gjithë. E zeza unë!

Ai s'e kishte parë kurrë në atë gjendje. E kuptoi se frika e saj kishte arritur pikën më të lartë. Ndërkaq, u hap porta dhe ata panë të birin. Të dy mbetën si të shtangur. Ferdi qe bërë qull në djersë. Me njérën dorë shtrëngonte tjetren. Leonora brofi në këmbë, sikur të mos kishte pasur asgjë dhe, duke belbëzuar fjalë të palidhura, u lëshua drejt tij.

— Mos thirrni kështu, se dëgjoheni jashtë! — folla ai dhe vazhdoi: — Ti, mama, qetësuhu! S'ka asgjë për t'u bërë merak. Më mirë më jepni ca jod për të mjekuar krahun. S'është ndonjë gjë e madhe, veç një gërvishtje. Më vjen turp kur e mendoj. Njëqind herë më mirë të isha plagosur!

E éma e ndjeu se i biri i tha ato fjalë me gjithë mend, ndaj bebet e syve të saj u zmadhuan. Ajo filloi të ecte nëpër dhomë, pa ditur ç'të bënte. Sytë herë-herë i shkreptinin, herë-herë i shuheshin. Tani

shihte vetëm një njeri, të birin, po duart s'i bënин pér asgjë. Pastaj profesori dhe e shoqja dëgjuan ashtu si më tym ato që nisi t'u tregonte djali. Ai kishte shkuar në shtëpinë e doktorit, pa i ndodhur asgjë shqetësuese. Nuk ishte futur nga porta, por kishte kapercyer murin nga ana e kopshtijeve. Pasi qe takuar me të, i ishte lutar të vinte në shtëpinë e tyre pér të mjekuar një të plagosur rëndë. Doktori e kishte çuditur me qëndrimin e ftohtë. Po Ferdit i kishte bërë më shumë përshtypje diçka tjetër.

— Mirë, po nuk më the, si e quajnë? — e ndërpreeu i ati.

— Do ta shihni së shpejti, baba.

— Mirë, mirë, vazhdo!

Doktori ia kishte thënë troç, nëse kishte siguri në shtëpinë e tyre më parë pér të plagosurin, pastaj edhe pér atë vetë. Djalit i qenë skuqur faqet nga turpi, por kishte heshtur dhe qe larguar, pasi e kishte bindur se nuk paraqitej asnë rrezik. Si kishte kaluar dy rrugicat e para, pati dëgjuar zëra dhe e kishte kuptuar se ata ishin të patrullës. Në mes të rrugës ajo i doli ballë pér ballë. U kthyte prapa. Fa-shistët i thirrën të ndalej. Ai u ngjit si mace në një mur rrethues. Krisi një pushkë. Ai kapercceu në anën tjetër. Krahu nisi t'i digjte sikur t'ia kishin futur në ujë të valuar. Ata nuk e ndoqën. S'e kapercyen dot murin. Ferdi u fsheh në ca kopshtije dhe, më në fund, shpëtoi.

Kur mbaroi së foluri, profesorit i mbeti mendja te dyshimi i doktorit. E zuri atë në gojë, shtrembëroi buzët dhe shikoi të shoqen. Ajo uli kokën. E ndjeu se dyshimi kishte lidhje me të. Pastaj, sikur kjo çështje të qe rrahur gjë e gjatë, Samiu u hodh e i tha të birit:

— Tani nuk është koha për pikëpamjet e njërit apo të tjetrit. Unë kam frikë se ai doktori yt nuk do të vijë.

— Jo, baba. Ai do të vijë, po mund të vonohet. Ndoshfa patrulla vërtitet ende aty rrotull.

Ora e murit ra njëmbëdhejtë herë. Profesori shkoi pranë të plagosurit. I biri doli në oborr. Nën shikimin e s'ëmës, ku frika dukej hapur, ai rrëshqiti deri te porta e jashtme dhe hoqi llozin. Kur hyri prapë në dhomë, e ëma e pyeti përsëri për krahun. Ai iu përgjigj me ca fjalë, që tregonin se përkujdesjet e tepruara e bezdisnin. Ajo heshti. I shoqi kishte qëndruar pranë dritares. Sytë i mbante ngulur diku në një pikë të errët të oborrit. Priste si një hije e heshtur. E ndiente veten të rraskapur dhe i vinte keq që shumë herë edhe disa gjëra të thjeshta nuk zgjidheshin shpejt e pa zhurmë. «E pse të jetë aq e ngatërruar kjo që po ndodh sonte te ne?» pyeste vete. Ai kujtoi bisedën me të birin dhe buzëqeshi i lehtësuar, kur mendoi se Ferdi ishte ende i ri e mbase edhe mund të gabonte, por nesër ai do të bëhej patjetër më i aftë se i ati. Mos vallë nuk e njihte sa duhej të birin? Buzëqeshi përsëri, kur tha me vete se nuk ishte sociologja që mësonte në shkollë ajo që e kishte zhvilluar aq shumë Ferdin, por një sociologji tjetër, shoqërimi i tij me komunistët, që i kishte dhënë atë logjikë të fortë e atë guxim për t'u pasur zili. Tundi kokën, sikur deshi të qortonte veten.

Porta e jashtme u çel pa zhurmë dhe dikush rrëshqiti nëpër oborr me hapa të shpejtë. Në dhomë u fut një burrë i shkurtër. Samiu shqeu sytë, kur pa doktor Janin. S'i kishte shkuar kurrë në mendje se edhe ai punonte për komunistët. Të dy kishin studiuar në një universitet. Si kolegë të vjetër kishin

ruajtur për njëri-tjetrin një farë miqësie, të bazuar në një shoqëri të largët e cila kishte mbetur prapa nga rrjedha e ndryshme e ngjarjeve.

— Mirëmbrëma zonjë, mirëmbrëma profesor! Besoj se nuk ju shqetësoj, ndonëse janë orë të vona e rrethana...

Doktori i zgjati dorën Leonorës. Ajo vetëm sa e çiku me të tijën, dhe e tërroqi shpejt të sajnë. Kurse me Samiun mbeten për disa sekonda me duart të bashkuara. Pastaj, aty për aty nisën të rrithnin shpatullat e njërit-tjetrit.

— Ju lutem, — foli ai, — më ndihmoni për të zhveshur të plagosurin!

Pa mbaruar mirë së foluri, doktori pa Ferdin që po i shkopsiste xhaketën. Samiu bëri përpara e u bashkua me të birin. Leonora mbeti pa lëvizur, e hutuar, me faqe të zverdhura, me sytë fare pa jetë.

Doktor Jani shtrembëroi buzët, kur pa plagën, po nuk foli. Hapi çantën, kërkoi ca ujë të nxeh të dhe një drithë të fortë afër.

— Si duket puna? E vështirë, apo jo? — e pyeti profesori.

— Plumbin do t'ia heqim, megjithëse i ka mbetur thellë. Këtë djalë nuk e njoh, por më duket se qenka trim! Unë e besoj atë që thonë, se trimat vritten më pak nga frikacakët, bile edhe që vdesin vetëm një herë, kurse frikacakët njëqind herë.

Leonora, që pati lëvizur si me përtesë, u skuq, vuri aty pranë ato që i kërkoi doktori dhe me sytë e ulur, padashur, nisi të mendonte për punën e rëndë të këtij njeriu, që kishte ardhur aty në atë orë të vonë të natës, pa marrë në sy rrezikun që i kanosej atij vëtë dhe shtëpisë së saj. Shikoi fshehurazi të shoqin dhe e ndjeu se atë çast atë e hante meraku

shtur me bindjen se koha do të bënte të sajën, ndërsa ngjarjet që po zhvilloheshin do të sqaronin shumë pika të errëta. Vështroi nga doktori, vuri re se ai i buzëqeshi të plagosurit. Duke fshirë djersët e ballit, tha me sy të shkëlqyer:

— Për mua, ky djalë shpëtoi.

Samiu i shtrëngoi dorën më shumë se miqësisht, ndërsa i biri e përqafoi. I këputur nga lodhja dhe përgjegjësia, doktori u lëshua në kanape, që kërciti fort, ndezi një cigare dhe filloi ta hiqte me tërë mushkëritë.

— Silli doktor Janit një limonadë e një kafe të fortë! — i tha Samiu së shoqes.

Ajo shkoi në kuzhinë dhe atij iu duk sikur ecte më lehtë. Po edhe vetë Leonora filloi të ndiente se diçka po shkonte mirë. Limonada dhe kafeja po nxirreshin për shkak të operimit të të plagosurit. Pra, ajo po i shërbente atij. Shpirti i saj i shqetësuar po i mbante gjatë ca gjëra, që më parë i dukeshin aq të frikshme dhe të padurueshme. Kur i solli pijet doktorit, ajo e falënderoi për atë që bëri, e pastaj, si një njeri që ëan borxhin, iku me të shpejtë pranë djaloshit të plagosur. Samiu e vuri re dhe e shikoi të shqen me një farë dhëmshurie. Doktori theu heshtjen duke rrufitur lëngun e zi e të trashë.

— Më falni, zonjë! Dua të jem i singertë. Nuk di, nëse ju tha gjë djali. Unë në fillim pata vërtet dyshim, sepse të tjerët nuk ju bëjnë njeri me iniciativa të tillë.

Pasi e hoqi edhe disa herë cigaren, doktori foli përsëri:

— Unë e burri juaj, zonjë, jemi kolegë të vjetër. Të gjithë sa ndodhën sonte në këtë shtëpi na gëzojnë, sepse shpëtuam bashkë një njeri tonin, një dja-

losh të guximshëm njëzetvjeçar. Unë i heq këtij kapelën me mirënjojje, sepse u hodh në zjarr, jo vëç për vete, po për të gjithë popullin.

— Ju e shpëtuat, doktor, jo ne! — tha Leonora me zë të dredhur dhe i uli sytë me të shpejtë përdhe.

— Jo, jo, nuk është kështu si thoni ju! Atë e shpëtuam tok. Ju e futët në shtëpi, pa marrë në sy rrezikun. Djali juaj erdhi tek unë, pa përfillur patrullat armike, kurse unë bëra vetëm detyrën e mjetkut.

Leonora u skuq rishtas. Profesori ndërhyri:

— Dëgjoni, doktor Jani! Nuk është e drejtë që thjeshtësia të mbulojë të vërtetën! Pa ju, ne nuk kishim ç'të bënim. A është kështu, Ferdi?

Ai shikoi të birin, që pohoi me kokë.

— Zoti Jani, — foli Leonora me buzë të dridhura. — Më vjen edhe turp edhe inat. Nuk jam aq e keqe sa mund të mendojnë njerëzit. Kam edhe unë zemër néné. E kuptoj se diçka më mungon, kjo është e vërtetë. Nuk jetoj me gjërat e mëdha, që kanë me vete tronditje të thella shpirtërore, po që janë një-kohësisht fişnikë. Nuk jetoj me to, jo se thellë në zemër nuk më pëlqejnë. Por, është diçka tjetër që më pengon. Unë jam mbytur me cikërrimat e jetës. Dhe, kur cënoheshin këto, mua më kapte frika. Më dukej sikur shembej tërë shtëpia. Ja, kështu u rrit tek unë kjo ndjenjë, që tani është bërë e padurueshme për të tjerët. Si duket, unë e kam fajin. Megjithatë, im shoq nuk besoj të zemërohet, po të them se në këtë mes diçka i takon edhe atij, ndonëse ka pašur mjaft telashe për vete dhe, më vret e mira, po të pohoj se nuk është marrë edhe me mua.

Profesori u kollit me qëllim që të mos fliste.

për të ngrënë. Kur hyri në dhomë, doktori po bisedonte me të shqin. U afroa tek i plagosuri dhe i vu-ri dorën në ballë. Ai i buzëqeshi. Ajo i ktheu atij bu-zëqeshjen dhe i tha doktorit:

— Zoti Jani, sa duhet të rrijë pa lëvizur djali?

— M'indha mua porositë, — iu përgjigj i shoqi — dhe ja bëri me shenjë të birrit të përcillte doktorin.

RROBAT MË TË BUKURA NË BOTE

Një mëngjes të freskët të vjeshtës së dytë të vitit 1944, kur dielli «notonte» midis reve të holla e të bardha, partizanët hynë në tërë përiferinë e qytetit. Hitlerianëve u mbeti vetëm qendra.

Njerëzit sa s'kërcenin prej gëzimit, ata vërshonin nga çdo anë pa dashur t'i dinin për predhat, që plasnin orë e çast, për mitralozët, që sokëllinin papushim. Dilnin nga shtëpitë e vjetra, e suleshin nëpër rrugët. Edhe fëmijët, që nuk kishin mësuar ende të ecnin mirë, edhe më plakat e më pleqtë, që mezi capiteshin, donin të çmalleshin me partizanët. Ishte një takim, që vështirë se mund të fiksohet, qoftë edhe në pikturat më të goditura. Tek disa lotët e gëzimit përzireshin me hidhërimin e thellë që sjell humbja e të afërmëve. Përqafimet, fjalët që nuk fshihnin asgjë, gjithçka, e bënин atmosferën e atyre çasteve të skalitej si me daltë thellë në shpirtra.

Komisarit të kompanisë i mbetën sytë tek një çunak nja katërmbydhjetë vjeç, që nuk sillej si të tjerët, që as qeshte e as fliste. U afrohej partizanëve me një kërshëri e mallëngjim të çuditshëm. Komisari e pa se si ai rrëshqiti lehtë-lehtë në një qoshe,

pranë një muri të veçuar. E shoqëroi me shikimin e tij të mprehtë. Djali mbeti për disa çaste me sytë të ngulura mbi pushkën e një partizani. Pastaj e preku atë ngadalë, sikur të friksohej se mos e shanin. Dora e partizanit lëmoi flokët e tij të prerë shkurt, ndërsa çunaku e shikoi në një mënyrë të pakuptueshme. Komisari u bë kureshtar. Nisi t'i afrohej, por s'arriti ta takonte, se dikush e thirri. U kthyesh pas njëzet minutave. Atëherë, në një pikë, ku rruga bënte një bërryl të fortë, po ngrihej një barrikadë. Partizanë e popull po hidhnin në kapicë ç'gjenin rrëth e rrotull. Komisari vërejti e nuk u kënaq. Erdhi edhe komandanti i kompanisë. Të dy kishin një mendim. Barrikada duhej forcuar. Dhe ashtu u bë. Pak më vonë sollën aty hekurishte, rrota karrocash e lloj-lloj sendesh të tjera. Ajo do të përbënte vijën e parë të luftës. Më tutje nazistët kishin strofkën e tyre. Domosdo, nuk do të bënin sehir.

Kur dielli ishte në të perënduar, komandanti e komisari dolën për t'i hedhur një sy vendit rrëth e qark. Zbuluesit kishin njoftuar se dukeshin shenja për një sulm armik. Papritur komisari qëndroi. Komandanti, që kishte bërë disa hapa përpara, ktheu kokën dhe e priti të afrohej. Tjetri seç foli e pastaj ia bëri me dorë dikujt. Ishte përsëri ai çunaku, që endej tërë ditën midis partizanëve. I foli me zë pak si të vrazhdë:

— Pse rri këtu e nuk vete në shtëpi? Po sikur të jenë duke të kërkuar? Apo të na i vënë fajin neve? Hapt, ik që tanë, se më vonë s'dihet ç'ndodh!

Pionieri nuk foli. Sytë e tij shkëlqenin sikur lëshonin rreze të forta drite. Edhe komandantit i bëri përshtypje ai shikim, por nuk donte ngatërresa, prandaj i tha me një ton urdhërues:

— Ty po të flasim, Largohu menjëherë! Merr vesh?

Çunaku uli kokën, diç belbëzoi e nuk luajti nga vendi. Komisari e komandanti shikuan njeri tjetrin.

— More, do ikësh apo si e kë hallin? Çfarë je ti, që nuk bindesh? A je partizan, apo...

Vetëm kur dëgjoi këto fjalë të komisarit, u duk sikur ai u përmend, tamam siç na ndodh kur kalojmë ethe të forta. Sytë e tij u përlotën. Nuk i fshiu atame mëngën e trikos së vjetër e të grisur, por i la të rriddhnin ato sumbulla të ndritshme, që fshihnin një duf të madh.

— Nuk largohem, — tha i vendosur. — S'jam i vogël e as frikacak. Më jepni një pushkë e do të shihni po s'thatë: Sa mirë bëmë që e mbajtëm!

— More, qënke bilbil ti! Si të quajnë? — e pyeti komisari.

— Elmaz, po Maze më thërresin.

— Ashtu! Ta gëzosh! Po... ç'ke ndër mend të bësh, po të mbajtëm?

Elmazi ia priti:

— Unë ç'do të bëj?! Po kjo dihet: Do të vras gjermanë sa të ngopem, ja këtë do të bëj. Ata janë qenër. Vranë gjyshin e shokut tim. Hynë në shtëpinë e tij, se kërkonin një komunist. Atje gjetën vetëm gjysh Ramizin. Ai ishte i sëmurë shumë. Gjermanët sec i thanë, po ai s'kishte fuqi të nxirrte zë. Njeri nga ata u nxeh, i ra fort në kokë me fundin e automatikut dhe e la të vdekur.

Komisari e komandanti po e dëgjonin me vëmendje. Ai vazhdoi pa marrë frymë:

— Jam mërzitur duke çpuar gomat e makinave gjermane. Tani dua të luftoj si partizan. Të marr

pranë një muri të veçuar. E shoqëroi me shikimin e tij të mprehtë. Djali mbeti për disa çaste me sytë të ngulura mbi pushkën e një partizani. Pastaj e preku atë ngadalë, sikur të friksohej se mos e shanin. Dora e partizanit lëmoi flokët e tij të prerë shkurt, ndërsa çunaku e shikoi në një mënyrë të pakuptueshme. Komisari u bë kureshtar. Nisi t'i afrohej, por s'arriti ta takonte, se dikush e thirri. U kthyen pas njëzet minutave. Atëherë, në një pikë, ku rruga bënte një bërryl të fortë, po ngrihej një barrikadë. Partizanë e popull po hidhnin në kapicë ç'gjenin rrëth e rrotull. Komisari vërejti e nuk u kënaq. Erdhi edhe komandanti i kompanisë. Të dy kishin një mendim. Barrikada duhej forcuar. Dhe ashtu u bë. Pak më vonë sollën aty hekurishte, rrota karrocash e lloj-lloj sendesh të tjera. Ajo do të përbënte vijën e parë të luftës. Më tutje nazistët kishin strofkën e tyre. Domosdo, nuk do të bënin sehir.

Kur dielli ishte në të perënduar, komandanti e komisari dolën për t'i hedhur një sy vendit rrëth e qark. Zbuluesit kishin njoftuar se dukeshin shenja për një sulm armik. Papritur komisari qëndroi. Komandanti, që kishte bërë disa hapa përpara, ktheu kokën dhe e priti të afrohej. Tjetri seç foli e pastaj ia bëri me dorë dikujt. Ishte përsëri ai çunaku, që endej tërë ditën midis partizanëve. I foli me zë pak si të vrazhdë:

— Pse rri këtu e nuk vete në shtëpi? Po sikur të jenë duke të kërkuar? Apo të na i vënë fajin neve? Hajt, ik që tani, se më vonë s'dihet ç'ndodh!

Pionieri nuk foli. Sytë e tij shkëlqenin sikur lëshonin rreze të forta drite. Edhe komandantit i bëri përshtypje ai shikim, por nuk donte ngatërresa, prandaj i tha me një ton urdhëruar:

— Ty po tē flasim. Largohu menjëherë! Merr vesh?

Çunaku uli kokën, diç belbëzoi e nuk luajti nga vendi. Komisari e komandanti shikuan njeri tjetrin.

— More, do ikësh apo si e kë hallin? Çfarë je ti, që nuk bindesh? A je partizan, apo...

Vetëm kur dëgjoi këto fjalë tē komisarit, u duk sikur ai u përmend, tamam siç na ndodh kur kalojmë ethe tē forta. Sytë e tij u përlotën. Nuk i fshiu ata me mëngën e trikos së vjetër e tē grisur, por i la tē rridhnin ato sumbulla tē ndritshme, që fshihnin një duf tē madh.

— Nuk largohem, — tha i vendosur. — S'jam i vogël e as frikacak. Më jepni një pushkë e do tē shihni po s'thatë: Sa mirë bëmë që e mbajtëm!»

— More, qenke bilbil ti! Si tē quajnë? — e pyeti komisari.

— Elmaz, po Maze më thérresin.

— Ashtu! Ta gëzosh! Po... ç'ke ndër mend tē bësh, po tē mbajtëm?

Elmazi ia priti:

— Unë ç'do tē bëj?! Po kjo dihet: Do tē vrash gjermanë sa tē ngopem, ja këtë do tē bëj. Ata janë qenër. Vranë gjyshin e shokut tim. Hynë në shtëpinë e tij, se kërkonin një komunist. Atje gjetën vetëm gjysh Ramizin. Ai ishte i sëmurë shumë. Gjermanët seç i thanë, po ai s'kishte fuqi tē nxirrte zë. Njeri nga ata u nxeh, i ra fort në kokë me fundin e automatikut dhe e la tē vdekur.

Komisari e komandanti po e dëgjonin me vëmendje. Ai vazhdoi pa marrë frymë:

— Jam mërzitur duke çpuar gomat e makinave gjermane. Tani dua tē luftoj si partizan. Të marr

edhe hakun e nënës e të babait. Ata më janë vrarë të dy nga bombardimet e fashistëve.

Ai heshti. Heshtën dhe dy të tjerët. Paštaj në ajër fërshëlleu një predhë artilerie. Ajo ra pak më tutje, në një urë të vogël. Komisari dhe komandanti shikuan andej nga plasi predha. Nuk vonoi e u dëgjua një zhurmë tanku. Tre partizanë po afroheshin, me të shpejtë. Ndërkohë në kthesën e parë të rrugës sokëlliu një mitraloz sharrs. Komisari e komandanti u larguan me ngut. Pas pak e gjithë kompania kishte zënë pozicion luftimi. Kurse Elmazi kishte mbetur vetëm e i pikelluar, se nuk kishte marrë ende përgjigje. Rinte në këmbë, me duart prapa kurrizit, me një gjakftohtësi, që të bënte edhe të qeshje, edhe të mendoje. Dukej si ndonjë komandant i vogël, që bën llogaritë përbetejën e afërme.

Si kaluan ca minuta, komisari u çudit që çunaku s'kishte luajtur vendit. Iu afrua dhe filloi ta merrte me të mirë.

Por, Elmazi ia ktheu:

— O shoku komisar! Mos më përzë, se nuk largohem! Unë e di sa ju kam pritur. Edhe në ëndërr ju kam parë të vini.

Komisarit i erdhi keq, po edhe i pëlqeu këmbëngulja e çunakut. I shkrepi mëndimi ta mbante në kompani. Por, ajo që e vendosi kryekëput këtë çështje qe diçka, që ndodhi ato çaste.

Partizanët e dinin se armiku do të përpinqej të çante rrëthimin, që po i zinte frymën, prandaj kur u dëgjuan krismat e pushkëve, plasjet e bombave dñe zhurma e tankeve, u hodhën në kundërsulm të menjëhershëm. Hitlerianët u prapsën, duke lënë në më pak se dy orë rrëth tridhjetë të vrarë.

Përpëra barrikadës kishte një ledh, fill pas tij

ndodhej një si kanal. Gjatë përpjekjes njeri nga gjermanët kishte arritur deri te kanali. Prej atje ai qëllonte me breshëri automatiku. Komisari i kompanisë shkeli këmbëzën e «belzhikut». Döra e gjermanit u u var sakaq sipër dheut. Kur u prengatit të qëllonte për së dyti, u step i trondit. Gishti i mbeti te këmbëza e pushkës. Dikush po rrëshqiste këmba-doras për te i vrari. Komisari e njohu mënjjehérë. Ishtë përséri ai, Elmazi. I thirri me emër dhe e urdhëroi të kthehej prapa, po nuk mori përgjigje. Djali vazhdoni të ecët me kërcime, si ndonjë mace e egër. Atë kohë nga ana e një shtëpi dykatëshe rrëthuár me pëmëtë dendura, erdhi një plumb. Përpara Elmazit u ngrit një re e hollë pluhuri. E qëlluan, por s'ë vrani. Që nga ai çast, partizanët ndoqën me ankth duelin që u bë midis një çunaku të paarmatosur, që dënte të arrinte me çdo kusht nazistin pa jetë, dhe shnjperit armik që përpiquej ta qëllonte për vdekje. Për çudi, sikur të ishte rëggjur në kuşchedi sa luftime, ai bëhej si i vrarë, sa herë qëllonte hitleriani. Partizanëve u ngrinte gjaku. Njeri prej tyre lëshoi në drejtëm të shtëpisë dykatëshe një breshëri mitralozi. Elmazi e shfrytëzoi edhe këtë rrethanë. Shnjperi u inatos. I bëri më të shpeshta qitjet, por më kot, se çuni, me kërcime dhe ecje zikzake, shpëtoi përmrekulli gjatë kalimit të një vendi të sheshtë. Kur u kthyte tek partizanët, qe rrjepur, në duar e bërryla. Njera faqe i kullonte gjak, por ai nuk ishte fare në vete nga gëzimi. Komisari e shtrëngoi në krahet e tij dhe harroi ta qortonte. Të tjerët po e përpinin me sy atë guximtar të vogël. Trikoja e vjetër me kopsa, shumë e madhe për trupin e tij, ishte shpuar në dy vende. Elmazi nuk kapte asgjë atë çast nga përshtypjet e atyre që e rrethonin. Ai vetëm përkëdhelte automa-

tikun fringo tē ri, që ia kish marrë armikut, e që mund ta kishte paguar me kokë. E lëmonte atë me ato gishtat e vegjël, e mezi sa merrte frymë nga gëzimi. Komisari i shkeli syrin komandantit dhe me vështrimin mbi çunakun tha:

— Hallall tē goftë, o Elmaz! Veçse kam frikë se është i rëndë për ty e s'e mban dot.

Elmazi aq donte. Iu hodh krahëhapur dhe e përqafoi.

— Keni për tē parë se qđo tē bëj unë tan! — ia ktheu komisarit dhe i ra armës me pëllëmbën e dorës. Të gjithë panë se si i xixëlluan sytë nga lumturi, —

Komisari vazhdoi pa e përmbajtur dot buzëqeshjen:

— Ta zemë se tē mbajtëm, por puna është se mos na katranos prapë ndonjë gjë tē pahirë.

Elmazi u pre fare. I mbeti pështyma në grykë.

— Pse e vogël qe ajo që bëre? A e di ti se partizani, që vepron me kokën e vet dhe nuk i bindet urdhërit ndëshkohet rëndë? Por, ne po ta falim këtë radhë, se ti nuk i dije këto rregulla, e se u tregove trim, partizan i vërtetë.

— Domethënë jam partizan, shoku komisar? — pyeti Elmazi duke u dredhur i téri nga emocionet.

Komisari qeshi. Elmazi sa s'u çmënd. E ngriti armën sipër kokës dhe u rrotullua me tē aq sa iu morën mendtë.

*

*

*

Atë natë Elmazi ra tē flinte në një shtëpi afër barrikadës. Automatikun e mbante te koka e rripin e tij tē mbërthyer fort me duar. Komisari pinte cigare

dhe e shikonte me dhimshuri, po edhe me një farë shqetësimi. Luftë ishte. Po sikur t'i ndodhët ndonjë e keqe? Mendonte e mendonte e më në fund qetëso-hej. S'është i pari ky që lufton me armikun në këtë moshë, thoshte me vete—. Ka të tjerë plot. Lufta jo-në ka ngritur në këmbë të madh e të vogël. Ja, Dho-ri! Kur erdhi në fillim, kaq sa Mazja ishte, po ç'të luftuar që ka bërë se! Kështu edhe Bardhyli. Po ku do të jetë, vallë, ai tanë? Me siguri diku me pushkën krahut».

Picërroi sytë dhe u kthyë me kujtime një vit më pas. Atëherë Partia i pati ngarkuar një detyrë të vështirë, të nxirrte nga qyteti dy ilegalë, dhe t'i përcillte në mal te partizanët. Në këtë punë, veç të tjerëve, do ta ndihmonte edhe Bardhyli, një djalë i vogël por i shkathët, që e njihte vendin me pëllëmbë e që atij i pati hyrë në zemër me takimin e parë. Ishte me trup të bëshëm, ndonëse sapo kishte mbushur pesëmbëdhjetë vjeç. Peshonte mirë fjalën dhe punën.

Një mbrëmje, kur pati rënë muzgu, gjysmë ore para ndalimqarkullimit, ata të tre kishin dalë nga baza e fshehtë. Ecnin veç e veç. Largësia midis tyre ndryshonte sipas vendit nga kalonin. Në krye pri-nëte Bardhyli. Duart i mbante në xhepa. Herëherë fërshëllente me qëllim një melodi të huaj. Derisa kalaun një nga rrugët kryesore dhe hynë në një rrugicë me kthesa, çdo gjë shkoi mirë. Por, disa çape më tutje ndodhi e papritura e parë. Në cepin e rrugës punonte një lustraxhi. Bardhyli pati dalluar dy vetë që bisedonin me lustraxhiun. Njërin e njihte. Ishte i dyshimtë. Pasi ua bëri me shenjë shokëve që të vazhdonin rrugën, u nis për te lustraxhiu e, kur arri-ti pranë tij, dëgjoi të dyshimtin tek foli ngadalë:

— Shikoje si është veshur njëri nga ata! Sikur e njoh. Më duket është prej atyre...

— Ç'të duhet ta zgjasësh muhabetin, — i tha të dyshimtit Bardhyli. — Më mirë shkurtoje gjuhën, në s'do ta fusësh kokën në bela!

Ata të dy e shikuani me vëmendje këtë djalë, që e mbante dorën e djathtë në xhepin e xhaketës plot arna, u frikësuan se mos ai e kishte gishtin te këmbëza e revoles dhe s'guxuan të nxirrin fjalë tjetër. Djali u largua i qetë.

I arriti shokët shpejt e doli përsëri përpara tyre. Pas pak iu afroan një kthese të fortë, ku rruga ndahej në tri drejtime. Papritur u dëgjua një zhurmë e mbytur. Bardhyli kuptoi nga vinte ajo, prandaj ua bëri shokëve me dorë që të largoheshin. Kaluan vetëm ca sekonda e u dëgjua fare shkoqur të ecurit e rëndë të një patrulle naziste. Të tre shokët ia krisën vraptit rrëzë një muri të rrëzuar dhe e thirrën Bardhylin që të bashkohej me ta, por nuk morën përgjigje. Dëgjuan vetëm një «alt!» me zë të fortë dhe pastaj një breshëri automatiku. Pra, patrulla qëlloi kundër Bardhylit, kur ai enkas i ra asaj në sy e vrapoi në drejtim të kundërt me shokët.

Komisari u largua nga këto kujtime, e shikoi edhe një herë Elmazin, që bënte gjumin e parë, pshëretiu dhe doli jashtë. Donte ajér.

Pas dy ditësh, rrreth barrikadës plasi pushka. Të rrrethuarit kërkonin hapësirë. Partizanët mezi prisin urdhrin për sulmin e përgjithshëm. Edhe pas dy orësh armiku nuk u bind se përtej barrikadës s'kalonte dot. Ai la ca pikë të forta. Gjatë atyre dy orëve të përpjekjes humbi shumë njerëz. Një tank mori flakë. E goditën mes për mes me një predhë antitank. Në një pikë tjetër dy partizanë ia mbyllën «gojën»

me dy granata një mitralozi të rëndë. Një ndërtesë e vjetër sikur po shkallmohej. Brenda kacafyteshin të dyja palët. Xhamat thërrmoheshin. Nga dritaret dilte një tym i zi. Nëpër shkallët e dhomat plumbat zëvendësosheshin nga bajonetat e qytat e pushkëve.

Kur ra mbrëmja, luftimet morën formën e qitjeve të rralla, sa për t'i kujtar njëri-tjetrit se të dyja palët qëndronin dhe prisnin agimin e së nesërmes.

Kur dielli doli një pëllëmbë mbi malin në lindje të qytetit, u dëgjuan shungullima të forta. Armiqëtë qëllonin me mortaja të rënda. Dy kompani nga të tyret u vërsulën mbi barrikadën. Ushtarët me rroba të murme u derdhën valë-valë në formë gjysmërrethi. Ata që vinin ballë për ballë u tërhoqën, pasi lanë nja pesëmbëdhjetë të vrarë. Dy oficerë, me revole në dorë, ndonëse u shqyen të thirruri, nuk qenë të aftë të ndalonin zmbrapsjen. Njërin nga ata e kapi një plumb në kokë. Tjetri e pa dhe u shtri barkas. Grupi tjetër, që vinte në krahun e djathtë, e filloj sulmin në kushte më të mira. Ushtarët u nisën nga ca ndërtesa dykatëshe rrethuar me kopshtje. Kur arriten afër barrikadës, hapën zjarr dhe nuk qëlluan keq. Plumbat férshëllenin në veshët e partizanëve dhe lëshonin tinguj metalikë kur goditnin hekuri-shtet. Një nga partizanët kerkoi ndihmën e shoqes infermiere, kurse një tjetër nuk arriti të thoshte asnjë fjalë. Pastaj u dha urdhëri për kundërsulmin përfundimtar. Ishte një lëvizje e ethshme, e përgjithshme, një shtytje e madhe përpara. Të tërë kérkonin të kapnin një copë rrugë të re, një pëllëmbë tok. Barrikada mbeti pas. Ajo nuk shërbet më si pikë mbrojtëse. Njëra nga kompanitë partizane e sulmoi qendrën e armikut nga e majta dhe e vuri midis dy

zjarresh. Hitlerjanët qëndronin ende. Shpejt kundër tyre u lëshua edhe kompania e Elmazit. Një mortajë me qitje të afërt u vendos në një qoshe të fshehtë prej nga mund të qëlløhej mirë. Luita u ndez edhe më e ashpër. Pas një ore fortifikata armike u ças. Një togë partizane hyri në njérën nga ndërtesa. Kompania tjetër u lëshua përpara dhe u fut me bomba dore në krahun tjetër të mbrojtjes së gjermaneve, të cilët nuk rezistuan dot më. Nga çdo anë shi-heshin armiq të vrarë. Të tjerë iknin nga sytë këmbët. Dişa dorëzoheshin. Megjithatë, ende luftohej në pikë të veguara. Por fani nazistëve u mungonte koka drejtuese. Nuk përbënин më një trup të vetëm. Pra, ishin para një fundi të pashmangshëm.

Komisari i kompanisë me ca partizanë u futën në katin e parë të njërsë prej ndërtesa të fortifikatës armike, por nga dritarja e jo nga porta, se ajo shpesh minohej. Brenda u bë një rrëmuje e madhe. Luftohej më të gjitha mjetet. Në këtë kohë një partizan rrëshqiti nëpër një korridor të ngushtë. Iu bë sikur dëgjoi zëra, kur shokët ishin duke larë hesapet me armikun në anën tjetër. Me gishtin të këmbëza e automatikut u afrua te një derë e vogël, që të conte poshtë, në bodrumin e errët. U mbështet në faqen e murit dhe thirri me zë të mprehtë: «Nazist kaput!», por nuk mori përgjigje e nuk vuri re asnjë lëvizje. Megjithatë, nuk u largua. Si kaluan nga dy minuta, porta kërciti lehtë. Ai ndjeu mornica në trup. Zemra nisi t'i rrihte shpejt. Një kokë njeriu pa helmetë e dy së të trembur për vdekje, u dukën në pjesën e sipërme të portës. Dora e partizanit lëvizti. Automatiku lëshoi një breshëri të shkurtër e një alamat trupi u shemb sakaq përdhe. U dëgjua përsëri thirrja «Nazist kaput!» e pastaj një breshëri tjetër

cau përmes portës, që kishte mbetur gjysmë e hapur. Pas kësaj, poshtë nga bodrumi erdhën zëra në gjuhë të huaj. Te porta u duk një tytë pushke, ku qe lidhur një shami e bardhë. Ai që e mbante doli jashtë me duart lart. Flokët i kishte krejt të thinjura. Përballë tij qëndronte Elmazi me automatik në dorë. Atë çast ia behu aty komisari me dy luftëtarë të tjerrë. Nga bodrumi dolën edhe tre nazistë. Partizanët i vunë përpara.

Të nesërmen çdo gjë kishte marrë fund. Nga brrikada ishte nisur një kolonë e gjatë partizanësh. Ajo shkonte për në qendër të qytetit. Anash dhe pas e shoqëronin një mori njerëzish. Në krye të kolonës eenin komandanti e komisari. Fill pas tyre, të gjithë panë partizanin e vogël, Elmazin. Disa e njo'hën. E thirrën me emër. Ai nuk u përgjigj. Ekte me kokën lart. Automatiku i lëkundej në krah. Pantalonat i kishte kthyer gati një pëllëmbë te këmbët se qenë shumë të mëdha. Edhe xhaketa ishte e madhe. Vetëm ylli i kuq, ndonëse i qepur shpejt e shpejt, bënte figurë. Ndonjë edhe queshte, pa të keq, me rrobat e tij të mëdha, kurse për të ato qenë më të bukurat në botë, më të shtrenjtat. Ata nuk e dinin se sa qe përpjekur ai për t'i veshur ato rröba. Kishte luftuar njëlloj si gjithë të tjerët, për të ecur me ballin lart nëpër rrugët e gjithë Shqipërisë.

POPULLI NË RRUGË

Atë ditë qyteti dukej edhe më i madh nga ç'ishte. Disa punëtorë asfalonin rrugën e gjerë, që çante mes për mes tij. Një ndërtesë e bukur, në mbarim e sipër, binte në sy nga larg. Trotuarët zgjeroheshin Pak më tutje ndërtesës, atje ku pak kohë më parë kishte qenë një vend plot dhera e baltë, tani jeshilonëtë një park i bukur. Edhe rrapi i vjetër në mes të trëgut kishte lëshuar dëgë e bisqe të reja. Ai i shkonte mirë ngjyrës së çelur e të ëmbël që dukej ngadó. Në sheshin kryesor kalonin makina me lloj-lloj materialesh. Plekseshin zhurmat e shumëllojshme me thirrjet e gjëzuara të fëmijëve, me të ecurit e shpejtë të kalimtarëve të rinj, me çapet e lehta e të matura të atyre që nuk i numëronin më vitet e jetuara e që kishin dalë jashtë shtëpisë sa për të thithur afshin e asaj jete plot vrull e gjallëri. Plagët e luftës po fillojnë të mbeteshin pas.

Shoferi i një kamioni, një djalosh me sy të qeshur, i ra disa herë borisë dhe nxori kokën nga makina. Ai nuk iu hakërrua kalimtares së moshuar, që e detyroi të frenonte me forcë, por vetëm i foli më zë të getë e pa zemërim:

— Kalo më mirë andej nga trotuari, moj nënë!
Atje je e sigurtë.

Plaka e shikoi si e hutuar, e falënderoi duke bel-bëzuar dhe bëri për nga i tha shoferi. Asaj po i kumbonte ende në veshë ajo këngë, të cilën një çast më parë po e këndonin ca fëmijë shkolle. Duke e dëgjuar atë, e kishin rrëmbyer kujtimet e asaj dite, kur tërë ai shesh kishte gjëmuar pikërisht nga ajo këngë, që shpërtente fuqishëm nga goja e demonstruesve e kur i qe dukur se edhe vetë kënga përlëshej me armiqtë dhe sikur ua pati ndërruar drejtimin plumbave të tyre. Eci edhe pak ashtu si e përhumbur dhe qëndroi përpëra një pllakë mermari të bardhë. Disa djem të rinj, siç dukej të ardhur nga ndonjë fshat, po lexonin c'ishte shkruar mbi pllakën. Ajo iu afroa njërit prej djemve dhe iu lut t'ia lexonte shkoqur e ngadalë. Ai e shikoi me kureshtje dhe nisi leximin, duke theksuar çdo fjalë. Këtu te ky shesh, më 28 Nëntor 1942, u bë demonstrata e madhe. . . . Asaj ia donte zemra që germat e skalitura të mos kishin të sosur, po të tregonin fill e për pe të gjitha ato që kishte parë e jetuar ajo vetë në atë shesh. Pastaj buzëqeshi lehtë dhe tundi kokën si për të qortuar vreten që kishte kërkuar aq tepër nga një pllakë përkujtimore.

Ishte hera e parë që vinte në qytetin ku kishte lindur, që prej mbarimit të luftës. Ndonëse i kishte kaluar të gjashtëdhjetat, mbahej mirë. Kishte trup të pakët, fytyrë të verdhë e duar të thata pa muskuj, ku dukej rrjeti i damarëve të kaltër e të fryrë. Ekte me çapa të vogla, po të shpejta e me një gjallëri që do t'ia kishte zili edhe i riu.

Jeta e asaj gruaje kishte qenë e mbushur plot dhimbje. Gjashtëmbëdhjetë vjeçë e kishin detyruar të bëhej nuse. Brenda pesë vjetve i vdiqën dy fëmi-

jë! U ngushëllua pak kur lindi dy binjakë. Ditën që mbushi tridhjetë e pesë vjeç i vdiq i shoqi. Ajo i rriti djemtë në varfëri të madhe. Pastaj erdhi lufta e ia mori të dy në lulen e rinisë. I madhi (e quante kështu, ngaqë vinte më i bëshëm e më i gjatë) mbeti në male. Ajo e nxirrte brengën duke biseduar me fotografinë e tij, natën vonë. Pas kësaj egërsohej, kërkonte të hakmerrej. Tjetri u vra një muaj pas të vëllait, kur po kapercente murin rrethues të shtëpisë, për t'u shpëtuar ndjekësve fashistë pas një aksioni. Kjo qe shtumë e rëndë për të, ndaj s'e linin vetëm. I vinin në shtëpi të njobur e të panjohur. Të rinjtë e thërrisin nënë. Edhe ajo i quante bij. Dhe s'e ndiente veten si nënë garibe, ndaj dhe nuk ligështohej.. Si ato rrënjet e pemës që kapen fort në tokë, për t'u bërrë ballë rrebësheve të natyrës, ashtu edhe ajo kapei fuqishëm pas jetës së lirë, për të cilën luftuan djemtë e saj e në emër të së cilës ajo duhej të ngrihej mbi çdo sakrificë, që t'i nderonte fëmijët edhe pas vdekjes së tyre.

Si hodhi edhe një herë vështrimin te pllaka përkujtimore, ndreqi shaminë e kokës dhe nisi të ecte së gjati trotuarit. Aty pranë saj ishte ai vendi me të cilin lidheshin kujtime të paharruara. Mendja filloj t'i bridhte nëpër atë shesh dhe për çudi hapat e saj po bëheshin më të vegjël, më të çrregullt. Papritmas qëndroi. Disa fëmijë brohorisnin e këndonin. Ajo e ndali shikimin tek ata. Në atë çast një si perde e mjegullt ia veshi sytë dhe duke qenë ashtu e përhumbur, si në kllapi, iu bë sikur dëgjoi që i thirrën: Nënë, ruhu se mos të të vrasin!» Kur i kishin thirrur kështu? Kush i kishte thirrur? Mendtë ju mëron më shumë. Sytë iu errën më shumë, balli iu mbush me bula të ftohta djerse. Nuk po dallonte më

ç'ishin ata që kalonin, fëmijë apo të rritur. U mbështet diku, pa qenë në vete. Pas kësaj iu bë sikur gjithë vendi lëvizi e sikur sheshi u mbush me njerëz të tjerë, që thërrisin: «Poshtë pushtuesit! Rroftë Shqipëria!...» Në mes të sheshit, midis njerëzve, ajo pa një grua se si brohoriste edhe ajo me grushtin lart, me shaminë e kokës të lëshuar mbi njërin sup, me flokët të shpupurisur. Kjo grua ishte ajo vetë. Dhe ja një djalë i ri, që po ë ndiqnin armiqjtë fashistë duke e qëlluar dhe që i thërritet: Nënë, ruhu, nënë! Ajo u del përpara fashistëve... Plumbi goditi në krahun e saj...

Krejt e pavetëdijshme, atje te vendi ku që mbështetur nëna, preku krahun atje ku pati marrë dikur plagën.

Me sytë gjysmë të mbyllur, të fiksuar në një pikë, me shpejtësinë e një èndrrë të shkurtër, plaka nisi të kalonte me mendje nga një ngjarje në tjetren. E tërë qënia e saj tani nuk ndodhej më në një ditë të zakonshme. Tani ajo jetonte në sheshin e demonstratës së madhe si atë ditë kur kishte zbritur populli. Shihite përsëri atë mizéri njerëzish të revoltar. Në krye valëvitej një flamur flakë i kuq. Në dallgëzimin e njerëzve ai herë — herë i humbiste nga sytë, po pastaj ngrihej përsëri lart. Njerëzit me uniforma të murme lëshoheshin si të tërbuar përrreth flamurit. Ata donin që nyjen e atij kordonit të fortë, që ishte lidhur tamam aty, ta zgjidhnin, pastaj ta këputnin e ta bënin copë-copë. Ajo vetë ndodhej ca si larg dhe nuk e kishtë parë si pati rënë një djalë nga plumbat e fashistëve italianë, i cili ishte kapur fort pas flamurit e nuk donte ta lëshonte nga duart. Ky ishtel dëshmori i parë i demonstratës.

Sheshi gjëmonte nga britmat, nga këngët, nga

parullat luftarake. Nënës i buçisnin veshët. Asaj i bëhej sikur dëgjonte përsëri thirrjet: «Duam liri! Poshtë fashizmi! Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!» Jetonte me atë pështjellim të madh që kishte kapur çdo gjë. Ja, sikur e ndjeu çapin e rëndë të atij katili, veshur me uniformën ushtarake, me ata sy të çakërritur, që kërkonin gjak, kurse ai studenti i plagosur qe mbështetur atje te shatërvani. Kondaku i pushkës ngrihej e ulej, ndërsa studenti e zmbrapste me njëren dorë dhe me tjetrën godiste xhandarin fashi, i cili nuk kaloi shumë e u rrëzua përtokë. kurse djalin e rrethoi në çast një skuadër e tërë xhandarësh. Niéri nga ata e qëlloi me qytën e pushkës. Xhandari i rrëzuar u ngrit dhe deshi ta vriste djaloshin, por një burrë me rroba tërë vajra e trup vigani e përfshiu xhandarin përfyti dhe e përplasi përtokë. Studenti iku. Punëtorin e kapën. Megjithatë, ai ishte i kënaqur që shpëtoi shokun. E vunë në mes dhe e shtynë përpara duke e goditur. Ai dukej si luan në mes të aenve dhe ecte me kokën lart. Ishte mbvtur në gjak. Nisi të këndonte: **O djem rrëmbeni pushkët ja vdekje ja liri!** Sa më tepër largohet, aq më i madh shquhej midis bajonetave, ndërsa ata dukeshin të vegjël, të frikësuar, të rraskapur. Kur ja papritur nënës i vajtën sytë te një vajzë leshverdhë. Në mes të shoqeve e shokëve ajo kacafytej me fashistët. Dukej si shqiponjë. Edhe atë e kapën. E hoqën zvarrë, e goditën keq, po thirrjet Poshtë fashizmi!» nuk ia ndaluan dot.

Këto shikonte nëna, i shikonte si tanë, të gjalla, me sytë e mendjes dhe nuk dinte ç'kishte ndodhur tjetër atë ditë të asaj demonstratë të madhe.

Zemërimi i madh i popullit kishte shushatur edhe prefektin. Siç tregonin më pas, ai ecte nëpër

zyrën e mobiluar dhe mbante veshët nga dritarja, prej së cilës hyntë brenda zhurma e tmerrshme e sheshit. Ngrinte herë pas here receptorin e telefonit, ndërsa te porta e tij trokisnin pa pushim për të thënë diçka të re e për të marrë urdhra. Prefekti i dëgjonte si i hutuar. Thirrjet e njerëzve nga jashtë futeshin si thikë në zemër. Mendoi për një çast të dilte në ballkon e t'u thoshte demonstruesve ndonjë fjale qetësuese, por hoqi dorë.

Nuk harrohet najo ditë! Qepenat e dyqaneve kërcitnin. Bashkë me punëtorët e studentët dilnin në rrugë dhe zejtarët, shkonin te sheshi, atje tek vor-bulla sillej furishëm. Nënëpa me sytë e saj një burri të thyer në moshë, që la dyqanin e vogël dhe që mori nga sheshi duke çaluar.

Pas gjysmë ore ajo e pa rishtas në njëren nga rrugica me kalldrëm. Përplasej sa të njëra qoshe në tjetren. Dukej si i dehur. Fashistët që bërdheshin drejt sheshite kishin goditur keq në gjoksët e më kokë. Ai eci e eci e u rrëzua. Qëndroi ashfa përmënjë cast. mbështeti bërrylat te gurët e kalldrëmit, i dha trupit përpjétë me sa forcë patid dhe diç deshi të thoshte, por e kapi një kollë që ia mori shpirtin. Pështyu në tokë. Sytë i mbetën në lëngun e trashë e të kuq. Duart nuk patën më fuqi ta mbanin trupin e dobët. U shemb prapë përdhë. Pikërisht në këtë çast e kishte arritur nëna me shaminë e rrëzuar e flokët e shpupurisur. E kishte tërhequr me nxitim, para se të vinin atje karabinierët. Kur e futi në derën e një hani të vogël, ai i buzëqeshi, ndonëse ajo për të ishte fare e panjohur. Vetëm kaq pati forcë të bënte.

Ishte ditë e shtunë, ditë pazari. Në qytet kishin ardhur shumë fshatarë. Disa prej tyre u bashkuan me punëtorët e studentët. Pati edhe të atillë që i për-

fshiu vala e demonstratës pa kuptuar fare, pa pasur kohë të pyeshin e të sqaroheshin. I rrëmbeu ajo shtjellë e fuqishme, që i bënte njerëzit për vete. Kështu i ndodhi edhe një fshatari, që shkoi të merrte gomarin të hani për t'u kthyer në fshat. Atë e goditën befas me qyta pushkësh. Kurse ai filloi të thërriste «Poshtë fashizmi! Duam liri!» krah për krah me të tjërët.

Nënës iu përfytyrua edhe ai burrë dyllë i verdhë që u ndodh papritur afër demonstruesve, me brezin flakë të kuq ngjeshur belit, tek ndrinte qosteku i sahatit, me një peshqir borë të bardhë në qafë e me qeleshen në kokë. Ajo e diktoi si u zembraps me lemeri, kur turma nisi t'i avitej. Shau ndyrë, kür njoju bashkëfshatarin e tij që u përzie me «rrebelët». U zbyth si ndonjë hajdut. Nisi të shpejtonte çapet, por u pengua në një gur kalldrëmi dhe duke mallkuar u lëkund ca e ua mbathi këmbëve mu përpara syve të nënës shamirrëzuar. Kur pa se s'kishte njeri rrotull, shfryu hundët, po në tokë nuk ra asgjë. Hyri në një rrugë tërë pluhur.

E çfarë s'kishte ndodhur asaj ditë! Nëna nuk kishte mundur t'i shih të t'i dëgjonte të gjitha! Sytë invajtën te hoteli i madh e pastaj të godina e dikurshme e qeverisë së shitur tek i huaji. Ato dy ndërtesa ditën e demonstratës i dukeшин sikur fshin ëndrrin diçka të frikshme, të mistershme; por që edhe lëkundeshin e do të shkallmoheshin.

* * *

Kujtimet e këtyre ngjarjeve e bënë nënën ta ndiente, më të fortë gjëzimin e lirisë. Duke e rimarrë

veten, po gjithnjë ashtu nëpër mjegull ajo dëgjoi se si përhapeshin tingujt e një këngë kushtuar atdheut. Ata vinin nga ndërtesa e re e bukur në mbarim e sipër. Hodhi sytë andej dhe pa fotografinë e shokut Ënver të vendosur në fasadën e ndërtesës. Iu duk sikur portreti i udhëheqësit u bë njësh me cohën e kuqe të flamurit. Vuri dorën në ballë, të shih-te më mirë...

Sytë iu njomën. Ishin lot lumturie.

Etakat e gjithnjë	3
Mesjeti	14
Shoqeria partizane	21
Dënim	27
Kuvendi	37
Konkordati i batalloves	54
Motiv e vëllaz	67
Qortimi i gjithëve	70
Rendja e së shumtë më tepë	86
Përputhje	114

the following day. The author had been invited to speak at a meeting of the New England Society for the Advancement of Science, held at the University of Vermont, on the 2d of October, 1851. The meeting was opened by a paper from Mr. J. C. Dyer, on "The Geology of Vermont." This was followed by a paper from Mr. W. H. Brewster, on "The Birds of Vermont." The author's paper was the third in the order of reading, and was delivered at 1 P.M. The author had been invited to speak at a meeting of the New England Society for the Advancement of Science, held at the University of Vermont, on the 2d of October, 1851. The meeting was opened by a paper from Mr. J. C. Dyer, on "The Geology of Vermont." This was followed by a paper from Mr. W. H. Brewster, on "The Birds of Vermont." The author's paper was the third in the order of reading, and was delivered at 1 P.M.

SAY'S LIQUORIN PAPER FOR INVESTIGATION

L E N D A

— Flakët e urrejtjes	3
— Mësuesi	14
— Shoqëria partizane	27
— Dënim i	37
— Kovaçi Feti Jonuzi	47
— Komandanti i batalionit	54
— Motër e vëlla	67
— Qortim i sinqertë	76
— Rrobat më të bukura në botë	99
— Populli në rrugë	110